

Studiuesja e njohur Alketa Spahiu flet për librin e saj më të fundit, “Kadare, bashkëkohës i epikes”, si dhe për kujtimet e kalimit prej një sistemi ku liria i ishte mohuar maksimalisht drejt një jete me mundësi të pafundme për individin që ta kuptonte dhe ta jetonte lirinë e vet.

ALKETA SPAHIU: Studimi im i kushton shumë vëmendje anës vokale të rrëfimit kadarean

Bisedoi Andreas Dushi



100-vjetori i lindjes së poetit

Llazar Siliqi, përfaqësuesi më i talentuar i brezit të viteve '50-të

Nga Klara Kodra



(fq. 4)

Brezi i viteve '50-të nuk arriti të bëhej dot avangardë, siç u bë me një shpërthim të fuqishëm krijues avangarda e viteve '60-të që e rilindi realizmin kritik shqiptar, duke e pasuruar me atome modernizmi, por së cilës iu desh që të fshihej pas mburojës së realizmit socialist që ishte atëherë i vetmi drejtim i pranuar. [...] Një talent i tillë ishte Llazar Siliqi, i cili u shfaq dhe mbeti gjithë jetën e vet poet duke lëvruar zhanre të poezisë epike ose epiko-lirike dhe lirika të mirëfillta, në ndonjë rast duke u afuar me muzikën në krijimin e libreteve muzikore.

Promovimi i librit të Ylli
Drishtit dhe Andrea Llukanit

IKONOSTASËT E SHQIPËRISË

Nga Gazmend Leka (fq. 5)

SHËNIME MBI LIBRAT

“Porosia e kullës”, e Pashko R. Camajt

Nga gurët e kullës
tek xhamllëku i
qiellgërvishtëve

Nga Fatbardh Amursi (fq. 6)

“Eskadronët e vdekjes”, i Bardhyl Mahmutit

Një vepër e fortë,
që denoncon gjenocidin
serb në Kosovë

Nga Rudina Muharremi Beja (fq. 8)

Romani “Balada” i shkrimtarit rumun
Adrian Lesenciuc

Romani i një balade,
balada e një romani që
na erdhi nga Rumania

Nga Visar Zhiti (fq. 9)

Për librin “Me gjuhën dhe stilin e
poezisë” të prof. dr. Tefë Topallit

Një përmbledhje studimore
me analiza gjuhe e stili

Nga Prof. As. Dr. Orjeta Baja (fq. 10)

Botohet në Spanjë “Vallëzim me hënën” i shkrimtarit Namik Dokle

Këto ditë u botua në Madrid libri i legjendave të Gorës,
shkruar nga Namik Dokle dhe përkthyer në spanjisht nga
María Rocés Gonzáles. (fq. 13)

FRANZ KAFKA OSE ANKTHI EKZISTENCIAL

Nga Feride Papeleka



(fq. 20)

BIBLIOTEKË

Nasi Lera (fq. 14)

Qeni me emër njeriu

Zejnullah Rrahmani (fq. 16)

Heshtja

Shqiptar Oseku (fq. 17)

Takimi

Petro Çerkezi (fq. 18)

Zemra ka kujtesë

Luerda C. Avdiaj (fq. 18)

Dromca të trishta

Aleksandër Ivanoviç Kuprin (fq. 22)

Milioneri (Përktheu: Kosta Nake)

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Një letër nga Bilbao, nga piktori Fatmir Haxhiu

Nga Enver Kushi (fq. 12)

E dija që e kisha ruajtur si sytë e ballit, letrën që më kish dërguar Fatmir Haxhiu, nga Bilbao e largët. Dhe kur e hapa dhe nisa ta lexoj, nga fjala në fjale dhe përmes rreshtave, më dukej sikur dëgjoja zërin e Fatmirit dhe të Farziletit.

Në parathënien e librit “Kadare, bashkëkohës i epikes”, shkruani se është në thelb, punimi juaj i doktoraturës. Çfarë ju shtyu ta studioni pikërisht në një të tillë qasje Kadarenë?

Që në vogëli, kisha marrë një formim të fortë mbi mitologjinë greke nga im atë. Netëve të dimrit, mitet greke më ofroheshin si përralla, të rrëfyera gojarisht, duke më ushqyer imagjinatën me historitë e Olimpës dhe heronjve legjendarë. Kur u rrita, letërsia greke e lashtë vazhdoi të më tërhiqte shumë, duke u shndërruar në një pasion të vërtetë. Por, sajë leximit të romaneve të Ismail Kadaresë përjetova një emocion të veçantë, një ndjesi që më rikthente në ato rrëfime të fëmijërisë.

Në universitet, letërsia epike greke, dhe veçanërisht Homeri, u bë fusha ime e specializimit në kuadër të letërsisë së krahasuar. Në momentin e zgjedhjes së temës së masterit, lidhja mes veprës së Homerit dhe asaj të Kadaresë m'u duk krejt organike. Fryma epike, e pranishme te të dy këta autorë, më hapi udhën e botës studimore. Kjo frymë u bë për mua si filli i Arianës, që më udhëhoqi nëpër labirintin e analizave dhe hulumtimeve letrare, duke më çuar drejt studimeve të doktoraturës.

Ky studim, cilat aspekte të panjohura të veprës së Kadaresë mendoni se nxjerr në pah për herë të parë?

Mendoj se vepra e Ismail Kadaresë mbetet ende pak e lëvruar në të gjithë dimensionet e saj. Ajo përmban shumë shtresa të ndërthurura që, së bashku, formojnë atë që mund të quajmë veçantinë e stilit të tij. Në qendër të kësaj vepre komplekse qëndrojnë tradita gojore dhe fryma epike. Këto elemente përbëjnë bërthamën e veprës së tij.

Natyrish, shumë studime i janë dedikuar këtyre tipareve të rrëfimit të tij. Por, mendoj se ka patur një mungesë të rikonceptualizimit të kritikës së saj. Që do të thotë se, shumica e studimeve mbi të, rimarrin pa fund tematikën e diktaturës, pra përmasën politike. Unë nuk jam orvatur ta fus me zor veprën e Kadaresë nëpër konceptualizime filozofike. Paçka se mendoj që filozofia bashkëkohore do gjente boll terren hulumtimi në këtë vepër. Studimi im i kushton shumë vëmendje anës vokale të rrëfimit kadarean. Pra merret me Zërin, si element pak të përdorur në kritikën shqipe. Për këtë, jam thelluar në referenca autoritative tashmë, si studimet mbi poezinë orale dhe traditat, të Paul Zumthor, apo të Georges Gusdorf, etj.

Qasje e freskët në studimin tim, mendoj se mbetet fokusi mbi epitetet formulare, roli i tyre në konstruksionin e rrëfimit kadarean dhe në konstituimin e personazheve. Mendoj se ky element, i huazuar detyrimisht prej procedimit të poezisë homerike, është trajtuar jo shpesh nga kritika. Ky element, jo vetëm ka rëndësi akute në shkrimin e Kadare, në stilin e tij. Por, mendoj se është dhe element garantues i universalizimit dhe tiparit

ALKETA SPAHIU:

Studimi im i kushton shumë vëmendje anës vokale të rrëfimit kadarean

Bisedoi Andreas Dushi



Vizatim nga Anastas Kostandini - Taso

transhistorik të veprës së tij. Parë nga këndvështrimi strukturalist, të tilla elemente, enë komunikuese mes epokave dhe kulturave, e tejzgjasin shkrimin kadarean përtej kufijëve tanë gjuhësorë e gjeografikë. Është shumë domethënëse për mua të mendoj se Kadare mbetet një autor tepër-shqiptar e ballkanik, gjithë duke prekur skaje të largëta të mentalitetit botëror.

Kadareja shpesh perceptohet si një shkrimtar që përkthen kompleksitetet e historisë shqiptare. Si do ta përshkruanit rolin e tij në

ndërtimin e identitetit kulturor shqiptar?

Kadareja dhe Shqipëria funksionojnë si dy anët e së njëjtës monedhë. Në Francë, këto dy emra janë shndërruar gati në sinonime. Kadareja mbetet padyshim një nga autorët “më shqiptarë”, nga frymëzimi dhe lëvrimi i lëndës njerëzore. Por, krijimtaria e tij tejkalon kufijtë natyrorë dhe historikë të Shqipërisë. Ai flatron drejt një universalizmi që vetëm letërsia e madhe mund të arrijë.

Natyrish, nuk është shumë e

vlefshme ta kufizojmë zhvillimin e letërsisë së sotme shqipe vetëm te shkrimi i Kadaresë. Ai mbetet vërtet autori më i kompletuar i letrave tona. Por, identiteti shqiptar, ecuria e subjektit shqiptar pas viteve 90të, është shumë më i gjerë dhe shumë më kompleks se sa mund ta përmbledhë një autor i vetëm, sado i shquar. Letërsia bashkëkohore shqipe me siguri duhet të ketë tiparet e saj, si të frymëzuara edhe të ndryshme prej asaj të Kadaresë. Sepse, mendoj që, në rast të kundërt, do të mohonim vetë peshën e veprës së tij në lexuesit e krijuesit e sotëm.

Sipas jush, a ja ka dalë (dhe nëse po, si?) Kadare të kritikojë në mënyrë të nënkuptuar regjimin komunist, duke qenë njëkohësisht nën mbikëqyrjen e tij?

Ky aspekt i veprës së Kadaresë nuk ka qenë ndër shqetësimet e mia kryesore, megjithëse është diçka që mund të vërehet lehtësisht. Shtresat që përmenda më lart përfaqësojnë lexime të ndryshme që mund t'i bëhen krijimtarisë së tij. Për mendimin tim, Kadare vetë kishte një marrëdhënie paksa komplekse me konceptin e disidencës, të paktën ashtu siç e interpretojnë disa kritikë. Ai shkruan dhe, si çdo shkrimtar, shndërrohet në një ndërgjegje që vrojton dhe analizon një situatë. Kjo është, në thelb, esenca e të qenit intelektual.

Ajo që më duket më e rëndësishme në veprën e Kadaresë është fryma epike që ai arrin të zbulojë dhe të pasqyrojë edhe në epokën e tij. Disidencën e Kadaresë (nëse duhet përdorur patjetër ky term) është më universale, më e gjerë. Nuk më duket se ai kufizohet te një kauzë e caktuar fikse ideologjike. Por, ofron një vizion të tij të botës, një botë pa kufij kohorë. Më vjen ndërmend një fragment interviste e Kadaresë, ku përmend figurën e Edgar Allan Poe. Dhe më duket me vend të theksoj, se, sikundër për poetin amerikan, edhe për Kadarenë lënda e botës është ekskluzivisht materje për letërsi.

Mendoni se Kadare është më shumë një shkrimtar kombëtar apo universal?

Alketa Spahiu

KADARE,
bashkëkohës i epikes

Onufri



Siç e përmenda më lart, Kadare është një shkrimtar që tejkalon kufijtë gjeografikë shqiptarë. Jo vetëm që personazhet e tij enden në çdo skaj të globit, por edhe temat që trajton ai janë preokupime universale. Nëse mund ta konsiderojmë si një autor shqiptar, kjo është për faktin se ai shkruan në gjuhën shqipe, një gjuhë që lexohet nga një pakicë e popullsisë së globit. Vepra e tij është përkthyer në shumë gjuhë, por kjo nuk garanton gjithmonë që lexuesit e huaj mund ta vlerësojnë plotësisht stilin dhe nuancat e tij.

Gjatë doktoraturës, më është bërë një vërejtje për mungesën e një kapitulli mbi vlerën e përkthyesve të tij, kritikë që sugjeronte se juria universitare franceze duhej të zotëronte të dyja gjuhët – shqipen dhe frëngjishten – për të gjykuar vlerën e plotë të veprës. Nuk ka dyshim se përkthyesit e Kadaresë, të cilët janë kryesisht shqiptarë, kanë bërë një punë kolosale. Megjithatë, nuk mund të thuhet se suksesi ndërkombëtar i Kadaresë i detyrohet vetëm përkthimit, siç shpesh theksohet nga ata që nuk e kanë lexuar atë në të dyja gjuhët.

-Cilat janë, sipas jush, tematika kryesore që rimerren në veprat e Kadaresë?

Miti luan një rol qendror në veprën e Kadaresë. Ai përdor mitet jo thjesht si referenca të largëta kulturore, por si mjete për të eksploruar tensionet dhe universalitetin e përvojës njerëzore. Në këtë kontekst, mitet nuk janë vetëm elementë të së kaluarës. Ata janë pasqyra të një realiteti të vazhdueshëm. Për shembull, veprat si *Kronikë në gur* ose *Pallati i ëndrrave* shpalosin një narrativë që ngërthen mitin dhe realitetin, duke i dhënë ngjarjeve historike një dimension të përjetshëm dhe alegorik.

Në të njëjtën kohë, politika dhe raporti mes individit dhe pushtetit janë tema që përshkojnë vazhdimisht krijimtarinë e tij. Në universin e Kadaresë, pushteti shpeshherë shfaqet si një forcë e errët, shtypëse dhe gjithnjë e pranishme. Ai analizon mënyrat se si pushteti ndikon jo vetëm në strukturat shoqërore, por edhe në psikologjinë individuale. Në veprat e tij, si p.sh. *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, politika dhe lufta shfaqen jo thjesht si ngjarje historike, por si trauma kolektive që përbëjnë vetë identitetin kombëtar.

Raporti mes subjektit shqiptar dhe botës gjithashtu zë një vend të veçantë në veprën e tij. Kadare ndalet shpesh në dilemën ekzistenciale të shqiptarëve mes Lindjes dhe Perëndimit, mes izolimit dhe globalizimit. Ai shtron pyetje mbi identitetin, mbi atë se si një popull i vogël si shqiptarët mund të gjejë vendin e tij në Histori. Përmes një qasjeje kritike dhe ndonjëherë ironike, Kadare arrin të pasqyrojë sfidat dhe përpjekjet e kombit shqiptar në raport me botën. Në veprën e tij këto tema e tejkalojnë kontekstin specifik shqiptar për të gjetur jehonë universale. Në një kohë kur raportet mes pushtetit dhe individit janë ende shqetësuese dhe konfliktet kulturore e politike mbeten në qendër të vëmendjes, mesazhet e Kadaresë vazhdojnë të ndjellin interes dhe reflektim. Ai na kujton se,



pavarësisht ndryshimit të kohëve, lufta për të ruajtur dinjitetin, identitetin dhe lirinë personale mbetet një betejë e përhershme e njeriut.

Ndërkohë, keni jetuar, së bashku me familjen për një kohë të gjatë në internim, në Gradishtë. Kohë e vështirë në diktaturë. Përse familja juaj, familja Spahiu, u internua nga regjimi i kohës? Cila ka qenë e kaluara e kësaj familjeje të njohur në Shqipëri?

Familja ime u dëbua nga Tirana në vitin 1962. Më parë, ajo ishte dëbuar nga Prizreni, pasi refuzoi të pranonte pasaportën jugosllave. Familja ime pësoi të njëjtin fat si shumë familje të tjera, të njohura ose më pak të tilla, që nuk radhiteshin brenda normave politike pas Çlirimit.

Kjo e kaluar e dhimbshme, me rrënjë në historinë e trazuar të familjes sime, na ndjek ende sot. Përkundër ndryshimeve politike dhe sociale në Shqipëri, ne mbetemi ende në pritje të një rehabilitimi që vonon padrejtësisht, një akt drejtësie që do të duhej të kishte ardhur prej kohësh. Me vendosjen në Francë, familja ime u integrua menjëherë në sistemin arsimor. Unë, por dhe im atë, paçka se tashmë në moshë, kryem një pas një të gjitha etapat e arsimit të lartë. Ne e menduam këtë si një nga sfidat kryesore për jetën tonë të re, jo vetëm si kompensim të jetës së marginalizuar më parë; por, sidomos, si sfidë për integrimin tonë në një jetë të re. Fakti që unë kreu një doktoraturë mbi veprën e Kadaresë, nuk lidhet vetëm me aksesin që vepra e tij ka në Francë.

Për mua si shqiptare, kish rëndësi edhe fokusimi në materjen shqiptare, tashmë parë nga modulet e reja, me të cilat më kishin orientuar studimet e thelluara në universitetin francez.

Në fillim të viteve '90 keni emigruar familjarisht në Francë. Cili ishte statusi që mori familja juaj nga shteti francez dhe rruga që keni bërë ju personalisht në Francë, në lidhje me studimet dhe karrierën tuaj?

Në prag të 17-vjetorit tim, familja jonë u largua nga kampi i Gradishtës për në Francë. Ishte një kthesë e papritur dhe vendimtare në jetën tonë e të bashkëvuajtësve tanë. Kështu nisi për ne një jetë e re, e udhëhequr nga një etje e jashtëzakonshme për shkollim dhe për të ndërtuar një të ardhme më të mirë. Im atë, i privuar nga arsimit për vite me radhë për shkak të internimit, rifilloi nga e para dhe u regjistrua si student në degën e Historisë. Me këmbëngulje, ai e vazhdoi këtë rrugë deri në përfundimin e doktoraturës. Sajë këtyre studimeve, ai gjeti një orientim të ri në metodologjinë e qasjen e historisë së lashtë të trojeve shqiptare. Disa nga librat e tij si *Triptik epirot, Mitologjia dhe feja epirote, Pellazgët dhe ilirët në Greqinë e vjetër, Iliriciteti i maqedonsave dhe i epiroteve*, etj, mendoj se i kanë sjellë një kontribut të rëndësishëm shkencor studimit të origjinave tona kombëtare, dhe janë absorbuar nga shumë lexues në të gjitha viset shqipfolëse.

Lidhur me mua, rrugëtimi im akademik shkoi drejt mbrojtjes së doktoraturës në Sorbonë, ku u përqendrova në letërsinë e krahasuar.

Më pas, kalova konkursin shtetëror për mësimdhënie, falë të cilit fillova të jap mësim. Aktualisht, jam pedagoge e gjuhës dhe letërsisë franceze në Paris, një arritje që është njëkohësisht një reflektim i sakrificave dhe përpjekjeve të familjes sime.

Përpara pak kohësh te "Peizazhe të fjalës" është publikuar një shkrim juaj shumë interesant me titullin "Të filmosh të kaluarën", mbi një instalacion të quajtur "Ruine Part I, Gradishtë". Çfarë është ky instalacion, një lloj *In Memoriam* për atë kohë aq të vështirë për ju, familjen tuaj dhe gjithë shqiptarët që vuanin në atë kamp internimi? Si qëndron kujtimi juaj në lidhje me të? A jeni kthyer ndonjëherë në Gradishtë? Si e keni përjetuar kthimin? Si jeni përballur me Kujtimin, me atë pjesë të jetës suaj?

Artikulli që botova te *Peizazhet e fjalës* përqendrohet në veprën e artistes franko-algeriane Halida Boughriet, e cila krijoi një instalacion në Gallerie delle Prigioni të Fondacionit Benetton. Kjo vepër lindi pas një udhëtimi të përbashkët në Gradishtë, vendin ku lindi dhe ku nuk isha kthyer prej 27 vitesh. Ishte një kthim fizik dhe emocional. Me këtë projekt, artistja Boughriet arriti të kuptonte jo vetëm ngërçin tim të brendshëm; por dhe të krijonte një instalacion-performancë të frymëzuar nga terreni ku kisha kaluar fëmijërinë time atipike. Kështu ajo, dhe unë si pjesë e projektit, u munduam ta zhvendosim Gradishtën drejt e në një galeri arti, pra duke sjellë një *heterotopi*, sikundër e etiketon shpesh filozofia bashkëkohore. Titulli i instalacionit, *Ruine (Gërmadhë)*, përkon në mënyrë ironike dhe simbolike me kuptimin e vetë fjalës "Gradishtë". Në fakt, kampi sot është pothuajse i shkatërruar; ai ekziston si një gërmadhë e mbushur me kujtime, por për çudi, brenda këtyre rrënojave ende kishte jetë.

Gjatë realizmit të projektit, zbulova se baranga ku jetoja dikur, tashmë banohej nga djali i një bashkëvuajtëseje të familjes sonë, i lindur pas vitit 1991. Një fëmijë i demokracisë, që kishte krijuar familjen e tij në të njëjtat rrënoja që dikur ishin hapësira e vuajtjes dhe izolimit tim. Ai vend përfaqësonte një dualitet të fortë: nga njëra anë, plagën e pashlyeshme të së kaluarës, dhe nga ana tjetër, një formë të re të mundimeve: varfërinë dhe mungesën e perspektivës që situata kaotike e sotme gjeneron vazhdimisht.

Në Gradishtë nuk gjeta më imazhet e fëmijërisë sime. Në vend të tyre, ndjeva se isha kaluar tashmë "në anën tjetër të pasqyrës" së kujtimeve. Gjithçka dukej e largët, si një kujtesë që më shikonte nga një vend tjetër, e distancuar nga vetë koha ime. Kjo përvojë intime, e mbushur me ndjesi të forta dhe kontradikta të brendshme, u bë thelbi i veprës së artistes Halida Boughriet.

Përmes instalacionit të saj, fotove dhe videos me zërin tim (voice over) duke recituar tekstin që shkrova pas këtij kthimi, artistja solli në jetë të gjithë këtë përzierje emocionale dhe refleksionesh.

Në rrugëtimin e letërsisë shqiptare, në përgjithësi, dhe të gjinisë së poezisë në veçanti, brezi i viteve 50-të, brezi i shkrimtarëve që botuan menjëherë pas luftës, pati një detyrë të rëndë për të plotësuar, që arriti ta realizonte në nivel shumë të kufizuar për arsye letrare dhe jashtëletrare.

Një nga arsyet për këtë ishte që ky brez shkrimtarësh nuk arriti të përcaktonte një program të qartë estetik për letërsinë e re që donte të krijonte. Synimi i shkrimtarëve të atëhershëm që iu drejtuan në fillim poezisë, si gjini më e pasur në tradita, mandej gjinive të tjera më pak të zhvilluara si proza dhe dramaturgjia ishte thellimi i realizmit të viteve tridhjetë dhe pasurimi i tij me një perspektivë të së ardhmes që lidhej me realizimin e idealeve socialiste, pra, me një lloj energjie romantike që vinte nga traditat e romantizmit historik shqiptar, tashmë të kapërcyer dhe t'i çonte më tutje.

Po ata nuk arritën ta realizonin këtë synim në një drejtim letrar që të kishte vazhdimësi me traditat e shkëlqyera të viteve tridhjetë, kur u zhvillua një shumëllojshmëri drejtimesh dhe u shfaqën individualitete krijuese të fuqishme.

Realizmi socialist, si drejtim i ri që po formohej pas lufte dhe duhet të mëshironte ëndrrat për një letërsi të re u shpëtoi shkrimtarëve nga dora për shkak të ndërhyrjes brutale të partisë-shtet në kulturën dhe letërsinë shqiptare.

Rregullat e këtij drejtimi nuk u formuluan nga vetë shkrimtarët, po u përcaktuan "nga lart". Letërsia që po lindte pati si model një letërsi të huaj, që në atë kohë kishte filluar të ngurtësohej në disa kallëpe si formulat e teoricienit Zhdanov, letërsinë sovjetike.

Së dyti, shumica e shkrimtarëve dhe poetëve që shkruan në atë kohë përbëhej më tepër prej militantësh revolucionarë se sa prej poetësh a shkrimtarësh të vërtetë. Pikërisht këta poetë e shkrimtarë mediokër iu përshtatën kallëpeve të një drejtimi që shumë shpejt u shndërrua në një klasicizëm të ri që ishte larg (në kuptimin pejorativ), qoftë nga klasicizmi historik, qoftë nga ai neoklasicizëm që gjalloi në formë elementësh në vitet 30-të.

Në 100-vjetorin e lindjes

LLAZAR SILIQI, PËRFAQËSUESI MË I TALENTUAR I BREZIT TË VITEVE 50-TË

Nga Prof. Dr. Klara kodra

Ndonjë talenti të rrallë iu desh të formohej në luftë me drejtimin letrar që po lindte, duke dalë jashtë rregullave të tij.

Brezi i viteve 50-të nuk arriti të bëhej dot avangardë, siç u bë me një shpërthim të fuqishëm krijues avangarda e viteve 60-të që e rilindi realizmin kritik shqiptar, duke e pasuruar me atome modernizmi, po së cilës iu desh që të fshihej pas mburojës së realizmit socialist që ishte atëherë i vetmi drejtim i pranuar.

Megjithatë, siç thamë më lart, pati ndonjë talent që arriti ta shfaqte vetveten edhe duke pranuar zyrtarisht rregullat e realizmit socialist, i cili vuante nga artificialiteti qysh në fëmijërinë e tij, si fëmijë i dobët dhe shëndetlig.

Një talent i tillë ishte Llazar Siliqi, i cili u shfaq dhe mbeti gjithë jetën e vet poet duke lëvruar zhanre të poezisë epike ose epiko-lirike dhe lirika të mirëfillta, në ndonjë rast duke u afruar me muzikën në krijimin e libreteve muzikore.

Llazari është një poet i lindur që e kishte poezinë në gen. Qe i biri i poetit të njohur rilindas Risto Siliqi që i dhuroi letërsisë shqiptare poemën social-psikologjike dhe epiko-lirike "Mrika në shkandull".

Poeti i ri lëvroi një tematikë dhe problematikë politiko-sociale. Për një



kohë të gjatë nuk arriti të shkëputej nga iluzionet për mundësinë e idealit socialist në të cilin besonte sinqerisht.

Kështu, talenti i tij spontan ngrinte krye kundër pikëpamjeve të gabuara teorike dhe kur e arrinte fitoren u jepte jetë krijimeve poetike të realizuara.

Thelbin e individualitetit krijues të këtij poeti e përbënte lirizmi, prandaj poemat e tij më të realizuara janë poemat lirike, pa subjekt "Prishtina" dhe "Ringjallje". Pranë këtyre poemave mund të vendosim lirika të mirëfillta, të freskëta e të çiltra, që përshkohen nga një zjarr i brendshëm.

Lirizmi i zjarrtë i brendshëm që e digjte poetin si një flakë e pashuar ishte

gjithnjë në luftë me retorikën buçitëse që quhej në atë kohë atribut i poezisë revolucionare, me patosin oratorik që, herë pas here, i jepte poezisë së tij karakterin e një fjalimi agjitativ.

Pikërisht, lirizmi i jepte poezisë së Siliqit, forcën komunikuese, kurse njohja e jetës së gjallë e frymëzonte autorin për detaje të goditura.

Le të kujtojmë portrete dhe tablo nga poemat dhe lirikat e tij, portretin e nënës së dëshmorit që ujit lulet dhe ruan si kujtim të shtrenjtë fotografinë e të birit, portretin e nuses së re që ka humbur fëmijën e vet, qysh në lindje dhe mban në dorë bohçen me pelenat e tij, profilin e rreptë dhe stoik të malësorit që ka humbur djalin e vetëm dhe ndrydh thellë në shpirt dhimbjen për t'i kënaqur mysafirët, tabloja e paharrueshme e Gjirokastrës të spërkatur me një pluhur të argjenditë etj, dhe mund të vazhdonim kështu gjatë.

Edhe në poemat relativisht më pak të realizuara si "Erë pranverore" dhe "Mësuesi" ka fragmente të fuqishme lirike ose dramatike.

Poezia e Llazar Siliqit është më tepër auditive e mbështetur te vargu buçitës dhe shpërthyes (ai i solli poezisë shqiptare për herë të parë vargun e thyer, sipas modelit majakovskian, po ia përshtati talentit të vet), po herë pas here ajo shfaqet si një poezi vizive, përmes detajesh konkrete dhe të goditura.

Llazar Siliqi arrin te poema "Prishtina", një nga poemat më të realizuara që u kushtohen heronjve të kampeve të përqendrimit të Luftës së Dytë Botërore, një realizëm të vrazhdë dhe një thjeshtësi të ashpër që i përshtatet temës.

Le të kujtojmë shkallëzimin e fuqishëm që shpreh në mënyrë sintetike ndjenjat e të burgosurve:

*"Me ditë,
Me javë,
Me muaj,
E pritëm me zemër të fortë,
Na vdekjen".*

Siliqi ndikohet nga poeti i shquar rus sovjetik Majakovski (studiuesi Robert Elsie e sheh krijimtarinë e Siliqit "si miniaturë"¹ të poezisë së paraardhësit rus, po pretendon se shfaqet në një mënyrë shumë më artificiale²).

Poeti ndikohet gjithashtu, siç e vë re edhe Elsie, nga poeti sovjetik Nikollaj Asejev, po thelbi i poezisë së tij mbetet vetjak dhe shqiptar. Gjuha e tij poetike qe gegërishtja që shfaqet në krijimtarinë e Llazarit mundësitë e veta shprehëse, pasurinë e leksikut dhe formave të veta gramatikore.

Nuk jemi aspak dakord me qëndrimin e studiuesit kanadez që nuk e veçon Siliqin nga brezi i vet, po përkundrazi i fut të tërë ata poetë "në një hon artificialiteti".

Llazar Siliqi luftoi tërë jetën për të dalë nga "honi i artificialitetit", nga lëvozhga e ngurtë e drejtimit letrar të realizmit socialist që mbyste talentet.

Dhe këtë gjë e arriti. Ai u ngjit te ajri i pastër i poezisë së vërtetë, te "qielli i pastër" i atdheut, të cilit i këndon te poema "Ringjallje".

Dhe la pas vetes frytet më të arrira të talentit të vet.

¹ Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë: Dukagjini, 1997, f. 383.

² Po aty, f. 382.



Do më pëlqente ta mendoja, se libri "IKONOSTASËT E SHQIPËRISË" është botuar posaçërisht për ata shqiptarë që e kanë në majë të gjuhës shprehjen:

-Shqipëria u bekuua nga Zoti dhe u mallkua nga shqiptarët!!!

Shprehje nga më të rëndat, që mezi ta mban kurrizi! E përsërisin jo rrallë, si një refren në bisedat e përditëshme mes shqiptarësh, vend e pa vend, në rrugë, në kafene, në mbledhje pune e deri në Parlament. Herë e shpallin me trishtim e herë me kënaqësi, duke e pretenduar si një "zbulesë". Në fakt, transmetojnë gojë më gojë një mallkim!!! Lëvdojnë Zotin që nuk e kanë njohur kurrë dhe mallkojnë shqiptarët, gjyshërit e tyre, baballarët dhe veten.

Ndoshta e thonë pa të keq! Por edhe e keqja kështu përhapet, si pa të keq. Mbillet farë sinapi e bëhet pemë, që vështirë të shkulet. Ata duan të thonë, se ne nuk kemi bërë gjë të mbarë e të bukur për vendin tonë, që ta meritojmë të nderohemi e të respektohemi ndër kombe. Me pak fjalë, duan të thonë se ne nuk e duam vendin tonë!!!

Libri "IKONOSTASËT E SHQIPËRISË", është antidot ndaj këtij "mallkimi", si kurse shumë libra të tjerë studimorë para tij. Janë librat që i kushtohen gjuhës sonë arketipale, e cila buron nga kohërat e erta, kur perënditë thirreshin me emrin e tyre të vërtetë, librat për historikun e flamurit tonë kombëtar, ku stampohet një shenjë e lashtë perandorake e po ashtu, librat për kodet e kanunet para ligjit, që rregullonin mardhëniet mes shqiptarësh

Promovimi i librit të Ylli Drishtit dhe Andrea Llukanit

IKONOSTASËT E SHQIPËRISË

Nga Gazmend Leka



e shumë libra të tjerë që nuk i nxënë raftet e bibliotekave tona.

Kaq do të mjaftonte për të kuptuar punët e bekuara të shqiptarit, ku e mira dhe e bukura humbasin kuptim, pasi të bekuara siç janë, shkojnë përtej së mirës

e së bukurës.

Kur ky "soj" shqiptari ta shfletojë këtë libër, do të kuptojnë se ne, kami bërë bukur po ashtu edhe ikonostasët! E them me modesti, se po ta teproj pak, për t'ju afruar më shumë të vërtetës, duhet të them, se i kanë bërë të mrekullueshëm dhe e meritojnë të hynë në fondin e vyer të kulturës botërore!!!

Kur ky "soj" shqiptari ta shfletojë këtë libër, do të habitet se si në një vend me territor kaq të vogël, kanë mbirë kaq shumë të tillë, ashtu sikurse ndodh edhe me kostumet kombëtare, që ndryshojnë nga njeri fshat në tjetrin, që vetëm një gardh i ndan. Kaq shumë ikonostase janë mbjellë, sa mbi 60 të tillë, duket sikur janë shumë e jashtë proporcionit për territorin e vogël dhe numrin e pakët të popullsisë! Vendi ynë që pikëzon në hartë, duket sikur nuk do t'i nxërë këto mrekullira të gdhendura në dru!!!

Kur ky "soj" shqiptari ta shfletojë këtë libër, do të njohin mjeshtrit


e gdhëndjes së drurit, të cilët e bënin ikonostasin si një vepër arti të përkryer, pavarësisht vendit ku do vendosej. Këto kavaleta të mëdhej ikonash, janë kryer po aq bukur, si në kishat e qyteteve të mëdhej, ashtu edhe në kishëzat e fshatrave të humbur e të harruar. Janë bërë me një mjeshtëri të rrallë, si të jenë objekte nga më të rëndësishmit, ashtu si edhe në kishat më të njohura të qytetërimit të besimit ortodoks. Është e njëjta dashuri, përgjegjësi, pasion e profesionalizëm! Filimisht, bërë me mur e më pas me dru. Njeri më i bukur se tjetri!

Ikonostasi i Kishës së Sopikut, kush-tuar shën Marinë, sa për shembull, është i njëjti në thelb me ikonostaset e kishave greke, bullgare, ruse etj.

Kishat, me ikonostasin, ikonat dhe afresket, shëmbellejnë me një libër të ilustruar, ku besimtari e ka më të lehtë të njohë Krishtin, shën Marinë, apostujt, katër ungjillorët, Lazarin që kthehet nga vdekja, të sëmuret që shërohen, darkën e fundit, skenat e pasionit deri në kryqezim e ringjallje të Krishtit. Krahasuar me besimin e parë, të patrazuar e të paprishur nga imazhi, duket si një sakrilegj, si një faj, apo si një gabim, por ky "sakrilegj", për fat, ne na jep mundësinë, t'i trashëgojmë këto kryevepra, që janë sot pjesë e rëndësishme e fondit të artë të kulturës shqiptare. Është pasuria e patundëshme e jona!!!

Kur ta shfletojë këtë libër, ai "soj" shqiptari do të gjejë të gdhendur në drurin e ikonostasit, një nga anarkitë e Nolit, që thoshte se:

(Vijon në faqen 7)



S'ka tjetër, ku njeriu ta lërë veten më shumë, se sa tek e shkruara. Në memoristikë, nëse kujtimet karakterizohen nga një lloji vetëdeklarimi pa dëshimtarë, zëre se ke bërë një selfije. Kur autori identifikohet me një kronikan ngjarësh me interes publik, ai merr vetvetiu atributet e një protagonistit, ngjall interes, sikurse po ndodh dhe me librin e Pashko R. Camajt "Porosia e kullës". (Sipas të drejtës zakonore, nëse pema i hedh degët në rrugë, frutat u përkasin kalimtarëve.) Jeta e autorit nis nga kulla e frengjive, guri i rëndë në vend të vetë, për të vazhduar tek xhamllëku i gradaçielave, ku botën e sheh si në pasqyrë. Ti e ndjek rrëfimin e tij, kurjoz të dish: cilat janë raportet e kullës së gurtë të etërve, ku të gjithë njohin të gjithë, me kullën e qelqtë të botës së lirë, ku namin ta jep sukcesi? Në variantin anglisht libri titullohet "Ëndërrime nga bagazhi i një veture amerikane", ndërsa në shqip "Porosia e kullës", ku ëndrra flet anglisht me drejtimin për nga e ardhmja dhe porosia vjen prej së shkuarës në shqip. A ka ndonjë urë lidhëse mes tyre apo në miniaturë tek "emigranti" shfaqet silueta e "moikanit të fundit"? (Shpesh historitë e kullave kanë një fund tragjik, sikurse ajo e Mic Sokolit, e Oso Kukës, qoftë dhe e Gjon Markagjonit, përjashtoj kullat e vrojtimit.) "Deri më sot, shumica e ëndrrave të mija më kthejnë në ato ditë të hershme kur nuk kishim asgjë, por as që nuk na nevojitesh shumë për të mbushur ditët tona."-shkruan autori "në formën më të bukur të mundshme", sikurse vë në dukje i vëllai përkthyes, duke shtuar: "përmes këtij përkthimi rinjoha vëllanë tim". Sepse s'ka tjetër ku e shfaqim veten më shumë se sa tek e shkruara. (Jemi mësuar, që, rinjohja e vëllait të ndodhë në balada gjatë dyluftimeve, ja që ndodhka dhe në shkrime.)

Në shumicën e faqeve të librit dominon retrospektiva, ku malli e bën të vyer dhe varfërinë. Në përshkrimin e autorit kulla prej guri ishte e lyer nga brenda me gëlqere. Dyshemeja prej dheu të ngjeshur me kalimin e kohës forcohej nga të shkelurat duke u çimentuar. Aty ishte vatra ku gatuhej dhe hahej. (Aktualisht autori është sekretar i "Vatrës" në Amerikë.) Zjarri ndizej në mes të shtëpisë, si oxhak i hapur dhe tymi nxinte trarët. Mbrëmjet ndriçoheshin nga një llambë vajguri. Kjo është kulla, e cila nuk të fton për të jetuar dhe çfarë porosie mund të vijë prej saj? (Rexhep Qose në librin e tij studimor me titull "Porosi e madhe" i përkushtohet Naim Frashërit, ku mesazhet e poetit i artikulon si porosi për kombin. A përputhen porosinë e kullës me ato të poetit tonë kombëtar?)

"Porosia e kullës" është ndër librat që publiciteti po e shoqëron, qysh prej daljes në treg, ende jemi në jehonën e tij, përkundër tipit të autorit, i cili përpiquej të bëhej sa më i padukshëm. Kujt i fshihej? "Kjo ndjenjë më ndoqi më vonë në jetë. Nuk kam dashur kurrë të jem në krye të linjës. Preferenca ime ishte t' i lija të tjerët më ambiciozë dhe më lakimtarë." Dhe kur i rastisi të dilte në një skenë amatore zë rreshtin e fundit të korit. Ndërsa për të atin do shkruaj: "Ai ishte një njeri i përrullur që nuk kërkoi kurrë vëmendje, megjithatë ai sapo ishte bërë një hero i menjëhershëm për të gjithë ne në atë dhomë, por veçanrisht për mua, një hero për përjetësinë." Ç' kishte ndodhur? Qendra e shkretë e Tuzit, ku tashmë ngrihet dhe shtatorja e Gjergj Kastriotit, ishte e shkretë, sikurse ndjenjat e prindërve të tij. "Ai i njohu të dy burrat dhe vuri re se në duar kishin revolver. Ata po ecnin drejt njeri-tjetrit duke hedhur fjalë-fjalë që burrat nuk ia thonë burrave të tjerë duke pritur të mbijetojnë. Pa një mendim të dytë, instikti

Libri "Porosia e kullës", i autorit Pashko R. Camaj

NGA GURËT E KULLËS TEK XHAMLLËKU I QIELLGËRVISHTËSEVE

Nga Fatbardh Amursi

i tij e tërhoqi babain tim drejt dy burrave. "Pse armët o burra-për çka u duhen armët? Burrat nuk i zgjidhin mosmarrëveshjet me armë!"-Krahët e hapur të babait tim drejtoheshin nga qielli, ndërsa ai përpiquej t' i bindte të ndalonin çmendurinë e tyre menjëherë. Në botën tonë të Malsisë, dihej se kur një njeri hyn në një mosmarrëveshje të këtyre për t' i dhënë fund konfliktit, respektohet përgjithmonë... "Për hir të zotit, për nderin e familjeve tuaja, mos e bani kta! O njerëz të mirë hiqni revolet e të flasim si"...Babait tim iu ndërpre në fjalët e lutja për armëpushim kur njeri prej tyre u qëllua nga një revole, e ndjekur nga një breshërimë plumbash nga të dy burrat... plumbat depërtuan nëpër pallton poliester dhe shpuan trupin e babait tim." Gjeka dhe Rroku ishin produkt të një shoqërie që s' e pranonin poshtërimin. Përherë nderi i panjollorur i malsorit ka kosto të lartë, aty ku fjala vret apo sedra njollos burrërinë. Gjithsesi, drama nuk u kthye në tragjedi, pasi të tre mbetën të plagosur. "Ky është një sulm ndaj vllaznisë tonë dhe ne do të

hakmerremi"-po nguteshin njerëzit e fisit të babait. Zinxhiri i hakmarrjes rrezikonte ta zgjeronte rrezën e konfliktit. I ati arrin t' i shuajë gjakrat dhe në kullë shtron një dreckë, ku ishin të ftuar dhe Gjeka me Rrokun. Kësisoj hasmëria kthehet në vllazërim. "Zoti ka vendosur të kursej jetën time dhe të këtyre dy burrave fisnikë"-janë fjalët pajtuese të babait të tij. Kjo është porosia e parë që vjen nga kulla për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Ja, si e trashëgon i biri: moralin e të atit, ku aspirata për ta bërë krenar babanë s' rresht tek ai. "Nuk kam pasur mëri e mlllef as ndaj qenit që më kafshoi."-shkruan ai fisnikërisht. Por të tillët lëndohen dhe më shumë, shpesh prej atyre, që përfitojnë prej tyre. Kur i biri i kujton se është e premtë dhe se s' duhet të hanë mish, i ati i përgjigjet se nuk është mëkat ajo që hamë, mëkatore janë fjalët që të ligjtë nxjerrin nga goja, duke e këshilluar: "Kurrë mos merr diçka që nuk të përket. Mos e sill në shtëpi atë që s' është e jotja". Pak po ju duket kjo porosi në kohën kur korrupsioni po e kthen vesin

e hajdutrisë në një kredo për pasurim? Po gojë mëkatore, sa e sa lëndojnë?

Shihni një përshkallzim interesant, ku shoqërohet rritja e tij në moshë. Fëmijëria nis me një top prej lecke, më tej duket se po bëhet më e gëzueshme me topin kinez prej ilitiku dhe kur i ati i sjell një top futbollit italian, do e pyes të birin se ç' kishte dëshirë të bëhej, kur të rritej. Futbollist dhe të luante me një skuadër të madhe, ishte përgjigja e tij. "Por skuadrat e mëdha janë shumë larg. Çka do të bësh ti kur ne të plakemi? Ti je më i vogli ndër katër djemve dhe ti e di se prindja i takon djalit më të vogël."-Ndërkohë topi do i kthehej në një glob, që rrotullohet dhe bashkë me të: fati i tij. "Në fundjavë para se të lirohesh nga ushtria, shkova në qytet dhe bleva një komplet xhinsi, një palë çizme dhe një xhup që e kishte të printuar USA në pjesën e përparme." Sigla USA një shenjë e rastit të ishte, pasi fëmijëria dhe rinia e tij kishte kaluar nga topi i leckës, tek ai kinezi prej ilitiku dhe në fund topi i futbollit italian? Po e thërriste bota e madhe. Ai që mbante themelet e kullës ishte babai, ndërsa ai që duhej të mbante babanë e plakur ishte i vogli i katër djemve tek i cili po vlonte dëshira për aventurë. Befas shfaqej një dramë. Është e njohur "lufta e brezave", konflikti etër e bij, por në libër babai mbetet përherë një idhull për djalin. Ndaj ai vuan dilemën: a i ka tradhëtuar paraardhësit e tij, ku vendin e kullës se gurtë do e zinte gradaçela e qelqtë? (Në Tiranë kullat mbajnë në sherr politikën.)

Kulla përfaqëson vendlindjen dhe më tej atdheun. Rrëfyeti duhet të lërë një shtet të prapambetur për të shkuar në shtetin më të fuqishëm dhe më të pasur të botës, duke u larguar nga kulla e të parëve, nga trojet stërgjyshore. Kujtoni fjalët e të atit: "Kam frikë për këtë vend. Kam frikë për ty, Çoço ... Nuk jam i sigurt se "plaku" (Tito, i cili do të vdiste në pranverë e ardhshme.) mund t' i mbajë në qetësi ma këto armiqësi?" Parandjen kohën e trazirave, përgjakjen e Ballkanit Perëndimor. Dhe më tej urtësia flet me gjuhën e së vërtetës: "Plaku nuk është i mirë, por asht më i mirë se pjesa tjetër e tyre dhe se është i vetmi që mund t' i mbajë në kontroll." Natyrisht që ne heqim paralele me diktatorin tonë, i cili i hapi namin vetes si lider botëror, por ndikimin e Titos nuk e kishte. Kjo paralele ndihmon për të kuptuar se Lindja, pavarësisht veçorive udhëhiqej nga i njëjta mentalitet. Nuk është rastësi dalja e Milosheviçit fill pas vdekjes së Plakut (Titos), sikurse e parathotë orakulli i kullës. Në këtë libër mësova se paska patur dhe burra vajtor, tek ne njihen vajtosat, sikurse babai i Pashkut, i cili do përndiqet nga hafijet e regjimit, për shkak të këtij vajtimi:

Oh, lajm i zi na vjen nga Azija,
Thonë se ka vdek aij Mul Delia,
E kanë me dvet si asht Malsia,
E kanë me dvet se asht Shqipnia,
E thuaj se asht zi e ma zi,
Se na ka ardh ne nji parti,
Që s' don kisha e s' don xhami,
Tretja zot farën e tij,



PASHKO R. CAMAJ

Porosia e kullës

Parathënie nga Besnik Mustafaj

OnufriKujtime



E na ka ardh një mret pa emën,
S` dim a është mashkull a asht femër?!”
Pasi e lidhin në trugun e një peme, e
lënë pa ushqim, do i thonë: “Ti kurrë nuk
do të flasësh kështu ndaj udhëheqësit tonë
të madh dhe nese e bën, kjo nuk është asgjë
në krahasim me atë që do të ndodhë me ty.”
Pashku kujton dhe një episodë kur ishte
nxënës: “Ajo nuk kishte aftësi për të mësuar
të recitonte një poezi të shkurtër për
“udhëheqësin e madh” të vendit komunist,
që aso kohe ishte e detyrueshme”, por
mësuesi e detyron të dalë para klasës. Nga
frika vajza urinon. Sa therëse janë këto
fjalë: “Ne qeshnim me jetën tonë, thjesht
për të shmangur të qarat.”

Emigranti Pashko R. Camaj nuk është
një i “ikur për modë”, sikurse u shpreh
Primo Shllaku për një prirje të sotme, por
një i përzënë, sikurse ka ndodhur në trojet
tona dhe duke i shpërngulur me dhunë.
Pra, një i ikur nga e keqja, i përzënë prej
së keqes. “Mosbindja ndaj shtetit do të
thoshte lehtësisht vdekje.”-shkruan ai
për gjyshin e tij, Pjetrin, i cili figuronte në
listën e “armiçëve të vllaznisë komuniste”,
duke qenë në fakt “armik i së keqes”. “Unë
i njoh mirë ata njerëz. Ata nuk mësojmë.
Ne duhet t`i dërgojmë të gjithë mbrapa
në Shqipëri.”-tha profesor Çaviq, si një
nga shkaktarët e largimit të tij nga kulla.
Është fatkeqësi që akademikë serb kanë
shkruar doktrina genocidi, shfarosje të
kombëve të tjera, që reflektohet dhe tek
profesori i Pashkos. Në oborrin e vejushës
së një heroi të dekoruar të Luftës së Dytë
Botërore ndodh ky episod përballje: “Ne
nuk e kaluam kufirin. Të tjerët e vendosën
kufirin aty ku janë. Kemi qenë aty prej
shekujsh zonzj!”-të duket si një ligjërim
nga drama “Epoka para gjyqit” të Ekrem
Kryeziut. Askush nuk donte t`ia dinte se
kush ishte, pasi nuk isha ai që ata donin.
Përherë në një mjedis armiçësor. U rrit
duke e patur Shkodrën në sy, dy kilometra
larg fshatit të tij. Konflikti thellohet, kur ai
largohet pa leje nga repartit për të takuar
të dashurën fshehurazi dhe e demaskojnë
si të ishte një dezertor luftime: “Të dashur
ushtarë trima, punëtorë, shikoni këtë
njeri, mjekun tonë, një turp për të gjithë
ne. Ndërsa ju punoni për të ndërtuar
bashkim-vëllazërimin dhe unitetin tonë,
ai po na minon të gjithëve!” Ata shqiptarë
që u besonin mos po ndihen ca më shumë
sot, duke futur armiçësi mes nesh, duke
mos njohur Porosinë e Kullës, por të atyre
që i urdhëronin? I rritur në Malsinë që nuk
e duronte poshtërimin, ai shprehet: “Kur
më kaloi poshtërimi fillestar që ndjeva, më
pushtoi ideja se ky vend ishte i dënuar. Unë
u trajtova në këtë mënyrë se s`isha njeri
prej tyre. Unë isha nga ata shqiptarë që
nuk mund t`u besohej.” Tualalet i ndotur në
stacionin e trenit të Zagrebit, ku në mur
shkruheshin lloj-lloj, tekstet i unifikonte
urrejtja. “Të gjithë duke se ishin dakort që
Kosova dhe populli shqiptar në Jugosllavi
ishin zuzarët e vendit.”-shkruan ai. Një
detaj i mrekullueshëm kur e gjithë kjo
ndyrësi dilte nga goja e një haleje! Dhe “me
arritjen e moshës madhore do të kuptoja
se kjo ishte arsyeja që do të më shtynte të
largohesha përgjithmonë nga vendlindja.”
Apo: “Ishte ajo kohë kur unë kuptoja
se lumturia jonë shkatërrohej lehtë...
Pothuajse çdo gjë që na e sillte jeta kishte
mundësinë të na i thyente zemrat tona të
brishta.” Aty ku lumturia shkatërrohet
lehtësisht dhe zemrat e brishta thyhen, a
mund të shpresohet një jetë më e mirë?

Fill pas luftës në Mitrovicë ekspozimi
ndaj plumbit ishte në nivelet më të larta,
shkruan ai nga pozita e një kërkuesi
shkencor, duke u rikthyer në trojet tona,
si një i dërguar i Nolit: “Nëno mos kij frikë
se ke djemtë në Amerikë!” Shumica flisnin

anglisht, por ai u flet serbisht dhe shqip për
të marr “rolin e një paqeruajtësi”, sikurse
kishte bërë dhe i ati i tij me Rrokun dhe
Gjekën. Por i duhet të përballet dhe me
të vërteta, që mbajnë pezull dhe dilemën
e tij karshi porosive të kullës. “Shumica
prej jush që keni patur fatin të largoheni,
ktheheni këtu vetëm për të shitur shtëpitë
ose tokat tuaja, mblihdni parat pastaj
fluturoni mbrapa. Fluturoni përsëri në
Amerikën tuaj. I shpenzoni paratë për
të blerë shtëpi apo ndonjë makinë të re.”
Dashamirësia e tij has dhe refuzime: “Unë
nuk u jap (mostra gjaku) skiptarëve dhe
atyre që bashkëpunuan me NATO-n për
të bombatuar qytetet tona dhe për të
helmuar fëmijët tanë.” Qëllimi i punës
së tij shkencore t`u shërbente të gjithë
banorëve, pavarësisht kombësive, për t`i
pastruar nga plumbi apo nga ndotja e
luftës. Ja që helmi i urrejtjes në Ballkan
qenka i vështirë të pastrohet?!

“Kur errësira e bagazhit të makinës
gëlltiti diellin, më kapi paniku.”-shkruan
ai para se të kalonte kufirin e Meksikës
për në SHBA. Dhe më tej: “Jetët tonë ishin
në dorën e njerëzve që nuk i njihim. Nuk
kishim asnjë që të na fliste e të na qetësonte
ankthet.” Përherë në përballje me të
panjohurën. Porosia e trafikantëve: të mos
shikonin askënd në sy, duke u përpjekur
të bëheshin sa më të padukshëm. E njihite
rolin e të padukshmit edhe pse rrethanat
e evidentonin. Një i huaj në tokë të huaj
i qeverisur nga të huaj dhe në trojet e tij,
duke mos ditur se çfarë vjen pas, guxon të
ndryshojë fatin e tij. “Pavarësisht ëndrrave
të mija të përealizuara, kisha arritur t`ia
pranoja vetes se sa kishin ndëshkuar
dështimet në përcaktimin e fatit tim. Ato
punuan për mua.” Vetëm një njeri vital
ia del: dhe kur erën e ka kundër, dhe kur
koha s`punon ende për të. I rritur në një
klime armiçësore nuk e shterr betejën për
të arritur paqen. Shef Zeka e kqyrte punë
e tij si bojaxhi pa i rënë në sy, duke pëlqyer
energjinë dhe përkushtimin në punë, ndaj
nga 5 dollarë në orë do e paguajë me 8
dollarë, duke i shkatërruar dhe mitin që ai
kishte pët bosët borgjez. Edhe shef Zeka
kishte patur dështime në jetë, sikurse
ëndërra e tij e hershme të bëhej diplomat
i lartë dhe të ndikonte në zgjidhjen e
konflikteve midis njerëzve dhe kombeve.
(Nga 5 dollarë që paguheshin të tjerët
në 8 dollarë për Pashko R. Camajn është
një tregues dhe për librin me kujtime, që
dallon nga të tjerët. Sepse autori nuk di të
bëjë hile, nuk urren, falë, nga që udhëhiqet
nga porositi e të parëve të tij, nga
Porosia e Kullës, nda nderi i panjollësor
i malsorit.) Kujtimet nuk i sheh si një
“udhëtim përfundimtar të egos”, por, si
një ndërthurje të trashëgimisë me shpirtin,
sepse përherë ka diçka më të vlefshme
nga ato materialet, që zbehen dhe u vjen
radha të zëvendësohen. (Kujtoj vilën e një
manjati amerikan e kthyer në një park për
vizitorët. Në dhomë kishte një mumje të
ballsamosur, marr në Egjipt. Nuk lejohej
ta fotografoje. Mumja dukej sikur ishte
pronari i asaj shtëpie, që dikur kish zgjuar
kureshtjen dhe lakmitë e sa e save për të
jetuar mes luksit. Frikshëm ngrihet pyetja:
po në kullë kush jeton?)

“Amerika të marrtë me të mirë!”-ishte
urimi i parë i mirëserardhjes, që atij i bën
kur shkeli në “tokën e premtuar”. Duket
sikur libri i Pashko R. Camajt mbyllet
me një happy end, sikurse lëvdohen dhe
arritjet, sukseset e tij në Amerikë. Sikurse
e thamë dhe në fillim, ai nuk u përket
atyre njerëzve që e kanë mendjen tek
vetja dhe libri që shkruan nuk i bën fresk
egos së tij. Aty ndihet “pesha e kryqit”,
ndihet përgjegjësia ndaj një amaneti, ndaj
porosisë së kullës. Dhe jo vetëm e tija...

(Vijon nga faqja 5)

- Në vendin tonë ka disa fe, por asnjëra prej tyre, nuk ka zënë vend në zemrën e një populli pagan.

Ikonostasi, i tillë është ndërtuar, si një anarki në rregull. Është mbushur me imazhe pagane e imazhe monoteiste, që jetojnë në harmoni sëbashku, pa i bërë karshillëk njera-tjetrës. Është gdhendur si një kopësht parajsë, me një bimësi të dendur e të harlisur. Motivet floreale mbushur me gjethe, janë populluar me plot zogj, me pëllumba, me dragoj e qenie mitologjike. Këto gdhendje të mrekullueshme bëjnë sfond, si një mërmërimë kori “a-cappella”, ku mbi të shquhen zërat e bukur të ikonave, figurat e besimit kristian, të praruar me të arta! Të dy këto imazhe, rrinë jo në konflikt me njera tjetrën, ashtu sikurse është larg fanatizmit dhe vetë e vërteta e jetës.

Zoti që na paska bekuar dhe shqiptari që na paska mallkuar, tek ky objekt takohen. Fjalosen me njeri-tjetrin. Takohen aty ku është kufiri, ku ndahet dhoma e “shenjtë e të shenjtave” me dhomën e besimtarëve e profanëve kuriozë, prandaj dhe mjeshtëria aty është derdhur me tepëri!

Kur ta shfletojë këtë liber, ai “soj” shqiptari do të njihet me portat e bukura të bëra bukur!!! Do rrijë përpara tyre, nese shkon në kishë, qoftë edhe si kureshtar dhe do tundohet t`i shtyjë që të hyjë brenda. Pa dyshim që duke i soditur ato, do të pendohet për fjalet që ka thënë mendjelehtësisht. Do ta tërheqin mallkimin e do e kthejnë në mallëngjim!

Por libri nuk është botuar vetëm për ata që nuk njohin të bukurat e të mirat e shqiptarit, por për të gjithë ne!!!

Dy autorët e librit, z.Ylli Drishti dhe z.Andrea Llukani, janë të kujdesshëm, për të evituar kohën kur Shqipëria ra në kaos, kur disa nga këto kryevepra u vodhën, u sharruan, u coptuan e u shitën ku të mundnin. Humbën pa nam e nishan!!! Më e rënda është, se janë shitur jashtë kufijve, për të mos u kthyer më kurrë. Ishte një kohë e mbrapshtë, vit zero, kur këto perde druri u çanë, po njëlloj si në kohën kur u çapa perdja prej cohe, në hyrjen e “Sanctum Sanctorum” të tempullit të Jerusalemit, në çastin kur Krishti dha shpirt.

Autoret kanë punuar një kohë shumë të gjatë, për ta ngjizur këtë vepër të vyer. Këtë material të madh e kanë gjurmuar kishë më kishë, në të gjitha trevat shqiptare. E kanë fotografuar, seleksionuar, renditur, përshkruar, analizuar për të na e sevirur ne. E kanë latuar me shumë kujdes, siç lathet një diamant, për ta bërë me dritë gurin e egër!!! Dikur këta lloj studiuesish, mbledhës nektari, quheshin At Shtjefen Gjeçovi, Thimi Mitko, Rrok Xois apo Qemal Haxhihasani. Është i njejtë stil pune, si tek shumë e shumë të tjerë, që mblodhën e bënë bashkë punët e mira a të bukura të shqiptarit në shekuj.

Ky libër do na japë mundësinë, që të ulur në dhomën e ngrohtë të shtëpisë, të shohim e të njohim fletë pas flete, dhomat e kishave, zbukuruar me këto perde të magjishme. Çdokush nga ne, do ta kishte të vështirë të bridhte e t`i gjurmonte anë e mbanë vendit këto objekte. Fare lehtë, ne i shijojmë, kënaqemi, ngazëllememi dhe bëhemi dëshmitarë të ngjarjes, në sajë të këtij libri. Ardhja në jetë e një ikonostasi ishte ngjarja më e madhe për besimtarët e kishave dhe kishëzave dhe ky libër, me dëshminë e tij na bën të gjendemi në mes të asaj ngjarje, duke u mahnitur me magjinë e lindjes së një kryevepre!!!

Libri na jep mundësinë t`i afrohemi e të shohim detajet deri në detaj. Kjo do të ishte e pamundur në jetën reale.

I formuluar siç është, ka formatin e një enciklopedie. Materiali është sistemuar, renditur, pasuruar me planimetri dhe imazhe, me vendodhje, me kohëndodhje e shumë shpjegime të domosdoshme. Përvçse është një libër i çmuar në vetvete, është edhe një libër stafetë, sikurse janë të gjithë librat studimorë.

Vetë autorët, për të realizuar këtë vepër-kryevepër, janë mbështetur në shumë analiza dhe studime pararendëse nga hulumtues e studiues të tjerë, por ky që kemi në dorë sot ka një veçanti. Është një studim gati shterrues dhe i vetmi kaq i plotë në Shqipëri deri më sot!!!

Autoret janë treguar të kujdesëshëm që ta pajisin studimin me një bibliografi të pasur, si alibi për të rrëfyer se ku janë mbështetur dhe mëkuar për t`i dhënë jetë vepërës së tyre. Bibliografija u jep mundësi dhe studiuesve të tjerë të njohin parardhësit e tyre që kanë hulumtuar në analizën e këtij objekti të çmuar. Gjithashtu, ata e kanë plotësuar edhe me një fjalorth shpjegues për dashamirësit që nuk njohin termat specifike.

Nuk më ngelet gjë tjetër, veçse të falenderoj z.Ylli Drishti dhe z.Andrea Llukani, për këtë vlerë të rrallë që po sjellin në bibliotekat tona!!!

Tiranë, 17 shtator 2024



Kam në duar romanin “Eskadronët e vdekjes”, të autorit Bardhyl Mahmuti, të përkthyer në gjuhën italiane nga shkrimtarja Ismete Selmanaj Leba. Ky libër, që po përkthehet në disa gjuhë, është konsideruar nga Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës si vepra më e mirë, që pasqyron gjenocin serb ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Autori ka kapur një temë shumë të rëndësishme, që është trajtuar edhe nga autorë të tjerë. Por romani “Eskadronët e vdekjes” ka një forcë të veçantë edhe për faktin se autori e ka ndërë mbi kurrizin e tij egërsinë e gjenocidit serb, duke qenë i burgosur nga ana e tyre për shkak të një interviste në televizion, ku ai kundërshtoi me forcë një eksponent serb, i cili deklaronte se kosovarët nuk duhet të krijojnë një republikë të tyre, si dhe për pjesëmarrjen e tij në demonstrata. Duke i njohur mirë gjakatarrët serbë dhe kasapin e Ballkanit Slllobodan Milloseviç, autori ka mundur të fusë në duar dokumente të rëndësishme, fakte për ngjarje dramatike e tragjike, dëshmi të shumta, të cilat kanë përbërë lëndën e parë të rëndësishme për ndërtimin e kësaj vepre letrare. E, mbi të gjitha, vepra fiton forcë të veçantë, sepse autori ka bërë që serbët të dëshmojnë me gojën e tyre krimet e pashembullta që kanë bërë mbi popullsinë shqiptare në Kosovë. Kjo i jep romanit një vërtetësi më të madhe e një autenticitet të jashtëzakonshëm.

Një skuadër vdekjeje i referohet një grupi njerëzish të armatosur që veprojnë me qëllimin e vrasjes së civilëve, zakonisht të paarmatosur, për qëllime politike. Lufta e Kosovës ishte një konflikt i zhvilluar nga shkurti 1998 deri më 11 qershor 1999 dhe përfaqëson një nga luftërat më të mëdha e më të përgjakshme jugosllave. Ndër shkaqet kryesore të armiqësive ishte përcaktimi i statusit të Kosovës si shtet i pavarur, që deri atëherë i përkiste Republikës Federale të Jugosllavisë.

Konflikti shqiptaro-serb i ka rrënjët më të hershme, që në dëbimin e shqiptarëve në vitet 1877 dhe 1878 nga zonat që ishin përfshirë në Principatën e Serbisë. Tensionet ndërmjet komunitetit serb dhe shqiptar në Kosovë vazhduan gjatë gjithë shekullit të 20-të, për më shumë se njëqind vjet, duke sjellë një dhunë serioze në disa raste, veçanërisht gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913), Luftës së Parë Botërore (1914-1918) dhe Luftës së Dytë Botërore (1939-1945).

Thënë këtë, autori Bardhyl Mahmuti, një zë i rrallë autorial, unik në panoramën diplomatike, në mbrojtjen dhe paraqitjen e së vërtetës, të së drejtës demokratike dhe të çështjeve kombëtare, drejtuar zyryave të ministrive dhe organizmave ndërkombëtare, na kthen pas, deri në ato ditë, në ato momente kur lufta e Kosovës ishte bërë temë qendrore e agjendave politike e mediatike, si një emër që pushtoi botën, me dëshminë e rezistencës më të madhe për të arritur vlerën hyjnore, lirinë.

Autori, duke bërë përshkrimin e së vërtetës me detaje të momenteve tragjike, sprovave makabre dhe sakrificave masive, nxjerr në pah mesazhin se liria në thellësitë e shpirtit popullor të Kosovës i ka mposhtur disa herë ligjet e natyrës, duke dëshmuar epërsinë shpirtërore të rezistencës, krahasuar me dimensionin fizik, si vlera më e lartë vlerësuese e mbijetesës.

Romani “Eskadronët e vdekjes”, përveçse një vepër letrare me vlera të mëdha dokumentare, ka ruajtur cilësinë e rrëfimit artistik, pa tjetërsuar autenticitetin historik. Teknika e rrëfimit, vazhdimësia strukturore e romanit dhe, mbi të gjitha, sinkroniteti kronologjik i kapitujve të librit e bën gjithçka më të kuptueshme dhe gjuha e autorit shquhet për transmetimin e saj të thjeshtë, të pastër dhe të qartë.

Në këtë roman autori Bardhyl Mahmuti hedh dritë mbi ngjarje reale, duke na rrëfyer për njerëz realë, jo personazhe imagjinare.

“Eskadronët e vdekjes”, të autorit Bardhyl Mahmuti

NJË VEPËR E FORTË, QË DENONCON GJENOCIDIN SERB NË KOSOVË

Nga Rudina Muharremi Beja

Ai flet drejtpërdrejt dhe me guxim për intrigat shtetërore, manipulimet mediatike të kohëve moderne dhe dokumenton me mjeshtëri artistike një realitet shqetësues. Kësaj romanit “Eskadronët e vdekjes” bëhet një dëshmi e hollësishme dhe e drejtpërdrejtë e krimeve shtetërore serbe ndaj të gjithë shqiptarëve në përgjithësi, por edhe ndaj disa intelektualëve serbë, që patën guximin e ndershmërinë të ngrinin zërin e të dëshmonin kundër gjenocidit në Kosovë.

“Letërsia nuk ka asgjë për t’u thënë atyre qenieve njerëzore që janë të kënaqura me atë që kanë, që ndihen mirë me jetën siç e jetojnë. Letërsia është ushqim për shpirtin rebel, lajmëtari i antikonzervatizmit, strehë për ata që kanë tepër shumë apo tepër pak në këtë jetë”, ka shkruar nobelisti i njohur Mario Vargas Llosa. Në këtë kontekst, romani i Bardhyl Mahmutit na mëson se në kohë iluzionesh masive, mbrojtja e së vërtetës është një akt revolucionar. Në faqet e librit ka tragjedi të panumërta fatesh individuale e familjare, të dokumentuara me njolla gjaku dhe imazhe martirësh. Ngjarje që trondisin thellë ndieshmërinë njerëzore.

“Skuadronet e vdekjes” është një libër që të lë pa gjumë dhe të zhyt në mendime. Një libër i pazakontë në të gjitha aspektet.

E veçanta. Tronditëse deri në thell. Ajo shkon përtej kufijve të një romani me saktësinë e rikrijimit të një bote që ishte aq e pranishme në jetën e shqiptarëve të Kosovës, por edhe përtej tyre. Një kërkim kaq i pafund, një fushë kaq e gjerë, ku lëvizin personazhet e vërtetë, emrat e vërtetë, duke ruajtur gjithmonë ndieshmërinë tematike e artistike.

Shumë nga protagonistët e kalvarit kosovar të viteve 1990 nuk jetojnë më.

Ja pse dokumentimi i historisë së asaj epoke të sakrificave të përgjakshme dhe të tragjedi individuale e kolektive përmes fjalës artistike është detyrë. Brezat e sotëm e veçanërisht ata të ardhshëm kanë nevojë ta njohin këtë të vërtetë, që ajo të mos përsëritet. Bota ekziston dhe shkrimtari flet. Kjo është letërsia.

Siç e preka pak më sipër, autori Bardhyl Mahmuti ka mundur të gjejë mënyrën më të mirë për t’i treguar dhe dokumentuar ato ngjarje të dhimbshme të popullit shqiptar të Kosovës, mëpërmjet rrëfimeve dhe këndvështrimit të vetë serbit. Autokritika, vetërrëfimi, kërkimi i provave dhe publikimi mediatik i së vërtetës nga personazhi kryesor (gazetari Mifi-Miroslav Filipoviq) rikonformojnë kundërshtimin e protagonistit ndaj regjimit totalitar, represionit despotik dhe censurës diktatoriale të lirisë së fjalës dhe të vërtetës së realitetit.

Gazetari serb vuan në qelitë e burgut për të vërtetat që ka shpallur, ndërsa propaganda dhe politika serbe mundohen t’i minimizojnë ato dëshmi, madje t’i quajnë frut të një fantazie të sëmurë të dëshmitarit që ka patur guximin të flasë e t’i kundërvihet politikës serbe ndaj shqiptarëve.

“Skuadrat e vdekjes”, që është kronika e një masakre e shkruar nga Bardhyl Mahmuti, na fton për të prekur plagët e hapura dhe për të reflektuar se si krimet e tmerrshme kanë mbetur të pandëshkuara deri më sot. Autori i shndërron heshtjet në fjalë. Asaj që është e pashqiptuar i jep zë. Ne i kemi harruar pothuajse plotësisht ato tmerre, ndërsa të rinjtë keqinformohen në mënyrë indirekte ose informohen në mënyrë sipërfaqësore, në një kohë kur vetëdija e tyre duhet të bëhet më e qartë se kurrë, sepse



janë ata që do të mbrojnë lirinë e Kosovës, fituar me gjak e sakrifica, dhe do të çojnë përpara çështjen kombëtare.

Ky roman sigurisht ka nevojë për kohën tonë. Gërshetimi i rrjedhave të të vërtetave historike të dokumentuara, të konceptuara si tematika e romanit, përcjell një paralele të dukshme me mentalitetet kriminale absolutiste. “Gjërat duhen thënë ashtu siç janë dhe është e vetmja mënyrë për të shpëtuar kombin nga njolla e krimeve të kryer nga pushtetarët”, shkruan autori.

Është jashtëzakonisht e vështirë të anashkalosh një paragraf ose një fragment të faqeve të librit. Talenti metodologjik i autorit manifestohet nga një vëmendje e veçantë reflektuese dhe fjalor tingëlues. Portreti i personazheve demokratë dhe në dukje oportunistë me virtyte të ndërgjegjes, me ndienjen e përgjegjësisë kolektive dhe metribute të moralit intelektual e njerëzor, në librin e autorit përputhet me një korrektesë dhe autenticitet të jashtëzakonshëm dhe me respektin për integritetin e tyre personal ndaj ortekut të propagandës serbe.

Gjatë leximit, lexuesi, pothuajse në mënyrë të pashmangshme braktis plotësisht veten në thellësi të përshkrimeve dhe të fuqisë dramatike të dialogëve. Prandaj nuk është rastësi që autori e nis romanin me një kujtim të kohës së Hitlerit, të veprimtarisë së drejtuesve të ushtrisë së tij për të shfarosur hebrenjtë, pra për të zgjidhur një herë e përgjithmonë problemën e ekzistencës së tyre. Nuk bëhet pa një qëllim të caktuar ky paralelizëm, por sepse politika e sotme serbe, na kujton nazizmin e dikurshëm, që solli aq tragjedi mbi globin tokësor.

Kosova, krahina e fundit e mbetur e krijimit artificial të quajtur Jugosllavi, luftoi në mbrojtje të sistemit të vlerave civile dhe të së drejtës themelore për liri dhe pavarësi, për të patur republikën e vet të pavarur. Përmes këndvështrimit të protagonistit dhe të vetëreflektimit të personazheve publike serbe, autori apelon dhe stimulon ndërgjegjen e të gjithëve.

Rrëfimi, leksiku dhe konsistenca informative vendosen me afinitet në tregim. Mentaliteti propagandistik serb dhe e vërteta ishin të largëta sa dy pole të kundërta, ndërsa autori i romanit “Eskadronët e vdekjes” e hedh poshtë këtë koncept. Ai e ka jetuar mbi lëkurën e tij këtë tragjedi.

Pasi lexon këtë roman të autorit Bardhyl Mahmuti, mëson se gjaku i viktimave të pafajshme nuk mund të fshihet aq lehtë sa kishin menduar krijuesit serbë të një holokausti të ri dhe aq më pak mund të harrohet. Ndaj i ftoj të gjithë ta lexojnë për të pasuruar së pari njohuritë e tyre.

Mendoj se meriton komplimente përkthyesja e librit në gjuhën italiane, Ismete Selmanaj Leba. Kontributi i saj dhe i atyre që po e përkthejnë në gjuhë të tjera, do të bëjnë që lexuesit e huaj, të cilët e kanë njohur pak, aspak, ose në mënyrë të shtrembëruar të vërtetën e kësaj tragjedie njerëzore, do të njihen më mirë e do të ndërgjegjësohen, që tragjedi si ajo e Kosovës, mund të përsëriten edhe për popuj të tjerë, nëse ndërgjegja kolektive nuk u vë fre politikave të tilla të gjenocidit e të shfarosjes së popujve më të vegjël.



Tani së voni doli në shqip romani “Balada”, - një titull që kumbon sërish madhërisht dhe në këtë vepër, - botim i “Onufrit”, i shkrimtarit rumun Adrian Lesenciuc, i cili erdhi dhe në Tiranë në përrurimin e veprës në shtëpinë muzde “Kadare”, që u zgjodh me qëllim.

Që në kopertinë të botimit lexojet “Një roman biografik për kompozitorin e madh rumun Ciprian Porumbescu – Kompozitori i himnit tonë kombëtar”.

Gjithsesi nga që romani “Balada” është për një kompozitor, ka muzikë të brendshme, një rendje ritmike drej saj, duke e kuptuar se muzikën e ka në trupin e vet si pema limfën.

Dhe fjalët e mia do të doja t’i ngjanin muzikës, akordeve të saj, të përcillnin emocion, jo analize...

Akordi 1

Pikërisht ky shënim i shkurtër: ... Kompozitori i himnit tonë kombëtar... do të shërbente si një thirrje për lexuesin shqiptar, që edhe pse nuk bën pjesë në intrigën romanore himni ynë, kërsëria për të ditur për këtë kompozitor, për jetën dhe vendin e tij në kohën e tij, mbeten joshëse, ndërkaq vepra e përplotës prishmërinë, bukur dhe me informacion letrar,

Nuk është një monografi, është një roman, monografi shpirtërore, mund të themi, që shpalos histori dhe një hapësirë kulturore, që janë të një të kaluar, që jehojnë si e tashme, ku rrëfimi në vetë të parë i jep një sinjeritet admirues.

Aq më tepër kur kemi të bëjmë me një shkrimtar serioz dhe me dije si Lesenciuc, poet dhe eseist dhe profesor universitar, me shumë çmime letrare kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërkaq dhe njohës i letrave shqipe në rumanisht, ku herë pas here i ka shoqëruar me artikuj kritikë të ndjeshëm.

Akordi 2

Koha e ngjarjeve është dhe nuk është e kufizuar nga historia e vet, aq sa duket sikur kufijtë midis kohës reale dhe asaj mitike janë të zbehtë. Historia zhytet në një Rumani rurale, ku traditat, këngët dhe legjendat përcillen brez pas brezi, një përzierje antropologjike, ku elementët folklorikë ndërthuren me sfidat për të afuar të tashmen moderne, duke ngulmuar në vevojën e rikthimit ndryshe.

Kjo qasje bën që romani të qëndrojë si një urë mes traditës si një ëndërr dhe botës bashkëkohore si një vizion.

Akordi 3

“...Baladë për Piano dhe Violinë, op.29, kompozim të cilin e ndjeja në vena. Ka diçka që duket të jetë gjenetiki dhe trashëguar. Teksa mblidhja të dhëna, - i thotë shkrimtari Adrian Lesenciuc si një kolegu Andreas Dushit në intervistën e tij, - zbulova se çfarë personaliteti i madh kishte qenë i ati i Çiprian Porumbescu-ut dhe vendosa të shkruaja rreth tij [...], që kontribuoi në ringritjen e shpirtit rumun gjatë revolucionit të 1848. Kam mbledhur informacione për diku dhjetë vjet [...] e përfundova. Për mua, ishte si një çlirim.

...Muzika e Çiprian Porumbescut është një mjet i tillë transmetimi kulturor dhe jam i lumtur që, nëpërmjet Asdrenit, një nga kompozimet e periudhës kur Porumbescu ishte student në Vienë, është bërë himni kombëtar i Shqipërisë.”

Romani “Balada” rrëfen një histori shumëdimensionale, ku ngjarjet ngjajnë me mitet dhe baladat popullore të Rumanisë. Në qendër mbetet kërkimi për kuptimin e jetës dhe identitetin, që formëzohen nëpër rrugë të përshkuara nga figura simbolike dhe situata jo pa enigma. Përmes narrativës,

Mbi romanin “Balada” të shkrimtarit rumun Adrian Lesenciuc

ROMANI I NJË BALADE, BALADA E NJË ROMANI QË NA ERDHI NGA RUMANIA

Nga Visar Zhiti

shkrimtari eksploron fuqinë e artit dhe traditës si mekanizma të ruajtjes së shpirtit kombëtar dhe njerëzor.

Akordi 4

Romani i ngjan një udhëtim në kohë dhe hapësirë dhe të një dimesioni tjetër, atë shpirtëror, për të gjetur të tashmen nëpërmjet së kaluarës. Gjatë këtij udhëtimi ndeshesh me vetvete të tjera.

Figura e gruas është dhe mbartëse e baladave, që ruajnë sekretet e trashëgimisë së lashtë, ndërsa i moshuari-persoanzh ka urtësinë popullore dhe lidhjen e ngushtë me natyrën dhe traditat.

Dilemat morale, mëdyshjet e brendshme, tërheqja nga një zë mistik – kënga e një balade të harruar, që ngjan se mban të gjitha përgjigjet që kërkohen, të paktën të ky roman.

Akordi 5

Personazhet e romanit aq sa janë vetvete, përfaqësojnë koncepte të thella dhe arketipe universale. Protagonisti, i

cili shpesh duket si alterego e autorit dhe e lexuesit, kalon një proces zhndërrimesh të brendshme, nga përjetime reale me dimensione fërgëlluese metafizike.

Figura të tjera përforcojnë karakterin alegorik të romanit.

Adrian Lesenciuc përqendrohet te rëndësia e trashëgimisë kulturore dhe forca e saj që na ngrihet vetvetiu në përballjen me krizat e kohës modern apo zhvillimet normale apo të bujshme.

Romani duket se është vepër e kujtesës, që mbetet dhe në ajër si muzika e baladat, e identitetit dhe lidhjes shpirtërore me rrënjët. Kërkimi për kuptimet ekzistencial duket se ka si çelës përgjigjen e pyetja thelbësore: A mundet tradita të ndihmojë njeriun të kuptojë vetveten dhe botën?

Ashtu siç thoshte poeti i madh europian Mario Luzi, ne jemi ajo që kujtojmë.

Akordi 6

Vlerat dhe Stili. “Balada” ka një rrjedhë si poetike dhe muzikore me natyrshëri që e bëjnë leximin një përvojë estetike dhe mendore të veçantë.



Titujet e kërëve janë si vargje baladeske. Adrian Lesenciuc ndërthur një gjuhë të kultivuar, që falë përkthimit nga rumanishtja nga Spriu Fuchi dhe Altin Vasillaq Kaso me thjeshtësi përcjellin një figuracion dhe simbole që pasqyrojnë një botë të thellë shpirtërore, me jetën e lidhur pandashëm me themelet, me atë trashëgimi kulturore që kulmohet te vlerat universale të njerëzores dhe artit.

“Balada” do të thosha se është një himn për traditat dhe një thirrje për të ruajtur kujtesën kulturore, e theksoj: **kujtesën kulturore, në kohëra të trazirave shpirtërore**. Kënga, ajo që është brenda nesh, edhe e papërfunduar apo e pakënduar, mbetet shtyllë e qëndrueshmërisë njerëzore.

Akordi i fundit:

Në veprën e shkrimtarit rumun Adrian Lesenciuc ka besim, Zot, kishat si institucione shpirtërore, më shumë si konstrukte shpirtërore, ndërkaq dhe romani i tij më i fundit, i botuar këtë vit në Rumani është “Gjuha e Jezusit” pjesën e parë të të cilit na e solli në shqip në “ExLibris” përkthyesi, studiuesi dhe kritiku i artit Dr. Luan Topçiu

“- Paqja është për të dobët!

Bëra kryq, sepse zavalli njeri, në padijen e tij, nuk mund të kuptonte që nga të gjitha viset nga vijmë, ne përshëndetemi duke i uruar paqe njëri-tjetrit, jo sepse jemi të dobët, por sepse dëshirojmë për njëri-tjetrin forcën e vërtetë.”

Ja, matrikulla e veprës Lesenciuc – paqja. Përmes konflikteve që sjellin paqe. Jo luftës. Çuditërisht në veprën e tij sikur parandillet ajo që ndodhi tani në Siri:

“Sapo kisha filluar të pija kafënë kur pashë ushtarët sirianë tek hyrja të cilët, papritur, u ngritën në qëndrim gatitu. Pas disa çastesh, një makinë e njohur u afrua... Mund të isha gabuar, sepse të gjitha makinat e zyrtarëve të zonës ishin Toyote të zeza, ose makina 4X4 nga General Motors. Nuk dija kurrë se kush ishte brenda tyre – klanet e fuqishme qarkullonin pa targa, shpesh me një kolonë të tërë Toyotash ose GMC, dhe çdo herë që një Toyota e zezë hynte në zonën e kontrolluar nga patrulla siriane, mornica rrëqethjeje më përshkonin gjithë shtyllën kurriore [...]

- Paqja qoftë me ty, - më përshëndeti dhe u ul pranë meje. - U trembe?

- Jo, - i thashë, ndonëse e dija mirë se ai e kishte kuptuar që po gënjeja dhe që dridhja ime ishte e dukshme.”

Letërsia, ajo e njerëzve dhe e lirisë së tyre, jo ajo e sundimtarve, i paralajmëron ata dhe diktaturat e tyre, madje i përmbys diktaturat më parë si dëshirë, si ëndërr, si thirrje, ndërkaq jep kurajo, na bën të guxojmë.

Në fund të fundit dëshmon me emocionin si muzikë në ajër, është kujtesë e së ardhmes ose le ta themi me fjalinë e fundit të romanit “Balada”: **“nuk është ajo që më përcakton. Unë nuk jam gjë tjetër veçse kohë.”**

Letërsia e madhe nuk na merr, por na jep kohë.

ADRIAN LESENCIUC

Balada



Një roman biografik për kompozitorin e madh rumun **CIPRIAN PORUMBESCU** – Kompozitori i himnit tonë kombëtar –

Onufri

Kohët e fundit, prof. dr. Tefë Topalli ka publikuar librin e tij të radhës, me titull “Me gjuhën dhe stilin e poezisë” - një përmbledhje studimore me interes të veçantë sa u takon disa autorëve dhe veprave, lidhur me artin e gjuhës së tyre. Ky publikim pasqyron një punë të thellë hulumtuese dhe një përkushtim të vazhdueshëm ndaj botimeve gjuhësore dhe letrare nga studiuesi Topalli. Libri është një studim analizuës që vë në plan të parë stilistikën dhe veçoritë gjuhësore të disa autorëve të poezisë shqipe, duke vëzhguar mënyrën sesi përdorimi i gjuhës, figurave të stilit dhe elementeve poetike ndikon në përvojën estetike dhe kuptimësinë e veprave letrare në vargje.

Prof. T. Topalli dallohet për qasjen e tij të thelluar dhe analitike, duke vënë theksin te rëndësia e gjuhës së pastër dhe fuqia shprehëse e poezisë. Edhe në këtë botim, objekt kryesor janë poetë dhe vepra të ndryshme të tyre, duke u ofruar analiza të hollësishme mbi strukturën dhe rolin që ka gjuha e stilistika në poezi.

Autori T. Topalli, si një studiues i përkushtuar, me emrin e të cilit lidhen rreth 20 botime, ka bërë tashmë emër në disa fusha të gjuhësisë, si: Stilistika, Gjuhësia e tekstit, Sintaksa, dhe Historia e gjuhës së shkruar shqipe.

Puna e tij me seminarët e disiplinës së Stilistikës së gjuhës shqipe, për vite me radhë, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, shquhet për analizën dhe interpretimin e hollësishëm të veprave letrare dhe joletrare, duke ndihmuar në zbrërthimin e aspekteve të ndërlikuara të shprehjes artistike. Po ashtu, në fushën e Gjuhësisë së tekstit, ai ka hedhur dritë mbi mënyrat se si organizohen dhe interpretohen tekstet në nivele të ndryshme, duke ofruar një qasje sistematike për studimin e tyre. Një tjetër ndihmesë e rëndësishme është puna e tij në Sintaksë, ku është thelluar në strukturat gramatike dhe rregullsitë që ndërtojnë gjuhën.

Këto përpjekje të ndërlidhura kanë formësuar një trashëgimi të vlefshme, duke ndihmuar në pasurimin e gjuhësisë. Rezultat i një pune të tillë është edhe vepra “Me gjuhën dhe stilin e poezisë” që përfshin analiza të krijimtarisë së disa figurave të njohura të letërsisë, gjuhësisë dhe kulturës shqipe, që përmes veprimtarisë së tyre kanë kontribuar në zhvillimin e gjuhës amtare dhe forcimin e identitetit kombëtar shqiptar. Lënda paraqitet nëpërmjet katër kapitujve, secili me një fokus të veçantë dhe të mirëstrukturuar, për të ndriçuar aspekte të ndryshme të gjuhës, stilistikës dhe traditës letrare shqiptare.

Botimi i ri, me mjaft risi vështrimi, tërheq vëmendjen e lexuesve pasionantë të letërsisë artistike, duke e vlerësuar atë si një udhërrëfyes për të kuptuar më mirë poezinë dhe veprën e autorëve shqiptarë. Ai vjen si një kontribut i çmuar në domenin e gjuhësisë dhe kulturës shqiptare, duke nxitur frymëzim për studiuesit e gjuhës e të letërsisë. Libri në fjalë, jo vetëm që sjell një vlerë të shtuar në fushën e stilistikës gjuhësore, por gjithashtu rikujton fuqinë dhe bukurinë e fjalës artistike.

Vepra hapet me një Hyrje të shkurtër nga autori, ku thekson se duhet shkruar për shkrimtarë e poetë dhe veprat e tyre, sepse epoka digjitale dhe inteligjenca artificiale, sikur e kanë larguar njerëzimin nga të lexuarit. Prandaj, duhet të përshkruajmë, të bëjmë rezyme dhe abstrakte të librave në fusha të ndryshme diturore, pasi edhe nuk mund të digjitalizohen të gjitha shpikjet dhe zhvillimet e shoqërisë njerëzore në lëmë të diturisë dhe artit në mënyrë të plotë; shpesh ato dalin vetëm si lajmërimi a njoftime të shkurtuara në programet e Google-it dhe Wikipedia-s, fundi: a nuk vjen kjo si metodë didaktike për t'i kthyer njerëzit tek leximi! - shkruan Topalli. Dhe vijon argumentin me parashtrimin e pyetje-përgjigjeve të tilla: A nuk ka bërë këtë shkrimtari i madh francez Viktor Hygo, kur publikon një vepër të gjërë për gjeninë

Për librin “Me gjuhën dhe stilin e poezisë” të prof. dr. Tefë Topallit

NJË PËRMBLEDHJE STUDIMORE ME ANALIZA GJUHE E STILI

Nga Prof. As. Dr. Orjeta Baja
Universiteti “Luigj Gurakuqi” - Shkodër

e Shekspirit, me anën e së cilës merr e i ngre monument dramaturgut e tragjedianit të pavdekshëm anglez, duke shpallur se *Shekspiri është Anglia, Gëte është Gjermania, dhe përpara tyre Dante është Italia?*... Çfarë ka bërë tjetër një nga kritikët letrarë më të famshëm të kohës sonë, profesori i Shkencave Humane i Universitetit të Yale-it e në Harvard, *Harold Bloom*, i cili, për më gjatë se 40 vjet, i ka transformuar studentët e tij në lexues të përjetshëm, duke i mëkuar me dashurinë e tij të pafund për letërsinë; ndërkohë që media e shpejtë elektronike kërcënon me bjerrjen e leximit!... Prandaj dhe Bloom-i u ka dhënë jetë librave më të mëdhenj botërorë për diturinë e paçmueshme që ata përçojnë. Ai shkroi me dashuri e pasion librin “Si dhe përse lexojmë” (H. Bloom, *How to read and why* (Si dhe përse lexojmë), Dudaj, Tiranë, 2008).

Edhe libri “Me gjuhën dhe stilin e poezisë” i autorit T. Topalli, synon të përçojë një ndihmesë në këtë drejtim: të sjellë njoftime të reja lidhur me profilin kulturor, letrar e shkencor të disa figurave të shquara të letërave shqipe në lëvizimin e gjuhës amtare.

Kapitulli i parë i librit, emërtuar “*Traditë letrare*” përbën një kërkim nëpër veprat e disa prej figurave të shquara të kulturës shqiptare që kanë dhënë ndihmesa të vyer në letërsi, gjuhësi e përkthime. Kjo hapësirë përfshin

artikuj të dedikuar për përvjetorët e lindjes së tyre, si: të poetit e atdhetarit, Asdreni (1872-1947); të pedagogut, studiuesit, poetit e përkthyesit Vehbi Bala (1923-1990); të albanologut Jup Kastrati (1924-2003).

Studiuesi Topalli thekson se: Në kohën tonë, botimet e këtyre figurave të botës intelektuale shqiptare vështirë të gjenden për nevojat e studiuesve tanë filologë, për të parë gjuhën dhe stilin, vlerat dhe risitë që ata kanë sjellë në atë periudhë të lëvizimit të gjuhës amtare... Për shembull, përmbledhja poetike “*Psallme murgu*” e Asdrenit mungon në libraritë e në shumë biblioteka të vendit. Për kohë më të vona, nuk mund të njihesh me krijimtarinë poetike të V. Balës, sepse nuk janë në qarkullim përmbledhjet e tij me vjersha e poema, me të cilat edhe nisën botimet në vitet kur hidheshin themelet e letërsisë shqiptare këndej dhe andej kufirit; ashtu si, vetëm me një fotokopjim nga Biblioteka Kombëtare, mund të sigurosh përshtatjen e parë në gjuhën e sotme të romanit lirik “*Këngët e Milosaut*”, nga prof. Jup Kastrati, studiuesi më i thellë i veprës së përgjithshme të De Radës ...

Një hapësirë e mirë e është lënë shkrimtari për poetin e Rilindjes Kombëtare, Asdrenin, në 150-vjetorin e lindjes së tij. Që në hyrje të shkrimit janë sjellë në mënyrë kronologjike studimet që i takojnë krijimtarisë së poetit



drenovar, me vlerësime të shumta për veprat e tij poetike. Asdreni është poeti dhe atdhetari i madh shqiptar, i njohur për pasionin e tij për gjuhën amtare dhe për vjershërinë që ngërthen në vetë shpirtin kombëtar. Topalli shkruan që Konica është i pari kritik që ngre lart *vjershërinë* e Asdrenit *për mendimin dhe derdhjen e tij në vargje*, kanunet e metrikës e, përgjithësisht, *për tërësinë e “Rrezeve” me plot vlerë letrare, që duhet të jetë në çdo libër të shqiptarit* Vijon në këtë mënyrë evidentimi i vlerësimeve për këtë poet përmes pasazhesh nga autorë të tjerë, si: nga Gj. Fishta, më 1914, përmes përmbledhjes “*Endrra e lotë*”, botuar në revistën e njohur “*Hylli i Dritës*”, më pas konsiderata prej L. Poradecit e Z. Skiroit, të cilët pohojnë se poeti drenovar *ka fituar një vend me nder pranë poetëve kombëtarë më të famshëm*. Vihet në dukje se kritika letrare dhe vlerësime për poetin vazhdojnë edhe më gjatë, pas Luftës II Botërore, me botime fragmentesh në tekste shkollore, deri edhe në botime akademike, bërë nën kujdesin e prof. K. Bihikut. Studime letrare e gjuhësore për Asdrenin kanë bërë edhe E. Çabej, Dh. Shuteriqi, J. Bulo, S. Hamiti, deri tek monografia e plotë e R. Qosjes për poetikën e tij dhe vlerat ideore për shkrimtarin e dy epokave, me titull “*Asdreni. Jeta dhe vepra e tij*”, 1972. Prej autorit analizohet jo vetëm gjuha dhe stili poetik i Asdrenit, por edhe roli i tij si simbol i përpjekjeve për emancipimin kulturor dhe gjuhësor të shqiptarëve.

Një vend i rëndësishëm i kushtohet personalitetit të gjithanshëm, që shquhet si pedagog, studiues, poet dhe përkthyes, Vehbi Bala, në 100-vjetorin e lindjes së tij. Vlerësohet qasja e Balës ndaj gjuhës shqipe dhe theksohet kontributi i tij i ndjeshëm në ruajtjen dhe pasurimin e letërsisë shqiptare, duke hedhur dritë për stilin e tij të qartë dhe të rrjedhshëm si poet dhe përkthyes nga rumanishtja, italishtja dhe nga gjermanishtja, siç është balada e njohur e Gëtes “*Mbreti i Tulës*”, sjellë në gjuhën tonë në disa variante, nga Ndre Mjeda, deri tek më të rinjtë.

Edhe në 100-vjetorin e lindjes së prof. Jup Kastratit, albanologut të njohur që ka lënë gjurmë të thella në historinë e gjuhës shqipe, prof. Topalli do të përgatiste një shkrim me vlerë mbi veprimtarinë e tij të vyer, duke u bërë pjesë e këtij botimi. Vlerësimet e autorit për Kastratin fokusohen në analizën e detajuar të veprave të tij, të cilat shërbejnë si bazë për studimet moderne të albanologjisë, të gramatologjisë, jo vetëm për njohjen e tyre, por edhe duke përshtatur gjuhën e rilindësit të madh Arbëresh. Ai nënvizon se veprat e prof. Kastratit (të botuara dhe lënë në daktiloshkrim) qëndrojnë në bazë të historisë së gjuhës shqipe dhe në themel të lidhjeve me kulturën dhe letërsinë arbëreshe. Njëherësh, Topalli nënvizon se me gjuhën e J. Kastratit, në mënyrë të veçantë, varianti që përdor ai nga vitet 1950-1970, bëhet një bazë e mirë shkencore për të studiuar si *kalohet nga idioma e një dialekti në standardin e njësuar të gjuhës sonë*.

Këto shkrime nuk janë thjesht përkujtimore, por një analizë e thelluar nga ana e autorit mbi mënyrën se si këta autorë përjetësuan trashëgiminë gjuhësore dhe letrare shqiptare. Ata paraqiten si një qasje historike e stilistike dhe janë një ftesë për të

TEFË TOPALLI

ME GJUHËN
DHE STILIN E POEZISË

Universo
BOTIME


reflektuar mbi traditën letrare e gjuhësore shqiptare, duke e parë atë si një burim të pashtershëm frymëzimi dhe studimi për brezat e ardhshëm. Ky kapitull i parë është një përnderim ndaj themeluesve dhe ruajtësve të fjalës shqipe, të cilët me punën e tyre krijuan themelet e zhvillimit kulturor kombëtar. Shtjellimi i mëtejshëm i veprës zbulon dimensione të reja të analizës letrare dhe gjuhësore, duke u ndalur në figura të tjera të njohura që shpalosin aspekte të rëndësishme të gjuhës dhe stilit artistik.

Kapitulli i dytë, "Krijues të sotëm", është fokusuar në gjuhën dhe stilin e veprave të dy autorëve bashkëkohorë: Alfred Çapaliku në lëmë të poezisë dhe Tonin Çobani në studimet fishtologjike. Autori analizon me thellësi e kompetencë gjuhësore dhe eksploron përdorimin inovativ të gjuhës e stilit artistik të këtyre dy studiuesve, duke nxjerrë në pah kontributet e tyre të veçanta në letërsinë dhe kulturën tonë.

Kanë tërhequr vëmendjen e veçantë të autorit të këtij libri, risitë që sjell poeti Alfred Çapaliku në 5 vëllimet e tij me poezi. Poetika e tij vështrohet në nivele të ndryshme të gjuhës, nga fonetika, leksiku dhe sidomos sintaksa e vargjeve, me përbërësit e saj, nga rendi, intonacioni, rima dhe poetizimi i fjalës. Pasi rendit disa tregues të stilit të vjershërimit të poetit, përqsuar me krijues bashkëkohës, vjen e evidentohet tematika e poezive të tij, duke e konsideruar leitmotiv të kësaj krijimtari; si dhe shquhet ndihmesa që ka dhënë poeti A. Çapaliku në hartimin e teksteve të disa këngëve, në bashkëpunim me kompozitorë e interpretues të melodive. Nuk janë lënë jashtë edhe mjaft përkthime në poezi nga pedagogu i letërsisë, Çapaliku, nga autorë të njohur në gjuhën angleze dhe italiane. Në analizën e kësaj krijimtari poetike, Topalli përqendrohet gjithashtu në mënyrën se si poeti ndërton një univers ndjesor përmes një gjuhe të pasur e të ngarkuar me emocione. Stili i këtij poeti shfaqet si një kombinim unik i traditës dhe modernitetit, ku fjala nuk është thjesht një mjet komunikimi, por një formë artistike që sfidon normat dhe zgjeron kufijtë e poezisë shqipe. Theksohet fakti se prof. Çapaliku përdor teknika të avancuara stilistike dhe figurative, duke krijuar një harmoni mes strukturës së thjeshtë dhe kompleksitetit tematik.

Sa i takon autorit tjetër, studiuesit më prodhimtar të veprës së gjerë të autorit të "Lahutës së Malcís", në të gjitha gjinitë letrare: nga lirika, dramatika dhe epika e tij, Tonin Çobani, vihet në dukje se ai ka mbi 30 vjet që i është kushtuar vendit që zë figura e veçantë e Gjergj Fishtës në jetën kulturore shqiptare gjatë gjysmës së parë të shekullit XX, sipas kredisë së përcaktuar prej tij *Miti dhe antimiti fishtjan*. Topalli vë në dukje që: në vitet 1990, Çobani publikoi i pari disa vjersha të poetit nga "Anzat e Parnasit" dhe nisi të shkruajë për krijimtarinë e tij, së pari për Poemën e madhe "Lahuta e Malcís", e vepra dramatike që janë inskenuar në Teatrin e Shkollës Françeskane të qytetit të Shkodrës. Theksohet se Çobani ka sjellë një dimension të ri në mënyrën se si Fishta perceptohet dhe analizohet, duke i dhënë një rëndësi të veçantë përdorimit të gjuhës shqipe si një pasqyrë e kohës dhe kontekstit historik. Në portretizimin e këtij studiuesi pasqyrohet puna e tij shkencore edhe për ndriçimin e disa figurave të tjera të kulturës sonë, përmes disa monografish, si, për *Frang Bardhin*, *Pjetër Zarishin*, *Naim Frashërin* etj. Autori ndalon edhe tek disa të dhëna për shkrime kritike e letrare, në tregime, skica e novela që ka botuar studiuesi Çobani.

Ky kapitull shërben si një urë lidhëse mes trashëgimisë së të kaluarës dhe krijimtarisë bashkëkohore, duke u evidentuar se si krijuesit e sotëm vazhdojnë të zhvillojnë dhe pasurojnë letërsinë dhe gjuhën shqipe. Studiuesi Topalli i paraqet A. Çapalikut dhe T. Çobanit si shembuj të shkëlqyer të gjuhës artistike dhe studimore që reflektojnë mundësitë e shprehësisë në stile të ndryshme.



Me analizën e këtyre dy figurave, kjo pjesë nuk përmban vetëm një vlerësim të arritjeve të tyre, por edhe një ftesë për lexuesin që të reflektojë mbi rolin e gjuhës dhe stilit në krijimin e identitetit kulturor bashkëkohor.

"Me më të rinjtë" është emërtuar kapitulli në vijim, ku është përfshirë një analizë e hollësishme për stilin letrar të poetit Arben Prendi, variantin e tij shkrimor të përdorur dhe çfarë e karakterizon këtë krijues në brezin e tij. Prof. Topalli vlerëson: përfitim e gjuhës poetike të Prendit, mënyrën se si poeti ndërton imazhe poetike të ndërlikuara përmes një strukture gjuhësore të përpunuar me kujdes, si dhe variantin shkrimor të tij, të qartë e elegant, që krijon një lidhje të ngushtë mes lexuesit dhe botës së tij poetike. Gjithashtu, ai evidenton: një qasje të rafinuara ndaj strukturës dhe ritmit poetik; një balancë mes ngarkesës emocionale dhe përdorimit racional të fjalës; gjurmë të ndikimeve tradicionale ndërthurur me një zë të fortë dhe original që reflekton mbi temat e ekzistencës, përkatësisë dhe ndjeshmërisë njerëzore. Ky shkrim analitik e pozicionon Arben Prendin si një nga poetët më të shquar të brezit të tij, duke vlerësuar aftësinë e tij për të qëndruar besnik ndaj traditës letrare shqiptare, ndërkohë që përqsafon një frymë të re dhe moderne në krijimtarinë e tij. Me këtë vështrim të detajuar, ofrohet një portret poetik i plotë i një krijuesi që e bën gjuhën shqipe të kumbojë me originalitet dhe thellësi emocionale.

Në tërësi, analiza e veprës së A. Çapalikut, T. Çobanit dhe A. Prendit e bën këtë segment të librit një refleksion të thellë mbi fuqinë dhe shprehësinë e krijuesve të sotëm për të pasuruar trashëgiminë letrare shqiptare.

Kapitulli në vijim "Autorë dhe vepra", sjell një radhë recensionesh dhe vlerësimesh të thelluara për vepra studimore kryesisht të disa gjuhëtarëve shqiptarë. Ky seksion pasqyron jo vetëm arritjet e këtyre studiuesve, por edhe ndikimin e tyre në pasurimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, sidomos në aspektin stilistik. Janë shkrime dhe vepra studimore të një rendi gjuhëtarësh që, midis të tjerëve, kanë gjurmë me vepra të rëndësishme për disiplinën e ndryshme, duke realizuar mjaft kërkime në lëmë të gjuhës amtare. Përgjithësisht, janë recensionet që Topalli u ka kushtuar botimeve të tyre në vitet e fundit, të tillë si: Xh. Lloshi, që u sjell lexuesve jetën e veprat e Konstandinit të Madh të gjuhës shqipe, dhe 'aventurës së librit shqip', pasi ka publikuar përmbledhjet: "Vështrime stilistikore" dhe "Huazimet e shqipes nga turqishtja"; E. Ymeri, i cili ka hartuar "Fjalorin e freologjizmave të gjuhës shqipe" me 1200 faqe; Gj. Shkurta, gjuhëtar i gjen fjalën e shprehjen e bukur shqipe në *Eposin tonë dhe këngë të tjera*, ndërsa ka hartuar e botuar *Fjalorin dialektor të Malësisë së Madhe*, me mbi 1000 faqe; R. Ismajli, hulumtuesi i

elementeve tekstuale në gjuhësinë tonë dhe Sh. Islamaj, studiuesja që ndjek ndër shkrimtarë *majat e artit të gjuhës* në planin stilistik. Kapitulli mbyllet me disa paraqitje veprash e analiza gjuhësore të tyre nga *Letërsia artistike* e S. Çapalikut.

Në këtë kapitull, autori ndalet tek disa nga veprat më të fundit të prof. Xhevat Lloshit, duke i vlerësuar si kontribute të çmuara në fushën e gjuhësisë shqipe, kryesisht të fushës stilistikore. P.sh., në "Vështrime stilistike", Lloshi sjell një informacion të hollësishëm të stilistikës së gjuhës shqipe, duke theksuar përdorimin e figurave stilistike dhe ndërthurjen e tyre me gjuhën e përditshme dhe letërsinë artistike. Më tej, vlerësohet gjuhëtar i Xh. Lloshi për mënyrën e saktë dhe të qartë të prezantimit të nocioneve dhe koncepteve stilistike, duke kontribuar në një kuptim më të thellë të strukturës dhe funksionit të gjuhës shqipe në krijimtarinë letrare; Në veprën tjetër, "Huazimet e shqipes nga turqishtja", prof. Lloshi i kushton një analizë të detajuar huazimeve leksikore që ka marrë shqipja nga turqishtja, një temë e rëndësishme dhe aktuale në studimet gjuhësore. Këtë analizë, Topalli e konsideron si një kontribut të rëndësishëm për albanologjinë, pasi shpjegon proceset dhe mekanizmat e huazimit, duke ofruar një pasqyrë të ndikimeve turke në gjuhën shqipe dhe si ato ndikime janë përshtatur dhe transformuar në kontekstin e shqipes.

Një tjetër vepër e vlerësuar në këtë përmbledhje studimore nga Topalli është "Fjalori i frazeologjizmave të gjuhës shqipe" i prof. Eshref Ymerit. Studiuesi sjell një recension të kujdesshëm, duke analizuar thellësinë dhe pasurinë e këtij fjalori të Ymerit, i cili mbledh dhe sistematizon frazeologjizmat më të përdorur në shqipen e sotme. Kjo vepër është shumë e rëndësishme për studiuesit dhe të gjithë ata që janë të interesuar për mënyrën se si frazeologjizmat shprehin realitetin dhe kulturën shqiptare, njëherësh edhe prurje nga kultura të tjera. Topalli thekson metodologjinë shkencore dhe sistematikën që leksikografi ka përdorur për të mbledhur dhe përshkruar frazeologjizmat, duke i dhënë kështu lexuesit një burim të pasur informacioni për përdorimin e tyre në çdo kontekst gjuhësor.

Po një fjalor tjetër i një rëndësie të veçantë merr vëmendjen e autorit të librit që përmban një analizë të hollësishme të këtij botimi: "Fjalor dialektor i Malësisë së Madhe", i prof. Gjovalin Shkurtajt. Topalli e vlerëson këtë punë të vyer e të gjatë studimore për pasurimin e dialektologjisë shqiptare, duke theksuar se Shkurtaj, në këtë vepër leksikografike, ka një pasuri të jashtëzakonshme në dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore të një zone të veçantë të Shqipërisë, që ka tradita të pasura gjuhësore dhe etnografike. Ai

thekson se ky fjalor është një thesar për të kuptuar ndryshimet dialektore dhe për të zbuluar ndjeshmërinë e gjuhës shqipe në aspektin e lëvizjes dhe evolimit të saj përgjatë shekujve. Në shkrim shpalosen edhe mjaft analiza e vlerësime të tjera mbi veprimtarinë shkencore të gjerë të këtij gjuhëtar i eksplorues të jetës gjuhësore, sociolinguistike, letrare e kulturore të botës shqiptare e arbëreshe.

Pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli është edhe një shkrim recensues mbi elementet e gjuhësisë tekstuale në gjuhësinë tonë, kushtuar veprës "Shumësia e tekstit" (Prishtinë, 1980), të prof. Rexhep Ismajlit, duke u ndalur sidomos te risitë e përmbajtjes dhe të trajtimit të mjaft nocioneve tekstore pak ose aspak të njohura në literaturën tonë para gjysmë shekulli.

Një shkrim i hollësishëm aq i veçantë dhe brenda fushës ku autori ynë ka bërë edhe botime të specializuara, është ai për veprat e prof. Shefikje Islamajt, një studiuese e spikatur në lëmë të stilistikës dhe analizës gjuhësore për autorë të ndryshëm. Prof. Topalli vlerëson kontributet e Islamajt në studimin e artit të gjuhës shqipe dhe veçanërisht në përdorimin e stilistikës si një mjet për të kuptuar më mirë funksionet dhe efektet e gjuhës në letërsi dhe komunikim. Ai shquan faktin se Islamaj ka sjellë një qasje të re në studimet stilistike, ku ka përfshirë analizën e teksteve letrare, duke ofruar një pasqyrë të gjerë mbi mekanizmat stilistikë që janë të pranishëm në shqipen moderne. "Ligjërimi, gjuha dhe stili" është monografia e radhës e gjuhëtares së njohur, me prurje të reja të studimit të fushës së stilistikës, që është objekt i një analize tjetër të thukët të studiuesit Topalli në vepër, duke nxjerrë mirë në pah pasurinë e vlerat gjuhësore-stilistike të saj.

Kreu ofron një pasqyrë të pasur dhe të gjerë të kontributeve të disa studiuesve shqiptarë, duke vlerësuar veprat e tyre dhe rëndësinë që ato kanë për zhvillimin e gjuhës shqipe në fusha të ndryshme, nga stilistika dhe frazeologjia deri tek dialektologjia dhe studimet e huazimeve. Përmes këtyre recensioneve, vepra e Topallit ndihmon në thellimin e kuptimit të arritjeve më të fundit në fushat përkatëse dhe thekson rëndësinë e studimeve të tilla për pasurimin dhe ruajtjen e gjuhës shqipe.

Libri mbyllet me tre recensionet dedikuar Letërsisë artistike: botimeve më të fundit të shkrimtarit dhe dramaturgut Stefan Çapaliku, për dy romanet "Një engjëll veshë me frak" e "albumi i thashethemeve" dhe *Letërsinë ndryshe të S. Çapalikut në tre libra* - siç e ka emërtuar Topalli. Analizat për këto vepra pasqyrojnë një shfaqje të thelluar në vështrimin e strukturës së rrëfimit, karakterizimin e personazheve dhe përdorimin e gjuhës në këto vepra, nga narrativa e gjatë, deri tek mjeshtria për të rrëfyer kallëzime popullore e barsaleta qytetare shkodrane. Për autorin e librit që po sjellim këtu, shkrimtaria e S. Çapalikut, përbën një zë krejt të veçantë të letërsisë sonë bashkëkohore; vlerësuar ajo si pjesë e një vizioni të ri letrar që sfidon normat tradicionale të rrëfimit. Ai përqendrohet në mënyrën se si shkrimtari eksperimenton me formën dhe përmbajtjen, duke sjellë një letërsi që është njëkohësisht e rrënjësor në realitetin shqiptar dhe e hapur ndaj ndikimeve moderne, me një gjuhë të pasur me figura stilistike dhe ndërtime letrare novatore.

Botimi "Me gjuhën dhe stilin e poezisë" i T. Topallit, përbën një vështrim studimi me vlerë për gjuhën dhe stilin e disa veprave në poezi dhe prozë. Me një analizë të thellë dhe të hollësishme të tyre, autori ka arritur të ravijëzojë një pasqyrë të qartë mbi përdorimin e elementeve gjuhësore dhe stilistike që i përshkruajnë ato. Ky libër është një burim i vlefshëm për studiuesit, studentët dhe të gjithë ata që janë të interesuar për zhvillimin e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në kontekstin e traditës dhe novatorizmit.

1

Ju riktheva në këto ditë, kur po rrokulliset edhe viti 2024 për të hyrë pas pak ditësh në çerekun e parë të shekullit XXI, një letër të Fatmir Haxhiut. Për fat të keq në kohët moderne, kur janë shtuar rrjetet sociale, mungon komunikimi nga më njerëzoret, që është ai nëpërmjet letrave. Nuk e di, nëse në fondin e piktorit të madh Fatmir Haxhiut ka letra të tjera, por do ishte me interes nëse ato janë, do dëshiroja, që Artani, djali i Fatmirit, i cili i është kushtuar me një zell të paparë trashëgimisë së babait të tij, t'i botojë një ditë ato. Nuk është e rastit, që ju riktheva kësaj letre. E para, sepse më 28 dhjetor Fatmir Haxhiu ka datëlindjen. Ai ka lindur në Gjirokastrë, në këtë funddhjetor të vitit 1927. E dyta, para disa javësh, Arjana më dhuroi Librin Monografik «Fatmir Haxhiu, piktori i historisë», shkruar nga studiuesja e mirënjohur, Suzana Varvarca Kuka. Mora pjesë në promovimin e këtij libri, organizuar më 14 nëntor 2024, në një nga sallat e Hotel Plaza, ishte një promovim emocionues, me një pjesëmarrje të madhe, që rrallë e kam parë këto vite. Po risjell këtu vlerësimet e piktorit mistik, Gazmend Leka: «Është e bukur dhe prekëse të mendosh, se ajo studentja e dikurshme në vizatimin e profesorit, sot është një personalitete e shquar në fushën e studimit». Më pas ai foli për vlerat e një prej piktorëve më të shquar shqiptar, siç është Fatmir Haxhiu. Këtë monografi e mora në duar, siç thashë më lart, dhuruar me një dedikim prekës nga Arjana dhe Artani. Kam patur fatin, që të jem mik i familjes së Fatmir Haxhiut dhe kam ndërë vazhdimisht ngrohtësi dhe mikpritje tek ata. I kam thënë Arjanës, se do të shkruaj diçka për Farziletin, gruan e Fatmirit dhe se ruaj disa shënime për të. Farzileti ka luajtur një rol të rëndësishëm, jo vetëm si nënë, por edhe si bashkëshorte, duke ia lehtësuar punën krijuese të piktorit të madh.

2

Kjo letër mban datën 25 gusht 1997 dhe është dërguar nga Fatmir Haxhiu dhe Leti(Farzileti), bashkëshortja e piktorit të madh. Ata në atë periudhë të trazuar dhe nga më dramatiket e tranzicionit shqiptar ndodheshin në Bilbao, ku prej vitesh jetonte Artani, djali i tyre, bashkë me Karminën, bashkëshorten e Tanit dhe Olisën dhe Editn, vajzat, që unë i kisha njohur fare të vogla, kur shkoja në familjen e tyre. E gjeta këtë letër në mesditën e 2 majit 2021, kur u ktheva nga varrezat e Sharrës. Mëngjesin e kësaj dite, që kishte shenjtërinë e Pashkës së Madhe, mora rrugën për në Sharrë. Mëngjesi ishte i lagësht, nga shiu i padukshëm, ardhur siç dukej nga qiej mistikë. Dhe teksa hyra në qytetin e të vdekurve, befas qielli u kthjellua. Kisha ardhur në këtë qytet të përjetshëm, të të vdekurve, për vizitë e për të biseduar me miqtë e mi, shkrimtarin Ylli Xhaferri, varri i të cilit është në krahun e djathtë, jo shumë larg nga hyrja e këtij qyteti, regjisoriin Kujtim Gjonaj, shkrimtarin dhe kulturologun Moikom Zeqo... Qëndrova gjatë pranë tyre, u fola, duke vështruar portretet e ngrira në pllakat e mermerta të varreve. Rrallë më ka ndodhur, që të ngarkohem

NJË LETËR NGA PIKTORI FATMIR HAXHIU

Nga Enver Kushi



me ca emociione krejt të veçanta, që nuk di sesi t'i quaj, siç më ndodhi kur u ngrita nga banesa e përjetshme e mikut tim të paharruar Moikom Zeqo. Atje lashë një letër, fshehur nën një gur, që disa javë më pas e gjeti vajza e tij Kleitja. Dhe kur dola në një nga rrugët e qytetit të të vdekurve, hodha vështrimin lart, ku ca re të bardha lëviznin si me përtim në qiellin blu.

Kërkova në parcelën, ku mesa mbaja mend, ishte varri i Vath Koreshit, njeriut të mrekullueshëm dhe shkrimtarit, që më ka ndihmuar në hapat e mia të para si prozator. U enda gjatë por nuk e gjeta. Edhe prof. Dhimitër Shuteriqin nuk e gjeta. As prof. Alfred Uçin dhe as shkrimtarë e artistë të tjerë që kisha njohur.

Pastaj këmbët më çuan në parcelën, ku ishte varri i Fatmir Haxhiut: një varr i thjeshtë, punuar bukur nga miku i tij, skulptori Mumtaz Dhrami. Përkëdhela autoportretin e Fatmirit dhe më pas edhe portretin e bukur të Farziletit, vepër kjo e Fatmirit. Në heshtje dhe më pas me zë, u thashë se u jam mirënjohës

të dyve për mikëpritjen, miqësinë, që më kanë falur në vite, se e ndjeja shumë mungesën e tyre dhe se vazhdonin te jetonin gjallë në kujtesën time. E ndërsa po largohesha, i dërgova sms Arianës, vajzës së tyre, ku i shkruaja, se u çmalla me ta. Ora ishte 11. Dielli digjte, ndërsa nga lugina e Erzenit, erërat dukej sikur sillnin hingëllimat e ngrira të kuajve, që piktori i madh Fatmir Haxhiu, ka hedhur në tablotë e tij të papërsëritshme. Këto hingëllima kuajsh më shoqëruan, kur hyra në shtëpi, bashkë me një ngarkesë të çuditëshme emocionesh, ose më saktë re malli, që dyndeshin vrullshëm, ardhur nga varrezat e Sharrës.





E dija që e kisha ruajtur si sytë e ballit, letrën që më kish dërguar Fatmir Haxhiu, nga Bilbao e largët. Dhe kur e hapa dhe nisa ta lexoj, nga fjala në fjalë dhe përmes rreshtave, më dukej sikur dëgjoja zërin e Fatmirit dhe të Farziletit. Letra është shkruar në dy faqe. Dallohet kujdesi i mikut tim, jo vetëm në kaligrafinë dhe saktësinë e shkrimit të shqipes, por edhe dëshira për të dhënë sa më shumë informacion, për Artanin, Karminën,

mbesat, që “janë rritur e zbukuruar dhe janë bërë zonjushë”, për Bilbaon, “qytet i madh dhe i bukur, ndërtuar mbi nje terren të thyer, me kodra gati malore, që së bashku me arkitekturën e bukur të ndërtesave, u japin larmi peisazheve befasuese...” Për t'i bërë më konkrete këto imazhe, bashkëngjitur me letrën, është edhe një kartolinë, ku janë 4 foto të vogla me ngjyra. Në pjesën e pasme të saj, poshtë emrit me gërma të mëdha BILBAO, janë këto diçitura për fotot: Ria, Teatro Araga, Casade Juntas (Garnika), y Basilica de Nuestra Senora de Begona).

Nuk po ndalem në hollësi të tjera, që Fatmiri shkruan në këtë letër, që kanë të bëjnë me jetën e gjallë artistike e kulturore, në Bilbao, por dua të nënvizoj dy konstatime që do t'i lexoni në këtë letër”

Së pari, atij i kanë bërë përshtypje, jo vetëm kultura e ndërtimit në Bilbao, Madrid, Gernika, San Sebastian etj, por edhe muzetë e pasur dhe kujdesi që tregohet për trashëgiminë kulturore në Spanjë, vend që i ka dhënë Europës dhe botës, shkrimtarë, piktorë, artistë, arkitektë të jashtëzakonshëm. Pas këtij konstatimi, vjen një frazë që nuk ka nevojë për koment! “... ndjej keqardhje për vendin tonë, që edhe pas pesëdhjetë vjetëve pune e djerse të lodhshme që bëmë, këto vitet e fundit, siç e di ti, e larguan Shqipërinë edhe më shumë nga bota e qytetëruar”.

Së dyti, piktori i madh Fatmir Haxhiu, siç shkruan në këtë letër: “Që kur kam ardhur, pothuaj çdo ditë kam punuar edhe piktorë, që t'i lë Artanit disa kujtime, sepse nuk dihet, jeta bën të vetën dhe





ma merr mendja, do ta kemi të vështirë të vimë përsëri”, ai ka vazhduar punën e tij krijuese, me të njëjtin ritëm, si në Shqipëri.

Ishte viti 1997, një nga më dramatikët dhe të mbrapshtët për Shqipërinë postkomuniste. Në qytetin e bukur të Bilbaos, ai atë vit, ishte në prag të 70 vjetorit të lindjes dhe punonte pa pushim, duke jetuar dhe me hallet e Shqipërisë dhe ngjarjet tragjike, që përjetonte Kosova martire, në atë periudhë. Mbjaj mend, që kur u kthye në Shqipëri, në shtator të 1997, më foli gjatë për qytetërimin e madh ispanik dhe dhimbjen, që përjetonte Shqipëria. Tre vite më pas, në fundvitin 2000 dhe fillimvitin 2001, piktori i madh Fatmir Haxhiu, do të vizitonte Kosovën e çliruar nga pushtuesi mbi një shekullor serb. Ai ishte i mbushur me emocione dhe po hidhte bocetet e një pikturë murale, për betejën e Fushë Kosovës të vitit 1389.

Miku im i shtrenjtë dhe i paharruar, ndërroi jetë, më 10 mars të vitit 2001. Ai u largua nga kjo jetë, me pengun më të madh të jetës së tij: mosrealizimin e pikturës murale për Betejën e Fushë Kosovës, që do t’ja dhuronte Muzeut të Prishtinës.

Mbjaj mend, që në shkrimin “Hingëllima e ngrirë e kuajve” mes të tjerash nënvizoj: “Tani në Fushë Kosovë ka ardhur pranvera dhe mjegulla shfaqet e rishfaqet, duke lëvizur ngadalë mbi të. Mëngjeseve dhe muzgjeve të vona, vazhdojnë duke fluturuar me krakërrima korbat. Atje është obelisku dhe tyrbja e Sulltanit të vrarë, 600 e ca vite përpara. Atje historia ka ngrirë. Edhe në Tiranë ka ardhur pranvera, ndërsa në një apartament të thjeshtë në “Rrugën e Elbasanit”, që nga mbrëmja e 10 marsit, në dhomë-studio, skicëtabloja “Fushë Kosovë1389”, më kot pret të hyjë në të Fatmiri. Më kot presin luftëtarët shqiptarë e ballkanas dhe kuajt e shumtë, penelin e piktorit. Ata kanë mbetur si në baladën e lashtë shiptare: të ngrirë, Medet! Mjeshtri i Madh nuk është më për t’u dhënë jetë atyre. Kuajt kanë mbetur në telajo me hingëllima të ngrira! Medet!”

Tiranë, dhjetor 2021-2024

*Të dashur Neta dhe Enver,
Dëshirojmë të jeni të gjithë mirë me
shëndet dhe me punë!*

*Neve këtu po e kalojmë mirë. Po
ç’mallemi me Artanin-Karminën dhe
mbesat. Ato janë rritur e zbukuruar dhe
janë bërë zonjushë.*

Qyteti është i madh dhe i bukur, i ndërtuar mbi një terren të thyer, me kodra gati malore, që së bashku me arkitekturën e bukur të ndërtesave u japin larmi peisazhesh befasues Bilbaos. Jeta është tepër intensive, fillon në mëngjes gati dy orë më vonë se në Shqipëri (pasi këtu dielli lind dhe perëndon dy orë më vonë nga tek ne), por vazhdon deri në ora dy mbas mezit të natës, sidomos në këtë periudhë, që janë dhe festa e gushtit, njerëzit dëfrenjë, kërcëjnë e këndojnë në mënyrë massive, të shoqëruara me aktivitete të gjera artistike e kulturore në shumë pika të vendit.

Artani është përpjekur të na argëtojë dhe të na kënaqë. Përveç Bilbaos, kemi parë dhe qytete të tjera, si Madridin, Gernikën, San Sebastianin e të tjera qytete, të cilat na kanë lënë mbresa të mëdha, për kulturën e ndërtimeve, pastërtinë shembullore, për muzetë e pasura dhe kujdesin që tregojnë për mirëmbajtjen e tyre. Bashkë me kënaqësinë ndjej keqardhje për vendin tonë, që edhe pas pesëdhjetë vjetëve, pune e djerse të lodhshme që bëme, këto vitet e fundit, siç e di ti, e larguan Shqipërinë edhe më shumë nga bota e qytetëruar.

Që kur kemi ardhur, pothuaj çdo ditë kam punuar edhe pikturë, me qëllim që t’i lë Artanit disa kujtime, sepse nuk i dihet, jeta bën të vetën dhe ma merr mendja, do ta kemi të vështirë të vimë përsëri. Më 3 shtator do të shkojmë në Venecia. Do Zoti ta kalojmë mirë. Në Shqipëri do të kthehem më 21 shtator, pasi edhe vizën ma dhanë deri në këtë datë.

Urojmë t’u gjejnë shëndoshë e mirë. Të fala të gjithëve.

Të fala keni nga Artani-Karmina dhe mbesat.

Ju përqafojmë

Leti-----Fatmiri

Bilbao, 25 gusht 1997


BOTOHET NË SPANJË “VALLËZIM ME HËNËN” I SHKRIMTARIT NAMIK DOKLE

Këto ditë u botua në Madrid libri i legjendave të Gorës, shkruar nga Namik Dokle dhe përkthyer në spanjisht nga María Rocés Gonzáles. Botuesja, Cristina Herreros Ferreira, në përcjellsen e librit shkruan:

“Në krahinën ballkanike të Gorës, e ndarë në tre shtete, e banuar nga goranët; me të folmen e tyre të veçantë, me rrënjët e origjinës në një lashtësi heretike, është fshati Borje, në pjesën shqiptare të kufirit, ku dielli lind dy herë në ditë dhe hëna perëndon dy herë natën, ku dihet se tre vajza kanë vallëzuar me hënën, ku rriten bimë dhe lule të shenjtëruara, zogjtë e Gorës këndojnë çdo pranëverë nëpër botë për t’i lajmëruar goranët të kthehen për festën e ndritur të Shën Gjergjit; atje ka ditë që hapet edhe qielli për të plotësuar dëshirat e njerëzve, ka yje që bien në prehërin e nuseve të fshatit, ka këngë e melodi që e çajnë edhe gurin dhe, aty jeton edhe një plakë treqind vjeçare që rrëfen kronikën dhe kujtesën e të gjithë kohërave.

Në këto troje ballkanike dhe legjendare udhëton Namik Dokle, i prirë nga bashkëbanorët mitikë të krahinës së tij, të cilët, për herë të parë, si në shqip edhe në spanjisht, përshtaqen në një libër.”

Kopertina dhe ilustrimet e legjendave janë realizuar nga Jesús Gabán, fitues i disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për ilustrimin e librave të autorëve spanjollë dhe të huaj.




Megjithëse ishte qen, mbante një emër njeriu. Dhe, çuditërisht, ai emër njeriu e bënte më qen se sa do ta bënte një emër qeni. Por kur e shihje në sy ndjeje se ata i kishte braktisur diçka që nuk e përcaktoje dot në i takonte asaj që i kishte dhënë emri prej njeriu apo asaj që ky emër i kishte zhdukur nga të qenit qen. Për vete nuk kisha takuar sy tronditës sa sytë e tij. Nuk e di ç'natë ishte zhytur brenda tyre që i drithëronte nga një dhimbje që nuk ishte as dhimbje njeriu dhe as dhimbje qeni. Ajo përhapej kudo dhe ti nuk e kuptoje si kalonte nëpër sytë e gjithçka që jetonte dhe merrte frymë.

Ai erdhi drejt meje sapo u largua makina. Dhe, si njeri që jam, gjëja e parë që bëra, lëvizja dorën sikur do ta qëlloja me gur. Kur prisja të largohej, ai u mblodh i gjithi, zgjati qafën si të më tregonte ku duhej ta qëlloja, nëse kisha vendosur ta qëlloja, dhe priti. Kur goditja u vonua, lëvizja ngadalë kokën dhe, ashtu, gjysmë i përkulur, më vështrroi me sytë e tij, ku nuk dalloje dot çfarë ishte prej njeriu, meqenëse mbante një emër njeriu, dhe çfarë ishte prej qeni, meqenëse ishte qen. Në vend të shihja sytë e tij (apo e pashë në sytë e tij), ndjeva se kisha ardhur në një vend të braktisur dhe të vdekur. Dhe në një vend të braktisur dhe të vdekur qentë janë të uritur. I thirra tim biri të sillte pak mish pule. Qeni u tremb nga zëri im dhe u bë gati të largohej. Ai dinte të largohej edhe pa u kërcënuar. Nuk e di përse zëri im iu duk kërcënues. Qeni më vështronte si të më thoshte: Përse me kërcënime? Trishtimi që më kishte ngjallur në fillim, kur pashë te sytë e tij se kisha shkuar për të kaluar pushimet në një vend të braktisur dhe të vdekur, u bë edhe më i mprehtë brenda meje. Atë çast ndjeva se braktisja ishte shfaqur brenda syve të qenit në të njëjtën kohë me braktisjen që u shfaq brenda qenies sime, megjithëse ishte hera e parë që shiheshim. Qeni vazhdonte të mos m'i ndante sytë, si të kërkonte prej meje t'i ktheja atë që i kishte munguar. Dhe ajo që i kishte munguar nuk ishte një copë mish pule. Por e kisha të vështirë të gjeja çfarë i kishte munguar. Dhe, për të mos u gjendur bosh, thashë përsëri se në një vend të braktisur dhe të vdekur të gjithë qentë janë të uritur.

Im bir u afrua me copën e mishit në dorë dhe nuk u tremb aspak nga qeni. Ai i foli dhe qeni lëvizti bishtin dhe më vështrroi si të më pyeste në mund t'i afrohej tim biri. U tremba se mos bashkë me copën e mishit të pulës i kafshonte edhe dorën. Dhe për herë të parë e pashë si qen. Frika ime doli e kotë. I thashë tim biri t'ia hidhte para këmbëve copën e mishit. Ishte hera e dytë që e shihja përsëri si qen. Edhe kur copa e mishit i ra ngjitur me këmbët e para, nuk e përllau, si mendova, i shtyrë nga uria. Ai nuk po m'i ndante sytë. Ndoshta ishte më i uritur se kurrë, e, megjithatë, më shihte në sy, si të priste të shuante para urisë diçka që ishte më e padurueshme se uria për një qen. Nuk durova dot dhe i fola me një zë që më habiti (si të mos i flisja një qeni, por vetes), të hante mishin e pulës. Vetëm atëherë e përllau menjëherë, si do ta përllante çdo qen që endet nëpër një vend të braktisur dhe të vdekur, siç ishte vendi ku kisha shkuar për të kaluar pushimet e verës.

Qeni, si lëpiu buzët, mori përsëri qëndrimin e parë. Më vështrroi në sy si të më lutej të mos e dëboja, por unë i tregova me dorën rrugën që duhej të ndiqte. Ai vetëm sa shkoi te dera dhe u ul rrëzë saj. Ishte një qen qime kuq, i bukur dhe dikur duhej të kishte qenë shumë krenar. Tani ishte vetëm një qen që kërkonte diçka që e kishte humbur. Se çfarë kërkonte nuk kisha si ta dija, prandaj më vrisnin sytë e tij, aq të butë dhe aq të trishtuar. Nuk e ngacmova më dhe hyra brenda të rregullonim dhomat ku do të flinin. Shtëpia ishte e madhe. Madhësia e saj e shkretoi edhe më shumë shkretinë e atij vendi. Si unë ashtu edhe gruaja ishim



lodhur nga jeta e kryeqytetit. Ndërsa këtu na lodhi sa shkelëm, shkretimi dhe heshtja.

- Mos bëmë gabim që erdhëm? - tha më na fund gruaja ime.

- Nuk e di, - thashë.

- Nuk do qëndrojmë shumë, vetëm njëzet ditë.

- Ka vende ku edhe dy ditë janë shumë.

- U pendova që fola ashtu sepse gruaja u merrziti.

- Mendova për ty, - tha ajo. - Je lodhur...

- Të dy jemi lodhur, - thashë dhe se pse shtova: - Këtu edhe qentë kanë harruar të shohin si qen.

- Çfarë?!

- Asgjë, asgjë, - thashë dhe hyra në dhomën ngjitur.

Ajo ishte tërë dritë dhe mbante ende erë pishe. Isha i vogël kur erdha për herë të parë këtu dhe ajo dhomë më ishte shfaqur shpesh si një ftesë e përsëritur. Shumë nga ata që kishin fjetur aty kishin vdekur. Tani isha unë më i moshuari që do flinte aty. Drita e heshtur e perëndimit më shtoi dhimbjen dhe se pse thashë se kisha ardhur vonë, tepër vonë. Duhej të kisha ardhur shumë vite më parë. Vetëm era e pishës nuk kishte ndryshuar. Ajo do vdiste së bashku me shtëpinë. Shtëpia më shumë se do të vdiste, do të shembej.

Dera u hap me vrull dhe brenda hyri e tmerruar gruaja. Ajo shkoi drejt e te dritarja dhe më thirri të shkoja edhe unë aty, duke më treguar me dorë oborrin. Im bir po luante aty me qenin.

- Mos ki frikë, nuk ka për ta kafshuar, - i thashë gruas.

- Ku i zihet besë qenit!

- Atij i zihet, - thashë. - Ai të vështron si të jetë njeri.

Më erdhi keq që ai qen vështronte si njeri. Gruaja hapi dritaren dhe i thirri djalit të hynte brenda. Atë çast pashë atë

që kisha parë kur zbritëm nga makina dhe na u afrua qeni. Ndërsa kur luante me tim bir sytë e tij ishin sy qeni, kur im bir u bë gati të hynte brenda sytë e tij u bënë sy njeriu. Ai e shoqëroi me sy tim bir gjera hyri brenda, pastaj priti një çast se mos im bir dilte përsëri në oborr dhe kur ai nuk doli, shkoi dhe u ul rrëzë derës së rrugës. Sytë e tij humbën ngjashmërinë me sytë e njeriut dhe u bënë sy qeni. Ai i kishte sytë si një natë e bukur vere. Djali erdhi te ne dhe ia bëri me dorë që nga dritarja. Qeni ngriti kokën dhe tundi bishtin. Muzgu në atë fshat rrëshqiste më shpejt se sa në qytet dhe po shkrihej mes errësirave të para të natës. Pylli mbi fshat nxinte. Heshtja ishte e rëndë si ta kishte lënë aty një vargan i përmortshëm. Nuk durova dot dhe i thashë gruas se do shtrihesha të flija.

- Kaq shpejt! - u habit ajo.

- Këtu nuk është asnjëherë as shpejt dhe as vonë, - thashë.

- Si të duash, - tha gruaja që nuk kishte kuptuar asgjë.

Por u pendova që kisha thënë se do të shtrihesha për të fjetur. Gjumi jo vetëm nuk po më zinte, por të qëndruarit shtrirë po më kthehej në torturë. U çova dhe pa e kuptuar e kapa veten duke kërkuar qenin. Dola në oborr dhe kur e pashë që nuk kishte luajtur nga vendi, u lehtësova. Ai ngriti kokën dhe donte të më afrohej, por se pse pata frikë. Sytë e tij dyshues ishin më se sy njeriu. Qëndroi para këmbëve të mia dhe priti. U përkula dhe i përkëdhela kokën. Sytë e tij humbën ngjashmërinë me sytë e njeriut dhe u bënë sy qeni. Dhe ai i kishte sytë si një natë e ngrohtë vere. E përkëdhela gjatë sepse më dukej sikur sapo të largoja dorën sytë e tij do të bëheshin përsëri sy njeriu. Kurse ai i kishte shumë të bukur sytë prej qeni. Nuk e mbaj mend sa qëndrova duke e përkëdhelur. Erdhi edhe gruaja me djalin.

I sollën për të ngrënë. Sa mbaroi së ngrëni shkoi dhe u shtri nën strehën e prishur të derës së rrugës. Ne hymë brenda sepse era që filloi të fryjë ishte e ftohtë, megjithëse ishim në kulmin e verës. Dhe mua m'u kujtua se natën aty frynte shumë erë edhe në verë. Tani ajo frynte në një vend të braktisur dhe të vdekur dhe ne kishim ardhur në atë vend të braktisur dhe të vdekur për të kaluar pushimet.

Të nesërmen, sapo u zgjova, dola menjëherë në oborr. Qeni, sa më pa, m'u afrua duke tundur bishtin. I përkëdhela kokën dhe i thashë të më ndiqte. Ai nguroi për një çast, si të mos u besonte veshëve që i thashë të më ndiqte, dhe erdhi i bindur. Prania e tij më hoqi disi trishtimin e ditës së mbërritjes. Zbrita drejt sheshit ku dikur ngrihej klubi i fshatit. Ai ishte i braktisur dhe po i shembej çatia. Dy pula të hutuara çukisnin barin që kishte mbirë midis gurëve. Para se të vija mendoja se kafen do ta pija aty, nën hijen e rrapit, çdo mëngjes. Por klubi po jetonte verën e tij të fundit. I rashë sheshit rrotull dhe kur ndalova, ndaloi edhe qeni. U pamë në sy. U kthym në shtëpi dhe im bir iu gëzua qenit. Kur nuk e kishte gjetur në oborr kishte menduar se qeni ishte larguar dhe nuk do të kthehej më. Ai filloi të luajë me të, ndërsa unë hyra brenda.

- Edhe klubi po shembej, - i thashë gruas. - Kafen do ta pi këtu.

Ajo shkoi të më bënte kafen.

- Po të duash ikim, - më tha kur më vuri para filxhanin e kafes turke.

- Duhet të kishim ardhur më parë, - thashë.

- Ti e di që nuk vinim dot.

- Duhej të kishim ardhur më parë, - përsërita i nxehur. - Tani as vetë nuk e di përse erdhëm. Të gjitha kanë vdekur. Unë jam më i moshuari që ka fjetur dikur këtu.

- Po të duash ikim.

- Jo, - i thashë, - do qëndrojmë.

Ajo nuk foli. Dhe unë kuptova se po më trembte vdekja. Ishte tepër herët për moshën që kisha t'i trembesh vdekjes, por frika e saj, që kishte qëndruar fshehur në qytet, u gjend zbuluar në atë fshat të vdekur dhe të braktisur. Piva kafen dhe i thashë gruas të shkonim diku për të kaluar ditën.

- Kur të bësh për të ngrënë mos harro qenin.

Ajo nuk më kundërshtoi sepse nuk donte të më shtonte mërzinë. Tërë ditën e kaluam në pyll. Sikur të mos ishte qeni nuk do dinim ç'të bënim. Ai luante me tim bir, hiqej zvarrë mbi bar dhe diku, aty mes lajthive, ndoqi një lepur të egër. Me siguri do ta kishte kapur, por se pse, kur i ishte afruar shumë, ndaloi dhe u kthye nga ne, na pa që atje ku ndaloi dhe, pa kaluar as disa sekonda, u sul drejt nesh më me shpejtësi se sa kishte ndjekur lepurin e egër. Kur ndaloi para këmbëve të tim biri, pashë se frika prej njeriu u kthye në sytë e tij në një gëzim të çiltër qeni. Atëherë e kuptova përse përpëlite midis qenit dhe njeriut. Si njeri nuk mund të ishte i lumtur, si qen, po. Dhe u kthye shumë shpejt në qen. Të gjithë, edhe gruaja, e cila me siguri kishte vënë re frikën e qenit, se ndërsa ndiqte lepurin e egër, ne, njerëzit, ishim larguar. Filluam të vrapojmë mes lëndinës të rrethuar nga lajthitë e dendura. Më i gëzuar nga të gjithë ishte qeni. Gëzimi i tij i pafajshëm na përfshiu të gjithë.

- Sa mirë që na priti një qen, - i thashë në mbrëmje gruas. - Po të mos ishte ai do kisha ikur prej këtej.

Nga jashtë erdhi një e lehur e egërsuar qensh dhe më pas lehet e përlëshjeve. Ato ishin aq të forta sa u drodhën edhe qelqet e dritareve. U përpoqa të shoh jashtë por ishte errësirë. Përlëshja sa vinte dhe bëhej më e egër. Qentë vazhdonin kacafytjen se kush do të bëhej zot i atij fshati të braktisur dhe të vdekur. E kisha të vështirë të dëgjoja të lehurat e qenit tonë. Nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë të lehte. U tremba se mos merrte plagë të rënda në atë përlëshje të egër. Nuk

doja të vdiste për shkakun tonë. Sepse me siguri nuk po ndeshje për vete por për ne. Mes shkurreve të gardhit pashë si ishin bërë njësh dy qen. Rrëmbeva elektrikun e dorës dhe zbrita me vrap shkallaret prej dërrase. Kur dola në oborr një angullimë e ngjirur po shuhej duke u larguar. Hapa derën dhe qeni erdhi drejt meje duke çaluar. U ul në vendin e tij të zakonshëm dhe filloi të lëpijë këmbën e majtë. U përkula mbi të por nuk guxova ta përkëdhel. Ai, si të mos më ndjente, vazhdoi të lëpijë këmbën. Nuk e mbaj mend sa qëndrova aty, në oborr. Kur shkova për të fjetur kisha një ngazëllim brenda vetes. Ishte një ngazëllim i panjohur, i paprovuar ndonjëherë dhe më erdhi keq që po e provoja aq vonë. Dhe para se të më zinte gjumi thashë se duhej të kishim ardhur aty shumë vite më parë. Tani, të gjitha vitet kur duhej të kisha ardhur në atë vend të braktisur dhe të vdekur më dukeshin si një armë e heshtur me të cilën kisha vlarë veten çdo ditë, pa e kuptuar.

Të nesërmen, që në mëngjes u mora me mjekimin e këmbës së plagosur të qenit. Ishte gjëja më e mirë që mund të bëja në atë vend të shkretë. Megjithatë, që të tre, unë, gruaja dhe im bir, nuk e kishim ndjerë ndonjëherë aq shumë pranë njëri-tjetrit se sa duke mjekuar këmbën e qenit. Harruam nga kishim ardhur dhe ku kishim ardhur. Ishim bashkë dhe koha dhe hapësira nuk kishte asnjë rëndësi. Dhe kur i shkrin kufijtë e rëndë të kohës je vetëm vetvetja. I vetmi kufi i prekshëm ishin sytë mirënjohës të qenit. Në qiellin e tyre rrëshqiste gjithçka që donte të ishte vetvetja.

Qeni nuk kishte asgjë prej njeriu, përveç emrit që e mësova dy ditë më pas. Deri atëherë nuk guxoja t'i thërrisja me një emër. Ajo që më habiti ishte se edhe im bir nuk i vuri ndonjë emër. Ne donim t'i thërrisim me emrin që kishte pasur dikur, sepse ashtu do të na dukej sikur kishim qenë gjithmonë aty dhe ai nuk ishte një qen i braktisur dhe i vetmuar. Kur mësuesi, që kishte ardhur nga qyteti për të gjuajtur vjedhurazi shkurta, na tha si quhej, më erdhi keq që qeni kishte një emër njeriu. Edhe tim biri nuk i pëlqeu, sepse emri nuk tingëlloi bukur. Kur i thirra dhe ai erdhi drejt meje rëndë-rëndë, emri m'u duk i shëmtuar. Ai qen duhej të kishte një emër qeni. Ndoshta nuk duhej të kishte emër. Sepse çdo emër do i vihej nga njeriu dhe duke u vënë nga njeriu, do i ngjante një rripi apo një zinxhiri që do e mbante të lidhur pas çnatyrimin. Jo më kot në fillim gjithçka tek ai ishte larg të qenit qen. Ai u kthye qen kur na gjeti ne. Të zotët e tij kishin ikur në Kanada dhe ai kishte mbetur vetëm. Vetmia e tij ishte vetmi njeriu. Kur ajo u thye me ardhjen tonë, u bë përsëri qen. Kur i tregova mësuesit për përlëshjen e natës, ai më tregoi se qeni ynë ishte ndeshur me Ujkun. Edhe të zotët e Ujkut ishin larguar për në Kanada. Ata e kishin gjetur Ujkun këlysh të vogël, e kishin marrë dhe e kishin ushqyer si fëmijë me biberon. Ai u bë një qen me hijen e rëndë të ujkut. Kur të zotët u larguan për në Kanada, u bë ujk, kur brenda lëkurës së tij përpëlitej ende qeni. Mësuesi ishte habitur si nuk e kishte shqyer Ujku qenin tonë.

- Vetëm sa e kafshoi te këmba, - thashë.
- S'më besohet!

Kurse unë e besoja. Qeni ynë, si kishte provuar vetminë, nuk donte më, që ta dëbonim, po qe se do të mposhte nga Ujku. Më shumë se me Ujkun, ishte përlëshur me veten të parë tek Ujku. Këto mendime nuk ia shpreha mësuesit. Ai e kishte mendjen të vriste vjedhurazi shkurta, që edhe pa çiften e tij ishin shfarosur pothuaj krejt. Më tha të shkoja me të dhe të merrnim me vete edhe qenin. Qeni ngriti kokën, si të kishte kuptuar përse bëhej fjalë, dhe më vështroi pa m'i ndarë sytë.

- Eja, - i thashë dhe eca drejt shtëpisë.

Mësuesi më pa i habitur dhe më thirri të qëndroja. Por nuk ndalova. Nuk mund të

shkoja për gjah me të. Aty çdo gjë ishte ose e vlarë ose e plagosur. Gjaku që po shterej ishte i padukshëm, por unë e ndjeva në tërë trupin tim. Atë e kisha parë edhe në sytë e qenit ditën kur erdha.

- Këtu vetëm duke gjuajtur mund të vrasësh kohën, - dëgjova zërin e mësuesit.
- Mos harro se ke një qen të mirë.

Nuk doja të vrisja kohën duke e detyruar edhe qenin të bënte diçka të diktuar nga unë. Doja që ai të bënte atë që i thoshte natyra e tij. Dhe natyra e tij nuk i thoshte të gjuante, por të qëndronte me ne. Ashtu ndjehej më qen. Natën e futëm brenda në shtëpi nga frika e Ujkut. Ai qëndroi aty deri vonë, por kur fikëm dritat, shkoi te dera dhe u përpoq ta hapte. Dera nuk u hap dhe ai u kthye nga ne, si të lutej ta ndihmonim. Mendova se donte të kryente nevojat dhe ia hapa derën. Para se të largohej na vështroi të treve, tundi bishtin dhe doli nga dhoma. Prita të kthehej, por ai nuk u kthye. Shkova te dritarja dhe e pashë që ishte shtrirë nën strehën e rrënuar të derës së rrugës. Nuk kishte për të fjetur natën. Do qëndronte atje, megjithëse mund t'i kishte pëlqyer më shumë të flinte me ne. Ia thashë këtë gruas dhe ajo u ngjesh pas meje.

Jashtë nata ishte e qetë, e heshtur dhe herë pas here shihnim nga dritarja si shuhej bishti i largët i ndonjë ylli. Ndoshta ishte nata e yjeve që binin. Gjumi ishte arratisur dhe ne nuk dinim çfarë t'i thoshim njëri-tjetrit. Gruaja shtrëngohej përherë dhe më fort pas meje dhe mua m'u duk sikur flokët e saj kishin thithur lëngun e barit të njomë, që nuk e njihte stinën e thatë të verës. Dhe ndërsa po më dehtë era e natës, e barit dhe e flokëve të gruas, dëgjova zërin e saj të ndrojtur, si të vinte nga largësia e thellë e viteve:

- Dua të bëjmë dashuri...

Kur në dhomë po regëntinte drita e parë e mëngjesit, ishim dy njerëz që nuk e dinim ç'moshë kishim, mbasi e kishim harruar atë. Kishim ecur gjithë natën, pa e ditur kush ishim, ku shkoni dhe ku do të mbërrinim. Gruaja, si të kishte ftohtë nga ajri i mëngjesit, ngjeshi kokën pas gjoksit tim.

- Mendoja se nuk do të përsëritej më, - më pëshpëriti.

Fryma dehëse e asaj nate nuk u shua aspak në netët e tjera. Ne ndjenim dridhjen e saj dhe po na vinte keq që do largoheshim. Dhe ndërsa e dinim se do largoheshim, qenit nuk i shkante në mendje një gjë e tillë. Ai ishte i kënaqur dhe ndahej nga ne vetëm kur binim për të fjetur. Shkonte nën strehën gjysmë të shembur të derës së rrugës dhe ne ishim të qetë. Asnjërit nuk po i dukej se ndodhej në një vend të braktisur dhe të vdekur. Ndoshta qeni nuk kishte fjetur kurrë aq pak sa flinte që kur erdhëm ne. Rrinte zgjuar tërë natën e natës dhe ndoshta frika e vetme që i shfaqej papritmas ishte frika e vjetër e braktisjes.

Ditën e fundit, për habi, nuk e pashë në sytë e tij frikën e braktisjes. Ai ishte bërë qeni që kishte qenë para braktisjes. Tërë ditën e kaluam sa te pylli me lajthi aq edhe te përroi i vogël, që sa vinte dhe po e shterte ujin. Atë ditë qeni ishte më i gëzuar se kurrë, luante me tim bir, zhytej në ujë, humbiste mes barit dhe lajthive dhe vraponte si të ishte dehur nga dashuria. Kur e shihnim ashtu harronim se të nesërmen, herët në mëngjes, do largoheshim. Ne do ta kujtonim vazhdimisht atë qen me emër njeriu. Kaq na mjaftonte për të mos e marrë dot me mend çfarë do të ishte për të ndarja. Ne do të mbartnim me vete mirënjohjen për të,

sepse po të mos kishte qenë ai, do ishim larguar shumë shpejt, të sigurt që nuk do të shkelnim më aty. Do të vinim përsëri verën e ardhshme dhe qeni do të na prishte. Mendimi se qeni do të na prishte, e ktheu ndarjen me të, në një ndarje të shkurtër. Vetëm im bir ishte i mërzhitur. Ai e ndjente më dhimbshëm nga të gjithë ndarjen. Dhe thashë se ajo ishte gjëja më e natyrshme.

Valixhet i mbyllëm sapo dëgjuam makinën që ndaloi para shtëpisë. Qeni ishte te dera e rrugës dhe nga qimet e kreshpëruara e kuptova se i kishte inat makinat. Shoferi na bëri zë nga poshtë dhe ne zbritëm. Qeni, kur na pa me valixhet në dorë, filloi të hidhte sytë sa nga ne aq edhe nga shoferi. Kur ia ngulte sytë shoferit vështrimi i egërsohej. Ai nuk e kishte parë asnjëherë shoferin, por si dukej i kishte marrë inat shoferët që kur ata morën me vete të zotët e tij që do të niseshin për në Kanada. Futëm valixhet në makinë dhe unë i hodha çelësin derës. Edhe sikur ta lija hapur, aty nuk do të vinte njeri për të vjedhur, sepse të gjithë e dinin se ai ishte një vend i braktisur dhe i vdekur. Qeni kishte ndjekur të gjitha lëvizjet e mia, si të mos kuptonte përse i bëja ato. Edhe kur djali u përlot nga ndarja, edhe kur gruaja i foli tërë dashuri, përsëri më vështroi si të mos kuptonte ç'po ndodhte. Ne sikur u lehtësuam disi nga që nuk kuptonte ç'po ndodhte. Dhe menduam se qeni do të vazhdonte jetën e tij deri sa të vinim verën tjetër. Hipëm në makinë dhe kur po mbyllnim derën pamë atë që nuk na shkoi në mendje se do të ndodhte. Qeni lëshoi një angullimë rrëqethëse dhe u hodh drejt derës së makinës, duke iu hakërruar shoferit. Unë u shtanga i gjithi, sikur shoferi të gabonte dhe të hapte derën, qeni kishte për ta shqyer. Ai filloi të gërvishte derën duke lehur. Pashë në sy gruan. Ajo ishte bërë e bardhë në fytyrë nga tronditja. Im bir filloi të qante pa zë. Lotët i rridhnin të heshtur faqeve. Qeni ishte hedhur nga dera ku rrinte ai, ngjeshi turirin pas xhamit dhe i lutej tërë dëshpërim tim biri. Ai ishte shpresa e tij e fundit.

- Nuk kemi ku ta mbajmë, - i thashë tim biri.


Shoferi filloi të shahej sepse ia gërvishti derën.

- Sa të vemi në Tiranë do ta çojmë bashkë për ta lyer, - i thashë.

Shoferi nuk foli dhe ndezi motorin. Qeni lëshoi një angullimë të thellë që u përhap mbi çatitë e shembura të fshatit, si të ishte grahma e fundit e atyre ditëve të bukura që kishim kaluar bashkë. Djali vazhdonte të qante pa zë. Qeni lutej të mos largoheshim. Sytë e tij kishin dhimbjen më tronditëse që kisha ndeshur deri atëherë. Isha i sigurt se atë dhimbje nuk do ta ndeshja më të asnjëri.

- Nisu, - i thashë shoferit se nuk po duroja më.

Sapo makina lëvizti, qeni bëri një kërcim të befasishëm dhe si i doli para makinës, u shtri ngjitur me rrotat. Shoferi ngriu në timon. Ai e harroi inatin që pati me qenin se i gërvishti makinën. Asnjëri prej nesh nuk kishte forcë të zbriste dhe ta largonte qenin nga para makinës. Nuk e di sa kohë qëndruam brenda makinës si brenda dhimbjes së qenit. Dhe ndoshta do të rrinim ashtu tërë ditën, sikur të mos ishte shfaqur përsëri mësuesi, që do vriste vjedhurazi edhe shkurta e fundit. Sa pa qenin të shtrirë para makinë kuptoi gjithçka. U ul pranë tij, i përkëdheli kokën, e ngriti më këmbë duke e tërhequr pas vetes. Qeni nguli thonjtë pas tokës së tharë nga vera pa shi. Mësuesi vazhdonte t'i fliste qenit, por as unë, as gruaja dhe as djali nuk e dëgjonim çfarë i thoshte. Veshët uturin nga angullima e dëshpëruar e qenit. Pashë si në mjegull mësuesin që po tërhiqte zvarrë qenin dhe po si në mjegull pashë edhe sytë e qenit. Ata ishin sy njeriu. Dhe ndjeva se qeni kishte për të vdekur shumë shpejt dhe ne nuk do të vinim më në atë vend të braktisur dhe të vdekur.



Onufri Tregime

Heshtja jote asht sa qielli i thellë. Ajo po më mëson me e kuptue humbjen time. Tash që dielli u shue dhe ra terri, fjalët e tua të dikurshme janë yje të natës...

Sa e sa herë u përplasa në mëdyshje cila je Ti: ajo që e bukur asht me e pa dhe bukuri përhap ngado që ecën rrugës, apo ajo që nga të gjitha pjesët e trupit shfaq bukuri të cilën e dëshmon esenca e bukurisë sate në trupin e dashtun për mue? Apo, unë vetë e kam krijuar pamjen tënde të cilën e due? Cilën pamje me e ndërtime n'këtë shkrim? Atë pamje me të cilën mundet me t'njofte gjithkush? Apo këtë pamjen tande që unë e ruej thellë në shpirt dhe që asht vetëm imja? Apo këtë pamjen tande, mbi të cilën ka ra heshtja e randë e së panjofitunës?

Në netët e gjata të vetmisë së shkrimit për ty, unë e krahasova me pakufi secilin detaj tandin me vajzat e vendit dhe tue marrë prej secilës gjanat ma të bukura, mirëpo nuk mujta as me u afrue te bukuria jote. Ti je ma e bukura e të gjitha pjesëve të bukura të vajzave që kam pa...

Dikur dritë i jepshe dhomës, gjithë shtëpisë. Ti i jepshe dritë qytetit. Kur shkove Ti, të gjitha u shuen në terr.

Me largimin tand, bota e madhe, e bukura dhe madhështorja, erdh mbas teje, Shtrigë.

Të kujtohet se si në atë fillim po e shihja me kujdes peizazhin e dashunisë si me qenë ai peizazh i natyrës së mrekullueshme herët në një mëngjes pranverë? Përmbi detajet e bukura ende nuk qe largue plotësisht terri, mirëpo tue u përqendru, tue pa përtej asaj që syni sheh, e kuptojsha që po iluminohesha në atë dashuni siç iluminohet pelegrini i devotshëm në udhëtimin e tij jetësor drejt shtëpisë së Zotit.

Po depërtojsha ngadalë përtej shqisës dhe po shihsha mbrenda territ të mrekullueshëm në të cilin Ti më ftojsh, më kishe grishë e tash po më prijshe.

Thellë e ma thellë të rashë mbrapa, magjistare.

Dashunia për ty e zgjanoi botën time larg e larg, përtej së përditshmes, përtej përvojës që na sjell koha dhe përtej asaj që të pesë shqisat na flasin një jetë të tanë.

Tash, kur e kujtoj këtë dashuni, e shoh që kam në mendje pamje të pambarim të saj: biseda, mesazhe, letra, postkarta, skica, fotografi, shënime çasti, dokumente, përshkrime, regjistrime, burime të shumta, arkiva, biblioteka, filma, poezi, gjana pa fund që munden me u radhitë si pamje ekstaze të jetës me ty. Shtrigë. Shumë.

Çdo gja për të cilën deri atëherë kisha jetue, si dija, mësimdhania, librat, pasunia, fama, nuk më kënaqshin ma. I hodha përtokë lehtas, siç hidhet pluhuni që ka ra mbi tryezë të shkrimit, para se me nisë me shkruie fjalën në letër.

Fjala ishe Ti.

Fjala je Ti.

Ti e di që unë, atëherë, i kisha të gjitha: shëndetin, familjen, pasuninë, fuqinë, të mirat, dijen, artin, të gjitha gjanat që e bajnë njeriun të lumtun... Mu atëherë rashë n'dashuni me ty dhe e pashë që e gjithë lumtunia e atyne gjanave aq të çmueshme në jetë nuk është ma të randë se një kokërr gruni n'hambarin e dashunisë, ku përfundova unë, bashkë me ty.

Erdhe në andërr. Çuditshëm: nuk isha i ngarkuem emoci-onalisht. Ti ishe diku, mirëpo më duhej me të gjetë, se kisha me e ndryshue një ngjyrë tanden. Ti ishe diçka blu e thellë, pranë së errtës, ndërsa unë duhej me të ba ngjyrë purpull, bojalli. Nji lloj piktore të cilën duhej me e ndërrue tue mos ia humbë as kuptimin, as bukurinë, mirëpo nuk ishte ashtu e mundun, se ishe Ti. Ti e pranove në tanësi atë që të thashë unë. Megjithëse na po flitshim si dy të njoftun të thjeshtë, të cilët duhej me e krye një punë të vogël, por të domosdoshme. Bashkë e bamë një copë rruge, kaluem disa pasazhe ose korridore, disa zyra të ndryshme, mandej ashtu natyrshëm Ti u largove dhe unë vazhdova me e krye edhe ma tutje atë punë, mirëpo ndërkohë e kisha shumë të qartë që po më duheshe, ndërsa nuk mundesha me të gjetë ma. Prandaj i pyetsha njerëzit e njoftshëm për ty.

ZEJNULLAH RRAHMANI

Heshtja

Tregim

E di që kishe veshë pantallona xhins dhe nji bluzë dhe ishe nji vajzë me flokët blu të haptë, si qielli i fjetun... Por unë u zgjova: nuk të gjeta. U zgjova pa të gjetë ma. Kurrë ma! Ajo ndjenja që kam nji punë, të cilën domosdo duhet me e krye, vazhdojke me qenë pjesë e mendjes sime, si e ndiej edhe tash, në këtë moment... dhe ja që të telefonoj për me qenë në nji mënyrë në kontakt, me ty edhe pse nuk përgjigjesh ma, edhe pse e di që Ti nuk përgjigjesh dhe unë jam në anën tjetër të botës, ndërsa Ti je në Prishtinë, ose diku aty, rrotull, në heshtje.

E Dashtun, bukurisë sate rrezëluese seç i kish ra nji hije hane, trishtim e lodhje bashkë.

Ra nata dhe nuk po e ndezshim dritën në shtëpi. Drita nuk u bjerr nga fytyra jote dhe prej saj bukuria ndriçonte butë-butë. Ishte magjia e femnës së dashunueme që shtrihej mbi gjanat e botës përreth dhe unë e ndiejsha atë ngroftësi... Bota e tana ishte e pasunueme nga ndjenja jote që po i influenconte sendet e shtëpisë sime. Mbreti isha unë, shërbëtori yt.

Jam i humbuni, se mbasi që fjeta prapë, prapë u ktheva në andërr me ty dhe prapë e di që të kërkova. Vazhdova me të kërkue deri në mëngjes, mirëpo nata i zhduku gjurmët dhe mëngjesi më gjeti me pak hije të zeza të

andërrës, me boshllak të pakufishëm në zemër dhe me rrathë mavi nën sy...

Tash e shoh që dashunia, çkado qoftë ajo që quhet kështu, nuk mundet kurrë me u shpjegue me fjalë të besueshme. As nuk due me e tregue me fjalë të vërteta. Çkado qoftë ajo që unë ndiej, le të mbetet përgjithmonë në figura e në art. E vërteta kishte aq shumë bukurie dhe ndjenja sa përgjithmonë ka me u varrosë me mue... edhe me ty. Ajo dritë dëshpërimi në fytyrën tande mundet me u pa sall në fytyrën e gurëve të vorreve... Përse më le?

Ti më ke dhurue disa nga mrekullitë e jetës.

Nëse ndonjiherë e kam ndie natyrën e blertë dhe ajrin, asht koha që Ti më ke dashunue. Ditët kur e kam ndie lirinë si me e ndie freskinë e ajrit dhe erën blu të ajrit të malit janë ditët kur jam dashunue në ty. Nëse ka pasë kohë që i ka dhanë kuptim jetës sime, ajo kohë ka qenë koha që ta kam kushtue ty. Nëse ka pasë nji përjetësi në jetën time, kjo asht dashunia me ty.

Në mue dashunia pat folë si art. Të gjitha kanë qenë aty: goditjet me daltë mbi mermer, shenjat e mrekullueshme të vijave, tonet fantastike të ngjyrave, shenjat e ngjashmëritë,

mashtime të errëta ndjenjash të brishta, sugjerimet e stërholla të emocioneve dhe dhembjet e mprehta që copëtojnë, aromat e padefinueshme të humbjeve e pikëllimeve...

Ti i dhe kopshtit bukurinë ku shëtisja në andërr. Veç lule të egra e parfume kurrë të shijueme fluturojshin përreth meje.

Ti je nata jeme e parfumeve.

N'atë dashuni, ndjenjat tona ishin gjethe të llojlojshme të pyllit të pashkelun... E shoh tash që i shkruiej se si po tentoj me i vendosë në rende, me i kthye gjethet që kanë ra prapë te druni i tyne dhe me i pa sa të bukura e të natyrshme që ishin dikur.

Atë dashuni kush e krijoi nga ne të tre që ishim të pranishëm: Ti, Zoti dhe unë? Cili nga ne të tre e nisi ortekun?

Secilën gjethe e marr në duer dhe e shoh sa e veçantë ka qenë secila dhe sa shumë ngjyra e muzikë ka bartë dikur, prej fillimit të qenies së saj e deri në ditën e sotit të kujtimit tim.

Ka pasë aq shumë ekspresione ndjenjash, sa shpejt e patëm kuptue edhe unë, edhe Ti, që kishim marrë krahë e po fluturojshim nëpër qiellin e paanë të kozmosit, mospërmas stuhisë së kaosit... Tash, lum mikja, unë me duer të shkruemeve të dashunisë dhe ja, po baj të pamundunën me i vu në lëvizje, po i shtyj nëpër galaksitë e fjetuna e pa mbarim të rruezave... Prushin e zemrës po e shpërndaj si zjarr të kujtesës mos me e humbë asnji margaritar të dashunisë, asnji gur të saj.

Para atij zjarri, që më kthehet në zemër me ty, dielli i verës duket si nji qiri i vogël në dollap.

Ndoshta nuk më dashunojshe vetëm si të tillë çfarë isha e jam, po më dashunojshe se vetja jote jetonte në mue? Edhe unë të dashunojshe ty jo për çfarë je në veten tande, po të dashunojshe se vetja ime jetonte në ty. Tash që mendoj për këtë, e shoh që dashunia ishte rruga për me e realizue veten tonë. Tue njoftë ashtu veten tonë, në ne e në tjetrin, na bahej e mundun me e njoftë jetën dhe plotninë e saj që nuk përthekohet mbrenda nji individi. Çdo gja në këtë univers asht e lidhun dhe asht pjesë e vetes sonë edhe nëse asht në tjetrin. Pa veten tonë të shtrime tek tjetri nuk ka botë, nuk ka Univers, nuk ka Zot. Na, në dashuni, jemi esenca e vetes, siç asht syni ynë esenca e dritës, lëkura jonë esenca e prekjes, veshi ynë esenca e tingullit, gjuha jonë esenca e shijes, truni ynë esenca e vetëdijes... Në dashuni të gjitha i kishim të lidhuna, të kuptueshme ishin të gjitha, ishim esenca e vetes sonë.

Në dashuni na ishim.

N'dashuni ishim të gjithë së bashku: Ti, unë, shtëpia, oborri, fusha, pylli, toka, oqeani, qielli, dita dhe nata, Universi, emnat tanë, na, Zoti.

A asht dashunia si jeta? Kur asht, asht e pambarim dhe e pafund, asht e ndryshme dhe e ndryshueshme, e bukur dhe bukuri...

Çka ndodh me dashuninë kur vjen fundi? A asht ajo si njeriu? Që vdes? A ekziston ma përtej fundit? Çka asht njeriu kur e humb dashuninë? Ato ditë unë kisha dashtë me u ba diell që del mbi majë të Pashtrikut për me të pa ty kudo që mundohesh me u fshefë. Ti hyn në mendimet e mia natyrshëm siç hyn drenusha në pyll dhe bredh sa do, bredh nga e shpie hapi a instinkti dhe nuk lëndohet kurrë, as kurrë nuk humb, se asht në shtëpinë e vet.

Brumbuj e grajz fluturoen rend e rend mbi lulet e gjemba-çeve. Kanë me mbledhë nektarin e tyne a me u therë në gjemba e panumërt, si unë? Le të kthehet qenia ime në gjuhën e vet, ashtu si kthehem netëve të verës në shtëpinë tonë, të lodhun dhe të gëzuem, dhe i lajmë kambët, fytyrën, bahemi të pastër për familjen tonë, për veten dhe për Zotin në ne. Nji mbramje të tillë, mbasi të përçolla ty deri poshtë te hymja, u ktheva dhe natën që kish mbetë e kalova tue ndie praninë tande në mue... Baj be që nganjherë, edhe mbas shumë e shumë vjetëve, n'momente të pastërtisë sublime, e ndiej si Ti troket në zemër... dhe ajo brubullon sikur bletë që bahet gati me dalë nga kosherja e me nisë familjen e re...

ZEJNULLAH RRAHMANI

DETI I ZI

Onufri Tregime

Të ketë qenë ajo dashuni dhe mrekulli bukurie vetëm një pikturë e bame mbi ujin e lumit që rrjedh?

Natën folëm gjatë për poezinë dhe dikur, vetvetiu tue ndëgjue muzikë...

Ti rrijshe e mbështetun te shtrati im me një filxhan kafeje në dorë. Të kishin ra mbi sup flokët all. Supet delikate të dridheshin lehtas si pemë që tundet nën peshën e borës... Te cicat që u frynë lulëzuen kokrrat e përskuquna...

O Zot! thirra përmbrenda vetes: E kam kaq pranë gruen e dashtun, që nuk mundet me u pa ma n'këtë dhë.

Poezisë së grues ia ndjeva ritmet e fshehta dhe gjithë kuptimet deri tek terri i figurave të arta... muzikën e ndjeva të tanën në dashuni, të plotën, siç e ndien toka lumin që rrjedh nëpër gjinin e saj.

Isha ato caste popul që porsa e ka fitue lirinë dhe vazhdon me jetue përtej realitetit.

O Zot! Sa afër i afrova vdekjes atë natë! Tue të shikue, lëshue ndjesish e ndjenjash të përhumbuna, në qetësinë e kënaqësive sensuale, në një çlirim a robnim të mrekullueshëm, e të frigshëm emocionalisht, fillova me e ndie dhe fizikisht, pothuajse me e pa, atë lidhje të pashembullt që po bahej mes meje e teje. Po e kuptojsha rrugën e fshehtë e të çuditshme që po kapërcente nga shqisat dhe gjithnji e ma e qartë po bahej që ajo lojë e kënaqësi po i kapërthente hapësinat e thella e të zeza shpirtnore ku lind prej fillimit e krijohet bota njerëzore...

E di, loja e shqisave po e mbushte jetën, ajo lojë shpirti po na e hapte derën e vdekjes.

Na ishim dy të verbët që i prijshim njanitjetrit rrugës së panjoftun. Nji qorr dhe nji e verbët ishim të vetëm në Pyllin e Zi: mrekulloheshim me çdo prekje, me secilin kontakt lirojshim kënaqësi e frigë të madhe, e shijojshim çdo gërvishtje, secilin lëndim, çdo aromë, çdo za të pyllit ku jetojshim...

Ka me vdekë trupi im, kur të mos jetë ma trupi yt. Kur të vdes trupi, kam me vdekë edhe unë.

Na ishim dy persona që ishim strukë në shpellë të fshehtë dhe kishim zaptue fronat e po pijshim me kënaqësi pije të ambla e të idhta. Pijshim nektar dhe pelim. Ishim të hapun për pafundësinë e ndryshimeve. Trupat tanë notojsin butë-butë në ndjesi, nëpër prekje, shijime, kënaqësi... nëpër dhembje e mall, nëpër ambëlsi e dhembje... Kishim nevojë me qenë të vetëdijshëm për atë që po na ndodhke me trupat dhe me ne.

N'terr e ndritë jetojshim njikohësisht.

Si kuaj të egër kalërojshin kënaqësitë tona.

Karroca e çmendun që fluturojke nëpër qiell e tërhequn prej yjeve ishim na. Dëshira jonë e tërhiqte nëpër rrugët e pakrye të dashunisë dhe të humbjes.

Vetëm ty të shihsha. Vetën nuk e shihsha ma.

Murg në shkreti u bana atëherë dhe Ti ishe qëllimi që përmbante shkakun e parë dhe arratisjen e fundit. Kur m'preke Ti, diçka në mua klithi: "Zgjuhu! Ndiqe mrapa në mësimin e dashunisë! Ndiqe derisa të unisohesh me të. Njihe për me e njoftë veten!"

Por Ti je në botë diku... Si me e kthye unë shikimin nga vetja tash?

Në shtëpi timen Ti ishe zjarri që digjej në votër. Kur shkojshe, ishe dielli në qiellin e kësaj bote.

Si zjarri në votër që digjet në mbramje të vonë dimni, me gjithë flakërimën në gropën e oxhakut, dashunia jote shkëlqente për të gjitha gjuhëflakët. Porsi ato dashunia shprehej në forma të ndryshme, tue pasë dalë prej të njajtit burim...

Nga dashunia jote nxejke dielli, binte shiu, fryjke era, reshke bora, vrahej e kthjellej moti në shpirtin tim.

Natë grimë kohe të dashunisë u përsërit mija herë gjithë cikli i jetës e vdekjes.

Unë tash i bana njiqind vjet në humbje. Ti nji mijë i bane. Nji-mijë-e-njiqind-e-nji jemi.

Era që fryu sot më solli kujtimin tand. Njiherë, n'të ftoftë, fryma jote e ngroftë dhe e avullt përhapej deri tek unë e unë e pata thithë atë frymë të dashtun që dilke prej gojës sate.

SHQIPTAR OSEKU

Takimi

Tregim

Sonte rashë në dashuri, shoku im, i sthathë prapë fqinjët të tavolinës në të djathtë. Ai, një diplomat i ngarkuar me shkëmbimet tregtare, kësaj radhe ishte tepër i dehur për të më dëgjuar dhe i zhytur në një bisedë pijanikësh me mikun matanë.

Darka zyrtare kishte pasur ushqim mediokër, por ishte kompensuar për shumë orë rresht me lumenj vere të kuqe parajsore, e cila u kishte rënë në kokë të gjithëve. Në këtë stad të vonë të pasdarkes mbretëronte një atmosferë e çlirët. Shfaqjet e artistëve që ndërroheshin në skenë s'i ndiqte më kush me përkushtim. Kthina e madhe e banketeve gjëmonte nga dolli dhe qeshje zëlarta që vinin nga të gjitha tavolinat.

Sonte rashë në dashuri, shoku im, përsërita, duke vënë re se gjuha më ishte trashur nga vera. Por shoku as ktheu kokën që të më shikonte.

Sytë më shkuan sërish tek ajo, ulur pranë bashkëshortit të vet, në tavolinën e


kryeparëve. Nuk kisha parë kurrë një çift aq të panatyrshëm. Ai një mjekrosh i zeshkët, i shëndetshëm, energjik në pije, zëlartë gjer në skandal me shokët e tavolinës, tamam ashtu si paragjykoreshin burrat e atyre ishujve. Ndërsa ajo antipod i tij, me një blu jonike sysh si të grabitur nga thellësitë e detit, me gjymtyrë të hajthme që ia theksonin finesën e manireve dhe një takt delikat në ndorim të njerëzve, thua se mund t'i parashikonte mendimet e tyre para se t'i mendonin.

Unë nuk kisha parë kurrë flokë si të sajtë – kaçurrelë, biondë, që i derdheshin mbi supe si rrëfim i ndritshëm dielli vere e kallinjsh të artë.

- Rashë në dashuri, - mbaj mend se i thashë shokut tim që në krye të darkës. Dhe ai, sa ishte ende esëll, më porositi gjithë alarm që të kem mendjen.

- Kemi ardhur këtu për të tjera arsye dhe burri i saj është i rrezikshëm.

- A thua të jetë e lumtur me atë bishë?
- Nuk është, të gjithë e dinë se nuk



është. Dhe kjo është arsye shtesë që të kesh kujdes. Njerëzit e palumtur të mbeten në dorë.

Si të qëndroja gjakftohtë? Çifti mikpritës ishin si bukuroshja dhe bisha. Dhe bukuroshja kishte parë *nja dy herë me kureshtje në drejtimin* tim, duke më tkurrur në çast tërë mbresat e tjera. Bisedat, dollitë, zërat, tingujt e muzikës, dritëhijet e flakadanëve, gjithçka kishte reshtur saora, për të mbetur fill e vetme në botë veç ajo, bluja e syve të saj.

E kisha dëgjuar emrin e saj edhe nga të tjerë që ishin gostitur në të njëjtën kthinë banketesh, por kisha besuar gjithmonë se bëhej fjalë për teprime. S'ma kishte thënë mendja kurrë se gjithçka që thuhej për atë grua mund të ishte vërtet e saktë. E çfarë mund të dijë një vdekatar i rëndomtë për tekat e perëndive?

Befas vura re se u ngrit nga tavolina e të shoqit e u nis drejt tavolinës së madhe me kana e karafë vere. Ku shkon vetë ashtu, mendova, për çfarë i ke shërbëtoret? Pastaj m'u duk sikur ajo m'i lëshoi sytë për një çast, në rrugë e sipër.

Kjo qe gjithë ftesa që më duhej. Zotat ndihmojnë trimin, thashë me vete. U çova ngadalë me kupën në dorë dhe eca me hapa të matur drejt tavolinës së verërave. Rrugës m'u desh të ndalem në nja dy vende, për të cakërruar kupën me të tjerë që po kënaqeshin. Në skenë kishin dalë ca akrobatë që gëlltisnin flakë dhe villnin rrëke zjarresh. M'u duk se mori dyqind vjet gjersa arrita, *më në fund*, tek tavolina ku ajo po mbushte me nge një karaf me verë.

- A ju pëlqen loja me zjarrin, zonjë?
- pyeta pa e parë në sy, teksa gjoja po shikoja një kanë me verë.

- Më falni? - pyeti ajo dhe u kthye drejt meje.

Zëri i saj më erdhi si harpë engjëjsh.
- Loja me zjarrin, - thashë dhe u ktheva edhe unë drejt saj, ndërsa bëra me dorë nga akrobatët në skenë.

- Ah, ato lojëra me zjarr... jo, ato lloje lojërash me zjarr nuk më bëjnë përshtypje, - u përgjigj ajo.

Mбай mend që qesha pa arsye dhe që ajo më ndoqi me të qeshura. Që *më nguli sytë* dhe me dorën e majtë ndreqi një rënie të padukshme flokësh: flokët e saj, që më kujtonin histori verash nga fëmijëria ime, me diell e kallinj të artë.

Në atë çast kuptova, pa kuptuar as vetë se si, se ajo do të ishte imja. Një qetësi e madhe më kaploi, një si kujtesë orakujsh, një nga ato ndjenjat e çuditshme kur të duket se gjithçka që ndodh të ka ndodhur edhe tjetër herë: kur njeriu thujase luan një reprizë dramatike.

Më vonë do të më rrëfenin orakujt se ajo ndjenjë u sajohet gjithmonë njerëzve kur luajnë skripte të shkruara nga fati.

Mbusha kupën me verë dhe ia zgjata asaj ta cakërronte.

- Gëzuar, zonjë! Për shëndetin dhe bukurinë tuaj. Mos mbetshim kurrë pa to.

Mбай mend se ajo u ndal pak, heshti dhe më shikoi për një çast amshimi drejt në sy, duke zhbërë saora gjithçka përjashta atij vështrimi.

Kur foli, zëri i saj më erdhi nga largësi, nëpër shtresa të panumërta të blusë që kishin mbështjellë gjithë botën time si shpërgënj magjie.

- Gëzuar, imzot Parid, princ i Trojës! Ardhs gjithmonë në paqe e begati!

SHKUNDA PEMËN E VITIT

Shkunda fjolla dëbore, flutura e pusulla
kristaline
Dhe shkrova mbi to çastet brengëlenëse
të vitit
Copa të vogla letrash
Regëtima dhimbjesh
Verdhërime gjethesh në xhepa
trishtimesh
Dhe drodha me to cigare

U ula pastaj me plakun mjekërbardhë
I tymosëm dhe kuvenduam gjer në
mesnatë
Hidhe, tha hirin tek kjo vazo begonje
Të harlisen lulet ngazëllime
Premtime që vezullojnë solemnisht në
pemën e motit
Nën qiej dashurish të kërcënuara.

Shkunda pemën e vitit
Rodhi vera ngritëm doli e pimë shëndete
Plaku më përshëndeti me zërin bas ho,
ho, ho
Prej dielli flakësh dhe erërash mërgate
I fali detit mjekrën shkumëbardhë
Dhe qiellit pëllumbin e buzqeshjes
Eja, i thotë të riut të zotërosk këtë lumë të
shkumëzuar
Këtë tokë që digjet dhe njerëzit e rebeluar
Dhe iku. Oh, ho, ho!

HOTEL VETMIA

Në hotel Vetmia fjeta shumë net
Duke ëndërruar për ty, tha
Duke parë kopshtin e trandafilave nga
ditarja

Thonë se atje kishte fjetur dhe Helena e
Bukur.
Bishta cigaresh janë dëshmi kalendaresh
boshe
Hije që hiqnin valle në muret e kujtesës.

Në hotel Vetmia
Më vizituan shumë poetë
Dhe më falën pendën si medalion
trishtimi
Isha robi yt dhe robi i errësirës

Dilja nga ëndrra dhe zhytesha në
zhgjendërr
Vije dhe vetmia festonte, duartrokiste
Dhe buzqeshja bëhej çelsi i universit

Hotel vetmia, hotel zhauritës i heshtjes
Dëgjoj hapa, më buzqesh dita
Me dy liqenj mirësie, ndalu mos ik

Zgjat duart në errësirë të të përqafoj
Dhe kafashoj veten si cferku
Në skëterrën e natës hotel Vetmia
Ka vetëm një ndriçim
Fytyrën tënde hënore.

Hënë e brengës sime endet natë e ditë
Tek hotel Vetmia.
Hotel luksoz pesëyesh mjalt e helm.

PEMA DHE BABAI

Shihja cungjet e përzhitura të pemës duar
lutëse drejt qiellit
Ç' lutje pa vlerë. Dhe qielli përlotej.
Atë vjeshtë vetëtimat e dogjën atë lis
krenar
Si monument në udhëkryqin e erërave

Ca muaj me vonë u sëmur babai
Arqitrau i shtëpisë
Që ngjitime malin e kohës të mbledhë pak
diell

Lisi dhe babai
Babai dhe kumbulla në avlli



Kacafytëshin me shtërngatat

Ndaj të ngrysur
Plakat dilnin në pragjet e gurta të
shtëpive
Dhe pinin kafënë në heshtje
Një diell ironik i vështronte nga ballkoni
i malit
Dhe perëndonte

Fati lëpinte llumin e kafesë nëpër filxhane
Dhe bota terratisej

Qielli ulte shamitë e zeza
Mbi ballin e horizontit dhe psherëtinte
Psherëtinin plakat ogur i motit të keq

Lisi krenar u godit nga rrufeja
Kumbulla në avlli u tha
Babai mërgoi tek Zoti

Shumë pemë u prenë me rrënjë
Pyjet po digjeshin dhe vendi përmytej
Mërgoi dhe kënga e zogjve

Ishte pikërisht atëherë kur ishin hapur
dyert e burgjeve
Dhe portat e Hadesit
Stinët ishin ngurtësuar si gurë
Dhe jeta përtypte hekur.

GJITHË GRATË KANË PROFIL MUZE

Orfeu i këndon muzës së humbur
Euridice, Euridice dil prej territ
Bëhu ujvarë drite, bëhu notë lire

Gjithë gratë e botës kanë profil muze
Dhe hyjnë në zemrën e burrave
Me sandale të kaltra
Me leshnajë diellore
Dhe pelerinë të kuqe

Në sy u digjet trandafili
Dhe u pikon pikë-pikë ëmbëlsia në buzë
Si vilë e pjekur vreshte
Tek shfaqen të mbështjella me vello
magjie

Unë nuk dua të jem muzë, the
Dua të jem vetëm grua
Që i pikon dritë qerpiku
Vetëm gruaja të bën Orfe

GJEOGRAFIA E QIELLIT BOSH

Dritarja ishte e vesuar,
Bari me brymë
Sytë të përletur
Dhe rruga si një rrudhë dhimbjeje.

Bilbili mbreti i ligjërimit
Kishte kohë që e kishte braktisur kopshtin
Ti ishe shfaqur tek pragu i një ëndrre
Dhe buzqeshje

Sa doja t'i puthja ato sy
Por s'guxoja

Gjografia e qiellit ishte bosh
Bosh qielli i Tiranës
Në një stinë amorfe
Bosh krahët e mi që digjeshin
Nga dëshira përqaftimi

Ylberi që u zgjat midis dy maleve
Lamtumirë që më thante buzën
Që ma nguroste dorën e ngritur

Si më kishe hyrë kështu në zemër
Mbështjellë me një vello të mëndafshhtë
brenge

Hyrnosje, brenjosje
Një kaloshinë endej nëpër udhëkryqe
Prangosur në zemra.

DUEL ME NARCISIN

Pse ngrihesh mbi majat e këmbëve
Ule pak kokën të lutem, tha kameramani
Hodha një vështrim indiferent për qark
Tunda supet dhe zgjerova gjoksin
Që të mbushja krejt ekranin

Kur pashë veten në lajmet e mbrëmjes
Rrudha vetullat nga neveria
Bukur the ti, princëror si nga universi
poetik

Sa kohë m'u desh të dilja nga
megalomania
Si një cferku që pickon vetveten

Ti më vështroje dhe qeshje
Nga të gjitha plagët që kam marrë në
shpirt
Ajo që më gërvishit më shumë
E ma rebelon ndërgjegjen
Është egoizmi që e shkel më këmbë
Dhe si zvarranik me shtatë kokë
Ringjallet ende

I kam bërë atentate i shpalla duel Narcisit
Po dhe me vesh të përgjakur si të Trampit
E shoh të shfaqert sërish e sërish
Tund kokën krenar i mënjanon të gjithë
Me kamer apo pa kamer shfaqet para
ekranit

Pushtet piratësh dashuri demonjake
Përqafton vetveten dhe ëndërron frone
Shtyn rremat përmes dallgëve
Shkon në gijotinë dhe në kryqin e
kryqëzimit
Dhe sërish të pjell kobzeza botë
Zvarritesh e pushton krenë si larva e
krimbi
I mbyll veshët me dyll
Mos dëgjoj kumtehundur Sirena e
Kasandra

I vura kokës bandazhe si veshit të Van
Gogut e të Trampit
Po Narcisi stoliset në të gjitha pasqyrat
Ma bën me sy ç'pret thotë shpejto
Dhe i bie alarmant daulles së tamtamit
Mjaft, thua ti le të pikojë pak gjak nga
veshi
Vetëm në dyluftim me dashurinë vdes
Narcisi

KËPUTA CA LIMONË

Këputa ca limonë sot kishin aromë
ëndrre.
Limonë jeshilë! S'i kish pikuar dielli ende
Ngjyrëverdhe vetëm shalli yt. Limonë të
papjekur
shpërthime pa mend të moshës
adoleshente.
Pa diellin venerus buzqeshjeje zbeheshin
kujtimet.
Një lot inkandeshent dhe dita! E turbullt
paletë ngjyrëtharë harruar nga koha
Pikaso.
Kanavaca e ditëve, lekosur, shplarë pa
ngjyra jete
tavolinë feste qirinshuar. Planet i
braktisur
më kthen shëndete vetmimtare mërzia,
në orën zero, sahati ngelur nga shekulli i
kaluar.
Këputa ca limonë sot mbanin aromën
tënde,
ngjyrën e fustanit, vezullimin e leshrave.
E çava një, e vura në buzë më thartoi në
palcë.
I pikët ish si ndarje e gjatë. Aromë të
largët,
Dhimbje gërvishtëse! Qielli i vranët.

ZEMRA KA KUJTESË

Zemra ka kujtesë, të pastër kristal,
jo si mendja, qilim që venitet,
as si uji që rrëmben idhujt,
duke vrapuar vrullshëm drejt detit,
por flakë e pamëshirshme që digjet, natën
- ditën.

Beharet fshihen në prekjen e duarve,
çastet lulëzojnë në pëllëmbët e mia
si jaseminë që presin flad jetdhënese.

Dhimbja ka kujtesë, është pemë me rrënjë
të thella,

mban lotin tënd si vesë në gjetnajë,
brençën si kord lire Orfeu, të
pavdekshëm.

Çdo vështrim, vetëtimë,
çdo puthje, shkëndijë prush i ndezur.
E djeshmja pëshpërit ende
tinguj që vetëm zemra di të dëgjojë.

Zemra kujton fladin e floknajës sate,
kripën e lotëve - deti më i njelmët,
dhe yjet e rënë
kur u betove në heshtje:
Koha do të zbehët, dashuria do të mbetet.

Metal i skuqur, kujtimi i zemrës
nuk përkulet, nuk shkrihet.
Është zjarr që ushqehet me itenerare
e mistere brençash për ato që nuk u thanë
kurrë.
Është fara që rritet në arat e kohës.

Dhe në frymën e fundit të natës,
kur drita zgjon heshtjet,
dhe përmes lotëve të agut
trandafilat buzëqeshin, zemra mban
mend.
Vetëtimat e saj ndizen në të gjitha
dritaret:
Një jetë, një prekje, një puthje, përjetësia,
që vetëm zemra di të shënjtërojë me
kohën që ikën.

PSHERËTIMË

Pas xhamit psherëtiu vjeshta
Dhe rrokopuje derdhi tufa gjetesh
Letra të postuara nga stinë të largëta
Që pa u trasnkriptuar mesazhet treten.

Psherëtiu deti dhe me solli
Një kujtim diellor nga vera.

Psherëtime ti dhe u mjegulluan qelqet
Dhe qielli veshi bizhu ylberesh
Psherëtiu pylli me ca cicërima
Që shtegëtuan tutje nëpër botë.

Psherëtiu gjoksi im me imazhin
Kokën e Afërditës mbështetur mbi sup.

Psherëtime pemët, lulet, zogjtë
Psherëtime brençë, psherëtime sqotë.

Befas të gjitha psherëtimat u kondensuan
Në ca pika të përflakura lotësh
Që më dëgjin buzët e zemrës.

PSE VDES NJË DASHURI?

Stinët ndryshojnë, oh, sa shpejt
ndryshojnë stinët
gjethet rrotullohen në valle të harruara,
zogjtë vizatojnë vija në qiell, pentagrame
lirie
duke grisur mishin e kohës.

Lulet, lulëzojnë, vyshken, përkulen,
duke lënë aromën e tyre të harrohet
në rrënoja ngjyrash, në duar që
dashuruam marrëzisht
fryma e fundit para boshllëkut.

Dhe dashuria, pse vdes një dashuri?
Mos vallë fshihet në plasa drite?
Mos vallë shkrihet në pëllëmbët tona të
lodhura,
tekta shtrëngojmë të pamundurën?

Apo thjesht bëhet erë,
që na shtyn në dashuri të tjera
mos bëhet imazhe që vrapojnë mbi ujë,
mos bëhet kujtesë,
flakë që digjet pa dritë -
e përjetshme dhe inekzistente bashkë?

Ti thua se e di pse vdes një dashuri,
por nuk dëshiron të më lësh të më
shqyejnë
çakejtë me kthetra faji dhe pendimi.
Dashuria, thua, është një preher
vetëtimash.

DITËT JANË TË LODHURA

Ditët janë të lodhura.
Ditët e mia.
Një diell xhelatinoz rri varur
Në cepat e syve të horizontit.

Si mund ta shqyjej këmishën e trishtimit
që më mbështillet në trup si këmisha e
centaurit?
Nuk mund ta shqep kursesi.
Ndaj arnoj me arna të kaltra
Coprat e zbërdhlyura të gëzimeve të mia.

Ditët janë të lodhura.
Janë lodhur nga brutaliteti.

Bishërohen njerëzit, pemët, gurët.
Eci udhëve
dhe hije ime më ndjek
si një qen.

KËMISHA IME PREJ REJE

Këmisha ime prej reje
qepur nga rrobaqepsja vjeshtë
me fije rrufeje
u lag shtatë herë
gjashtë me lot dhe një me vesë trëndafili.

E ndera për tu tharë
në telin e ndryshkur të shpresës
dhe e dogji dielli i dëshpërimit.

Dhe mbeti dordolec në arën shterpë të
shqetësimit.
Vijnë dhe i klithin zogj fajtorë,
e rrëmbejnë erërat, e lajnë shirat
dhe e hekurosën dashuri fantazma.

Korbat ulen mbi supet e tij,
ku uleshin dy duar
pëllumba të butë ledhatimi.

Sqepojnë shkujdesur
fara gëzimesh të huaja
dhe sy të ëmbël dashurish të plagosura.


Këmisha ime - re dordolec
tund mëngët bosh me fije rrufeje
dëshira invalide në qiellin e zvetënimit.

TË TRADHËTOVA MBRËMË

Të tradhëtova mbrëmë, tha
Siç tradhëtojmë me sy, me trup, me buzë
e fantazi
Po me zemër jo, kurrsesi.
Hodha vello kombinezonin e qëndisur të
prillit
(Me siguri prilli provokues ishte fajtori)
Vesha pazmoren e një ylli, ktheja gota me
fund

Dhe tradhëtova vetveten
(Fajin e kishte hëna që s'buron dritë të saj
Po merr dritësim nga një planet tjetër)
Vera me urdhëronte të bëj divorc me
ndërgjegjen
Zbraza kaosin nga vetja
Dhe u nisa ta mbush me një kaos tjetër.
Ishte një tradhëti tjetër që hënëzonte në
sy

Me simptomat e tradhëtisë së vjetër sa
bota.
Të tradhëtova mbrëmë duke bërë flert me
poezinë
Po gjithsesi asnjë tradhëti nuk të fal
lumturi.



LUERDA C.
AVDIAJ

poezi

dromca të trishta

nën qiellin e nëntorit bie shi
shpirtëzimi i vjeshtës bëhet këtej xhamsyrit
dhe unë hesht nën jorganin e bardhë me aromë ëndrrash
zbardh dita
aroma e kafes tërheq trupin prej shtratit
libri i poezisë rënë përtokë është
shiu dëgjohej shumë
ajo fle ëmbël
ai ende nuk ka ardhur
koshi është plot me rroba që presin të lahen
orkidea po zhvishet çdo mëngjes
gjella e mbrëmjes harruar mbi sobë
frutat u bënë një javë ende pa u ngrënë
çast frymëmarrje
aroma e kanellës prej qirinjve ka mbushur guzhinën
dhe unë mbi kolltukun ngjyrë gjaku
vazhdoj të shoh shpirtëzimin e vjeshtës pa bërë zhurmë

* * *

asnjë dromcë buzëqeshje
shikimit tënd vjeshtak nuk duket
prej kohësh
po vjeshton edhe ti si stina
pa fjalë heshtjes tënde që veç ti di ta kumbosh
gjer tek unë
dhe qetësia ime të marrë fund ekuilibri im të prishet
dhe vetja bëhet rrëmujë në fund të filxhanit me kafe
mbi kolltukun e kuqërremtë
asnjë dromcë buzëqeshje nuk dhuron më
po padyshim mban ende zi për vetveten e shkuar ti

vjen harrimi dhe të gjen buzëvetes
nga fryn era e vetmisë prej një shekulli
pa neonët që trembin frikën e vdekjes
të gjen fillikat me krahët mbetur bosh
drejt deteve që nuk puthen më
dhe ti asgjë asgjë
këndon tingujt e heshtjes si në ditët e vdekjes së babait
trishtimi me krah qielli mbërthen shpirtin
bregut syve të pagjumur
pastaj bie vjeshta supeve të tua

fliste vdekja krahëve pulëbadhave
horizonteve të atdheut tim
që prej kohësh s'ia kam puthur dheun
as valët e as qiellin
peshkatarët ua falën jetën peshqve veç një ditë sa vdekja të puthte
tokën
edhe veten zhyetën thellësive
prej së cilave asnjë copë qielli nuk dukej
fliste vdekja një ditë në të cilën është më e gjallë se të gjallët
pastaj heshtje që i shpallë luftë kujtimeve
ti dhe unë mbesim me sy andej nga rrahin krahët pulëbardhat
për një grimcë shprese
fliste vdekja dhe e gjalla botë heshtte

FRANZ KAFKA OSE ANKTHI EKZISTENCIAL

Nga Feride Pappleka

Epilog

Më 1924, në moshën dyzet e njëvjeçare, shuhej në një sanatorium pranë Vjenës, Franz Kafka, i cili, sipas kritikës botërore, është një ndër katër shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit XX : (Joyce, Proust, Kafka, Borges), krijues i një proze të re moderne, në të cilën përshkroi njeriun e pafat. Pak përpara vdekjes, ai i pati shkruar, mes të tjerash, Max Brod-it, mikut të tij të ngushtë, se duhej « të digjte gjithçka që mbetej nga vepra e tij ». Brod-i nuk iu bind dëshirës së fundme të mikut të vet duke i dhuruar letërsisë veprën e një shkrimtari të rrallë. Dorëshkrimet që shpëtoi dhe botoi Max Brod-i, gjetën jehonë të menjëhershme. Lexuesit panë në veprat e Kafka-s shkrimtarin më pesimist të shekullit, por të kthjellët dhe vegimtar.

Jeta e tij në disa data

Franz Kafka lindi në Pragë më 1883 në një familje tregtare hebreje. Gjyshi i tij ishte shpërngulur prej një qyteti të vogël çek gjermanishtfolës që në shekullin XIX dhe që vendosur në Pragë. Kafka pati edhe dy vëllezër që vdiqën të vegjël dhe tri motra dy prej të cilave, Gabriela dhe Valeria u vranë si çifute më 1942 dhe e treta, Otilia përfundoi në Auschwitz dhe vdiq atje në shtator 1943.

Ai kalon një fëmijëri thujse vetmitare. Gjuha e tij amtare është gjermanishtja si për një përqindje të konsiderueshme të popullsisë së Pragës në atë kohë. Edhe pse nuk ka lidhje të forta me nënën e vet, që përjetonte zinë e dy djemve të vdekur, ai e sheh veten të lidhur më tepër me familjen e saj intelektuale, sesa me familjen e të atit, e dhënë pas tregtisë.

Në vitet 1889 deri më 1893 Franz-i ndjek mësimet e para si nxënës i dalluar. Ai merr pjesë bashkë me familjen në ritet fetare. Pas mësimeve të para pranohet në kolegjin shtetëror të Pragës. Më 1901 mbaron kolegjin dhe shfaq interesa për letërsinë (shkrimet e para nuk njihen) dhe për idetë socialiste. Pushimet e shkollës i kalon në fshat te daja i vet, mjek. Pas maturës (1901), në verë, ai viziton dy ishuj gjermanikë në Detin e Veriut. Në vjeshtë fillon studimet në universitet. I nis studimet për kimi, por e



Franz Kafka bebe, 1884.

ndërron degën dhe regjistrohet për drejtësi duke ndjekur edhe kurset për gjermanistikë dhe histori arti. Bëhet anëtar i një shoqate studentore që organizon veprimtari letrare. Po atë vit ai njihet me poetin Max Brod.

Karriera

Më 1906 merr titullin doktor në drejtësi dhe bën një vit stazh në gjykatën e Pragës. Në nëntor 1907, hyn në punë në një kompani sigurimesh tregtare, por pas disa muajsh jep dorëheqjen, sepse orët e gjata në punë e pengojnë t'i përkushtohet letërsisë. Sidoqoftë, ai është i detyruar të gjejë një vend pune në një kompani tjetër sigurimesh nga aksidentet. Më 1909 boton esetë e para në prozë në revistën *Hyperion*. Puna burokratike e rëndonte, sepse ekzistenca e tij ishte gjetiu, e gjitha e përqendruar te pasioni i tij : të shkruarit. Kafka e klasifikon punën që bën si një punë « për të fituar bukën e gojës ». Në shtator 1909 ai udhëton për në Itali me dy vëllezërit Brod që të marrë pjesë në takimin e parë ndërkombëtar të fluturimeve ajrore. Për herë të parë ai sheh avion dhe shkruan një reportazh që botohet në një variant të shkurtuar në revistën *Bohemia*.

Në vitet 1909 dhe 1912 njihet me rrethet anarkiste të Pragës. Mendime anarkiste shihen edhe në disa vepra të tij të kësaj kohe si *Kolonia ndëshkimore* dhe *Procesi*. Biografët e tij i përshkruajnë marrëdhëniet me të atin të vështira, sepse ai e mendon të birin si vazhdues të ndërmarrjes së tij tregtare. Për pasionin e të shkruarit Kafka sakrifikoji tërë kohën e tij të lirë. Kështu ai i prishi dy herë fejesat, fillimisht me Felice Bauer, me të cilën ka një korrespondencë të pasur, pastaj me Julie Wohruek dhe u jep fund marrëdhënieve me Milena Jesenska-Pollak (përkthyesja çeke e veprave të tij) shkrimtare anarkiste, të cilës i shkruante çekisht. Në një nga letrat drejtuar Milenës (*Letra Milenës*, botuar nga Arka e Noes) ai i shkruan: "Thika që unë e kthej kundër vetes, ajo quhet dashuri". Miqtë e tij të ngushtë janë Max Brod, shkrimtar, një filozof dhe një pianist. Ai punoi deri në pensionin e parakohshëm më 1922, kur iu shfaqën haptaz shenjat e tuberkulozit.

Më 1923 Kafka shkon disa kohë në Berlin



Motrat : Gabriela, Valeria dhe Otilia, nga të cilat dy të parat u ekzekutuan më 1942 nga nazistët dhe e treta vdiq në Auschwitz, më 1943.



duke shpresuar se do të përqendrohej më shumë në punën krijuese. Në këtë kohë ai njihet me Dora Diamant, një mësuese çifute poloneze me besim ortodoks. Dora ushtron një ndikim pozitiv në interesat e tij, miqësia me të e bind se ai mund të bëjë një jetë bashkëshortore që e quante të pamundur. Ata mendojnë që së bashku të emigrojnë në Palestinë. Ai nisi të mësonte edhe hebraisht. Atij i bie në sy se gjermanët dhe hebrenjtë e urrejnë njëri-tjetrin. Kafka bëhet mbrojtës i një humanizmi liberal.

Shëndeti

Qysh më 1917 Kafka fillon të pështyjë gjak. Kjo gjë ka ndikuar shumë edhe në prishjen e fejesave. Por, veç kësaj, ai e sheh të shkruarit si pengesë për një jetë familjare « normale ». Ai ka shenja hipokondrie, vuan edhe nga depresioni klinik dhe fobia sociale, siç mendohet sot. Ka edhe shenja që lidhen me stresin si : migrenë, pagjumësi etj. Duke mos i besuar shumë mjekësisë shkencore, ai përdor më tepër barna popullore.

Edhe pse gjendja e Kafka-s u përmirësua pas vajtjes në Berlin, ai ka humor pozitiv dhe shkruan shumë, inflacioni i dimrit 1923-1924 që i kobshëm për shëndetin e tij të paqëndrueshëm. Ushqimet bëhen të rralla dhe duhet t'i porosisë në Pragë, për më tepër shtëpia e pangrohur mirë, ndikon keq në gjendjen e tij shëndetësore. Kur e viziton miku i tij Max Brod në mars 1924, Kafka është rënduar aq shumë, sa ai e merr me vete në Pragë. Në prill i diagnostikojnë tuberkuloz edhe në laring. Kuptohet që Kafka është i dënuar me vdekje, sepse në atë kohë nuk ishin zbuluar ende barnat që shërojnë tuberkulozin dhe që ai ushqehet përditë e më vështirë nga sëmundja e grykës. Kjo situatë duket në shumë fragmente të novelës *Artisti i urisë*.

Veprat më të njohura të tij siç janë novelat *Metamorfoza* dhe *Kolonia ndëshkimore*, si dhe romanet *Procesi*, *Kështjella* dhe *Amerika*, kanë rrëfime të ankthshme dhe distopike, në të cilat protagonistët përjetojnë ftohtësinë e një bote që i mungon ndjenja e dhembshurisë, e cila çon në vetmi.

Komentar

Kafka është shkrimtar çek, i cili e shkroi veprën e tij gjermanisht. Me një trashëgimi kulturore të trefishtë : i dalë nga borgjezia tregtare, çifute e gjermanizuar, duke jetuar në gjirin e një popullate çeke nën perandorinë austro-hungareze, ai u ushqye nga kjo traditë kulturore me tri burime : nga tradita çifute, «fantomë e judaizmit», siç e quan ai, në të cilën edhe u rrit ; ai hodhi poshtë traditat e ngurta, por duke filluar nga viti 1910, zbuloi letërsinë *yiddish*, *Biblën*, tekstet *hasidike* dhe *gjuhën hebraike*, gjithë duke dëshmuar edhe një lloj interesi për lëvizjen sioniste, në të cilën e tërhiqte ideali i bashkësisë. Përsa i përket trashëgimisë sllave ai lexoi autorë rusë (sidomos Dostojevskin), mësoi për teoritë socialiste dhe anarkiste si ato të Hecerenit dhe Kropotkinit, mori pjesë në rrethet e avantgardës çeke. Dhe së fundi ai i bëri studimet në gjermanisht, duke përvetësuar trashëgiminë kulturore gjermanike. Megjithëse ishte e pasur, kjo situatë që për Kafka-n shumë turbulluese, se e thelloi ndjesinë e ndryshimit dhe thujse e bëri të pamundur integrimin e tij në rrethet kulturore të Pragës.

Pasioni i të shkruarit

Si shkrimtar Kafka ishte shumë dyshues dhe kërkues ndaj asaj që shkruante. Shumica e dorëshkrimeve të tij janë të papërfunduara ose të ndërprera. Por ekzistenca e Kafka-s kërcënohej nga një pasiguri më zanafillore e më e thellë : ky njeri i brishtë, që vuante nga dhimbjet e kokës dhe pagjumësia, shumë më herët se të prekej nga tuberkulozi, kjo genie që nuk mund të lirohej krejtësisht nga tutoria atërore dhe imazhi i saj (*Letër babait*, u shkrua më 1919, por që nuk u dërgua kurrë), u përpoq dëshpërimisht të luftonte kundër gjithçkaje që mund ta detyronte të ishte i ndërvarur, ta skllavëronte, por që e pagoi me çmimin e një vetmie që u bë pak nga pak e plotë dhe një thyerje gjithnjë e më e madhe mes unit të tij të brendshëm dhe botës së pazbërthyeshme, thujse armiqësore të jashtme.

Ankthi ekzistencial

Ditari i Kafka-s dhe korrespondenca e shumtë kanë një rëndësi vendimtare për të kuptuar kundërshtinë e tij, ankthin dhe vetë veprën. Me një gjuhë të përkorë dhe të përpiktë në romane dhe tregime, me humor syrealist ai përpiket të ndriçojë jetën e përditshme duke e futur lexuesin në një univers ireal, i cili të shkakton një përshtypje të ankthshme për jetën. « Fantastika » e tij absurde dhe mizore e bën thujse të padurueshme përvojën e dallimit midis njeriut dhe botës, të ndërgjegjes së mbërthyer në një trup « të huaj » (tema e metamorfozës », Ardian Klosi e shqipëron *shndërrimi*, por jo të gjitha termat e huaja mund të zëvendësohen), të fajshëm, pa ndonjë motiv të dukshëm, përballë labirintit të një bote të papërkryer. Lexues të ndryshëm kanë gjetur te *Ditari* i shkrimtarit njeriun e vërtetë, dhe kjo gjë i ka nxitur drejt veprës së tij me tipa të veçantë që mund të vihen krahas karaktereve të paharrueshëm të veprës së autorëve të mëdhenj të letërsisë botërore. Jozef K. ka diçka nga secili prej nesh, nga jeta jonë e përditshme që na përplas ndonjëherë me një burokraci të llahtarshme.

Vepra

Vepra e Kafka-s pak e njohur në gjallje të tij, e mohuar nën regjimin nazist, u zbulua në pjesën më të madhe të saj për Europën dhe botën pas Luftës së Dytë botërore. Ajo përmban romane, tregime dhe novela : *Përshkrimi i një beteje* (1906), botuar

pjesërisht më 1909 ; *Përgatitjet e dasmës në fshat* (1908) ; *Soditje* (1908), *Metamorfoza* (1912), botuar më 1915 ; *Vendimi* (1912), botuar më 1916 ; *Kolonia e riedukimit* (1914), 1919, Një mjek *fshati* (1916), 1920 ; *Hidhërimi i parë* (1921) ; *Kampioni i urisë* (1922) ; *Një grua e vogël* (1923) ; *Strofska* (1923) ; *Jozefina, këngëtarja* (1924) ; *Muri i Madh kinez*, (1919) botuar më 1930, dhe tri romane : *Procesi* (1914), 1925 ; *Kështjella* (1922), 1926 ; *Amerika* (1911-1914), botuar më 1927, etj.. Pastaj janë botuar dhe ribotuar disa vepra, si dhe *Artikuj*, *Jetëshkrime*, *Ditare*, *Letra*, *Biseda*, *Diskutime*.

Kafka mbahet si njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit XX, i njohur veçanërisht prej romaneve *Procesi*, *Amerika* dhe *Kështjella* si dhe prej novelave *Metamorfoza* dhe *Kolonia ndëshkimore*. Vepra e tij krijon një atmosferë makthi e frike, në të cilën burokracia dhe vetë shoqëria ushtrojnë shtypje te individit. Hendrik Marsman, shkrimtar hollandez në librin *Prozë kritike* e përshkruan këtë atmosferë si një « objektësi jashtëzakonisht e çuditshme... » (f. 85). Personazhet e Kafka-s janë simbole të njeriut të shkulur nga identiteti në kohët moderne. Disa mendonjë, megjithatë, që ajo është një përpjekje në luftën e dukshme me « forcat e epërme » për ta lënë njeriun që të bëjë zgjedhjen e vet duke qenë vetë i përgjegjshëm për këtë.

I thirrur më 1978 në serinë e emisioneve të radios France-kulturë, « Një njeri, një qytet : Kafka në Pragë », Milan Kundera nuk e pranon idenë se Kafka e ka parandier shtetin totalitar. Ai bën një shpjegim më pak të mistershëm dhe thotë se Kafka nuk është parashikues i të ardhmes, por një vëzhgues i kthjellët dhe i mprehtë i realitetit të tij dhe i shoqërisë në të cilën jeton. Për Kunderën ai ka një lloj të shkruar me përmasa universale. Vepra e tij me elemente realistë që përzihen me fantastikën, është një vepër e mrekullueshme që i shpëtoi « humbjes ».

Mjeshtëria e shkrimtarit

Kafka e quan të shkruarit si një domosdoshmëri të brendshme. Për atë është një « veprimtari e tmerrshme », e cila kërkon « një hapje tërësore të trupit dhe shpirtit ». Në një letër dërguar një miku të tij, ai shkruan : « Një libër duhet të jetë sëpata që çan akullin brenda nesh ». Disa rreshta më poshtë ai vazhdon : « Nëse libri që lexojmë nuk na zgjon me një grusht në kokë, përse duhet ta lexojmë ? ». Kafka thotë se duhet shkruar « sikur gjendesh në një tunel të errët, pa e ditur ende si do të sillen personazhet ».

Botimet

Gjatë jetës Kafka botoi vetëm disa tregime të shkurtra, midis tyre edhe novelat *Metamorfoza* dhe *Kolonia ndëshkimore*. Romanet e shquara : *Procesi*, *Kështjella* dhe *Amerika* janë botuar *postume* nga shoku i tij Max Brod. Në letrën që i la disa kohë para se të vdiste, ndër të tjera, ai i shkruan : « Ja, Max i dashur, lutja ime e fundit : gjithçka që mund të gjendet pas vdekjes sime (*domethënë, në bibliotekën time, në dollap, në sirtar, në shtëpi, në tryezën e punës dhe në çfarëdo vendi qoftë, çdo gjë që lë, fletore, letra personale apo jo personale, etj.*) duhet të digjet pa kufizim dhe pa u lexuar. Gjithashtu duhet të digjen edhe të gjitha shkrimet apo shënimet e mia që ke ti, apo edhe të tjerë dhe që ti do t'i kërkosh. Nëse ka letra që nuk duan t'i kthejnë, së paku duhet t'i djegin. Yti me gjithë zemër, Franz Kafka ».

Brod-i, i përballur me dysinë etike : të respektonte dëshirat e fundme të mikut të vet, apo të ruante trashëgiminë e tij letrare për brezat e ardhshëm, vendosi për këtë



Franz Kafka nxënës, para vitit 1900.

alternativë të fundit duke ia kushtuar jetën botimit të veprës së tij, *postume*. Vendimi i tij ishte fat për letërsinë botërore. Kështu më 1925 ai botoi romanin *Procesi*, librin më domethënës të tij, më 1926 dhe 1927 dy romane të tjera : *Kështjella* dhe *Amerika*. Pastaj të tjerat çdo vit.

Lidhur me dorëshkrimet e Kafka-s që Brod-i nuk i kishte shtënë në dorë para luftës, ishte Gestapo-ja që i kënaqi dëshirat e fundme të Kafka-s. Sipas kujtimeve të Dora Diamant-it, shkrimtari edhe vetë, kur ishte në Berlin dogji disa dorëshkrime, midis të cilave edhe një pjesë teatrale.

Max Brod-i i botoi romanet e mëdha të Kafka-s, por çfarë kishte tjetër nga dorëshkrimet që nuk arriti t'i botonte para fillimit të Luftës së Dytë, natën që nazistët pushtuan Pragën në mars 1939, ai ia doli t'i çonte në Poloni e pasatj në Tel-Aviv. Në gjallje të tij Kafka nuk kishte tërhequr vëmendjen e kritikës edhe nga botimet e pakta që bëri ai vetë si autor me kërkesa të mëdha ndaj të shkruarit. Disa tekste të Kafka-s janë të pambaruara, si bie fjala *Kështjella* ka ngelur në mes të një fraze, po ashtu *Procesi*, ka disa mbyllje dhe Brod-i ka zgjedhur njërin, duke i lënë si shtojcë në fund të librit ndryshorët (versionet) e tjerë. Ashtu veprimi ai me të gjitha dorëshkrimet duke shpalosur para lexuesit një vepër të hapur.

Fama

Gjeninë e Kafka-s, para publikut francez e zbuloi së pari shkrimtari Aleksandër Vialate qysh me përkthimin e romanit *Procesi*. Më pas ai vazhdoi me novelën *Metamorfoza* dhe me *Letra Milenës*. Ai botoi gjithashtu disa artikuj kritikë të rëndësishëm për shkrimtarin çek dhe e titulloi « *Mon Kafka* ». Max Brod-i botoi më 1937 librin « *Një jetëshkrim* » për Franz Kafka-n nisur nga kujtimet e veta dhe dokumente të ndryshme të shkrimtarit. Ai botim u përkthye dhe u botua nga Gallimard më 1945. Më vonë botoi një analizë Gilles Deleuze e të tjerë. Nga Franca përkthimi i Kafka-s vazhdoi në shumë vende të botës. Më 1976 Kafka u botua në Bibliotekën e Plejadës franceze, që u përtëri me një përkthim të ri nga Jean-Pierre Lefebvre, më 2018.

Botuesi anglez Malcolm Pasley, më 1961 arriti të siguronte pjesën më të madhe të dorëshkrimeve të shkrimtarit dhe i ka grumbulluar në *Bodleian Library* të univerisiteti të Oksfordit. Pasley, organizoi një grup që punoi për të dhënë në botime origjinalin e veprave të shkrimtarit të madh çek.

Veprat kryesore

Metamorfoza, është një rrëfim tronditës për fatin e njeriut. Gregor Zamza (Samsa),



Franz Kafka, 1906

zgjohet një mëngjes i transformuar në një « insekt të mistershëm ». Kjo novelë është edhe një nga më të fuqishmet që ka shkruar Kafka. Disa kritikë e quajnë roman të shkurtër dhe e cilësojnë kryevepër të tij. Ai e vendos fillimin e ngjarjes në një mëngjes, me zgjimin që personifikon jetën që vazhdon, por edhe shpresën dhe projektet e reja. Por të gjitha këto turbullohen kur personazhi i tij e ndien se nuk ngrihet dot si zakonisht. Gregor Zamza simbolizon gjithë të përjashtuarit për arsye të ndryshme nga kjo botë e ashtuquajtur « normale ». Lexuesi e kupton se metamorfoza e Gregorit është metamorfoza universale e individit të rrethuar nga vetmia dhe vdekja. Duke përshkruar situatat absurde, autori lë të nënkuptohet një kritikë shoqërore lidhur me varësinë, me mungesën e solidaritetit familjar dhe me shpërfilljen.

Pak historik për novelën “Metamorfoza”

Kafka e fillon veprën siç shkruan në Ditar, një të dielë, më 17 nëntor 1912. Ai ka ndenjur gjatë në shtrat në shtëpinë e prindërve, e quajtur « Anija » në Pragë. Një natë më parë ai ka punuar gjer vonë për romanin *I humburi* (Amerika). Dhe e ka zënë gjumi me idenë se nuk i ka ecur puna me romanin. Ai rri ende shtrirë, sepse pret një letër nga Felise Bauer. Letra vjen dhe ai përgjigjet : « Sot do të përshkruaj një ngjarje të vogël që më erdhi në mendje në shtrat kur isha fare shpresëhumbur... ». Edhe protagonist i tij si autori ka një vështirësi të pabesueshme për t'u ngritur nga shtrati. Autori e shkroi novelën për disa javë, kur e kishte menduar për një kohë më të shkurtër, sepse tregimin *Vendimi* ai e pati shkruar më 22 duke u gdhirë 23 shtator 1912. Fillimisht *Metamorfoza* u botua në tetor 1915 në Leipsig në një revistë dhe pastaj si libër në koleksionin « Gjyqi i fundit » në dhjetor 1915.

Romani *Procesi* është një nga rrëfimet më simbolike të shekullit XX, i vështuar nga kritika si një kryevepër e letërsisë. Ai është një vepër *postume* e Franz Kafka-s, i shkruar në verë të vitit 1914 deri në janar të vitit 1915 e që u botua nga Maks Brod-i, një vit pas vdekjes së autorit, më 1925. Në roman jepen telashet e çuditshme të Jozef K., i cili një mëngjes arrestohet pa shkak dhe u nënshtrohet kërkesave të drejtësisë. Është mëngjesi që daton me tridhjetë vjetorin e ditëlindjes. Protagonisti është punonjës banke dhe banon në një pension. Dy agjentët e policisë janë të mistershëm, nuk i thonë as arsyen dhe as nga cili autoritet janë urdhëruar. Kur lexojmë në fillim të romanit : « *Një mëngjes atë e arrestuan, megjithëse s'kishte bërë asnjë të keqe...* », mbetemi pa fjalë, ashtu si Jozef K. Romani ilustron në mënyrë të përkryer vuajtjen e individit përballë një bote absurde që i

nënshtrohet arbitraritetit dhe ecën në një labirint burokratik çorentues.

Jozef K., i ndodhur mes realitetit absurd dhe ekzistencës së tij të pasigurt, përpiqet që të sqarojë pozicionin e vet të pafajshëm për të gjetur një përgjigje, por nuk e gjen kurrë. Procesi jepet si një episod që ndërfitet në jetën e heroit, me një përzjerje të përshkrimeve të sakta dhe hollësive absurde, të cilat të krijojnë përshtypjen e një makthi. Ky ligj i përbashkët, që rrethi shoqëror i protagonistit e merr si të mirëqenë, atij i ngjason tërësisht abstrakt dhe i paqartë. Ai sheh në të vetëm hije me konture të pafundme. Sipas Kantit një mënyrë e tillë nuk lejon konstruksionin e asnjë ligji moral. Kështu Franz Kafka duket sikur ekspozon antiheroin e moralit kantian. Interpretimi i romanit *Procesi* ndihmohet edhe nga *Ditari* i mbajtur në kohën që është shkruar romani. Ndër të tjera, në një letër që i dërgon Felisë, ai e krahason çiftin e tyre si « dy të dashuruar që nën *Terror* shkojnë së bashku në gjotinë ». Për më tepër atmosfera plot makthe, absurditeti i situatave në të cilat gjendet protagonist, ndjenja e humbjes dhe e çrregullimit në universin e Joseph K., duket se janë elemente të mjaftueshme që të shpien te mendimi se Jozef K. do të ishte patjetër i humbur në një botë të pakuptueshme. Nuk kanë rëndësi faji apo drejtësia : me rëndësi është vetëm të vazhdojë procesi, i cili merr fund me ekzekutimin e Jozef K, në mbrëmjen e e 31 vjetorit të ditëlindjes.

Romani *Kështjella* u botua më 1926 si vepër *postume* me nisëativën e Max Brod-it. Autori rrëfen betejën e një geometri, të quajtur thjesht K., i cili përpiqet të hyjë në lidhje me autoritetet e fshatit që të zyrtarizojë statusin e tij. Por « *kështjella* » ku qëndrojnë funksionarët nga ku duhet të jepet autorizimi, mbetet e parritshme. Romani është i pambaruar. Megjithëse Kafka i shkruan mikut të tij Max Brod në shtator 1922 se e ka braktisur romanin, ai ia ka zbuluar atij sesi do ta mbyllte : « K. vendoset në fshat pa leje deri sa vdes. Në shtratin e vdekjes ai merr autorizimin për të jetuar në fshat ». Kafka nuk e mori prapë në dorë romanin, sepse nuk e la vdekja. Romani mbyllet me një frazë të lënë përgjysmë.

Romani tjetër *Amerika* ose *I humburi*, një titull i dytë që donte t'i vinte autori, i shkruar më 1911-1914 dhe i pambaruar, u botua nga Max Brod-i si vepër *postume*, më 1927. Protagonisti i tij, Karl Rossmann, një djalë i ri shtatëmbëdhjetë vjeçar shkon në Amerikë dhe udhëton nga mynxyra në mynxyrë, sikur ta ndiqte një fatalitet enigmatik. Të tilla janë temat themelore të veprës së Kafka-s.

Interpretimi i përgjithshëm kritik, stili

Vepra e Franz Kafka-s pasqyron shoqërinë e fillimit të shekullit XX. Stili letrar i tij ishte i errët, gjuha e përpunuar dhe e saktë deri në hollësi, prandaj përkthyesit fillimisht kishin druajtje nga një vepër tepër e veçantë që kërkonte një njohje të thellë për t'u futur në labirintin e një shkrimtarie të re. Brod-i duke ruajtur dhe botuar veprën e Kafka-s, i bëri botës një dhuratë të paçmuar, duke e njohur me një vepër të rrallë, e cila e ndryshoi dhe pasuroi peizazhin e letërsisë botërore. Personazhet e Kafka-s veprojnë në një botë ku marrëdhëniet që i udhëheqin janë të pakuptueshme e që rrethohen nga forca të panjohura. Sipas shkrimtarit « jeta është një mister i pazgjithshëm, një labirint që nuk ia dimë daljen dhe atë që na pret ». Ai studion psikologjinë e personazheve përballë situatave të jashtëzakonshme dhe trajton temat e vetmisë, të ëndrrave,

Ditën e tretë të Krishtlindjeve, në mbrëmje, disa mysafirë u mblodhën te Rakitini, nëpunësi beqar i postës. Kjo ndodhi në qytetin e vogël kufitar të Krasilovit, shumë i pistë dhe monoton, i banuar nga tre mijë hebrenj dhe fshatarë mazurianë, mes të cilëve qëndronte një grusht i vogël njerëzish që përbënin të ashtuquajturën shoqëri. Shoqëria përfshinte punonjësit e postës, personat e ngarkuar për kalimin e mallrave jashtë nëpërmjet pikës së tranzitit, policinë lokale, klerin dhe një mësues me ndihmësin e tij. Të gjithë ata rrallë e vizitonin njëri-tjetrin çdo ditë për të shmangur shpenzimet e panevojshme, por për Krishtlindje dhe Pashkë shkëmbenin vizita ceremoniale dhe merreshin vesh për aheng ku vallëzonin deri në agim nën tingujt e fisarmonikës ose violinës dhe dendeshin me vodkë të shpifur dhe prodhime pa pretendime në artin e kuzhinës.

Tavolina hapej në një ose dy dhomat e vogla në apartamentin e Rakitinit, i cili emrin e dhomës së ndenjes, në kontrast me të tjerët, e quante dhoma e gjumit. Në krye të vendit ulej drejtori i postës, Shmidi, një burrë i zbehtë, i shëndoshë, i fryrë, sikur ishte mbushur me ujë, i plogët dhe indiferent për gjithçka. Në krah të Shmidit dhe përballë njëri-tjetrit uleshin xhakoni Vasil dhe i zoti i shtëpisë, një brun i vogël energjik me fytyrë të verdhë të errët dhe të bardhat e syve po ashtu të verdha, me një vështrim servil e dinak.

Vendet e tjera ishin zënë nga ndihmësi i Pavlovit, një ish oficer kozak, një djalosh i qeshur, një këngëtar dhe aventurier dhe përkundruall mësuesi i tij Musorini, një njeri i zymtë dhe tip murgu, i gjithi i mbuluar me flokë të zes e të gjatë që e quante veten "apostull i pijetarisë së shtruar". Më në fund të tavolinës Agei Fomiç Malligini, po ashtu nëpunësi i postës që gjithmonë zinte vendin e fundit për drojë dhe modesti.

Agei Fomiç i shmangte vizitat me sa mundej, sepse e bënin të ndiente një lloj detyrimi për t'i ftuar të tjerët. Ai ishte nëpunësi më i varfër në gjithë zyrën, i detyruar të ushqente dhe të vishte të shoqen, vjehrrën e moshuar dhe pesë fëmijë, mirëmbajtja e të cilëve me një page mujore prej njëzet e dy rublash nuk ishte asnjëherë e mjaftueshme. Çdo aheng sillte nevojën e kufizimeve të tmerrshme në ekonominë familjare e cila kërkonte pakësim të skajshëm të shpenzimeve të përditshme deri në normalizimin e tyre. Gjithë familja duhej të hiqte dorë nga mish i supë, nga çaji i mëngjesit dhe nga një sasi drush të zjarrit për një kohë të gjatë.

Autoritetet që vinin zakonisht për të inspektuar postën, gjithmonë e shikonin ftohtë uniformën e vjetër të Agei Fomiçit, e gjelbër, e fshehur në cohët e arneve, me bërrija të ndritshëm. Dhe nëse nuk e largonin Agei Fomiçin për shmangie dhe paraqitje të papërshtatshme, kjo mund të shpjegohej nga keqardhja me të cilën figura e tij e gjatë, e dobët me faqet e zbehta me akne, zburuar me mustaqet e kuqe, të shkurtra e të rralla, me mjekrën, me buzëqeshjen joshëse dhe prej fajtori, me buzët pa gjak dhe sytë e ndritshëm e të shuar, mëshironte padashur cilindo.

Agei Fomiç erdhi në këtë mbrëmje vetëm për shkak të një nevojë urgjente. Gruaja e tij, një grua e sëmurë që gjithmonë ecte me gojën e fashuar, ishte gati për të lindur ato ditë; veç kësaj, shojet e çizmeve të djalit të madh ishin hapur; të dyja kërkonin para, por në shtëpi nuk kishte asnjë kopejkë. Gjendja ishte aq kritike, saqë Agei Fomiç, duke mposhtur drojën, vendosi të kërkonte borxh ca rubla me çdo çmim nga ndonjëri prej pjesëmarrësve në mbrëmjen e Rakitinit.

Dhe tani ai u ul në tavolinë, i shqetësuar, më i zbehtë se zakonisht, me zemrën e fundosur në drojë, duke fërkuar duart me nervozizëm dhe duke prititur çastin e përshtatshëm të bisedojë për punën e vet. Me një nxitim të rënduar, ai refuzoi çdo kafshatë që ju ofrua, nga frika e pakuptueshme se mos e bënte të zotin e shtëpisë të harxhonte pa nevojë.



ALEKSANDËR IVANOVIÇ KUPRIN

Milioneri

tregim

Përktheu nga rusishtja Kosta Nake

Mysafirët hanin dhe pinin. Mes tyre për një kohë të gjatë pati një bisedë të shtruar e monotone për çifligarin, për drejtorin e postës së provincës, për peshkopin e vendit, për të korrat e ardhshme, një bisedë që u përsërit aq shpesh dhe mërziqshëm saqë secili e dinte që më parë ç'illoj shakaje do të thoshte bashkëbiseduesi. Tri-katër herë Agei Fomiçit iu duk sikur erdhi çasti i duhur për të. I dukej e përshtatshme që gjatë bisedës së përgjithshme t'i kërkonte borxh ndihmës menaxherit ose mësuesit.

Bëhej gati të përkulej në drejtim të tyre, gati të prekte mëngën qetësisht për t'i tërhequr vëmendjen dhe pastaj t'i kërkonte. Por çdo herë, një drojë e pashprehur, pothuaj frikë, ia pengonte lëvizjen. Biseda gradualisht u kthye se si ishte bërë jeta tani, sa e shtrenjtë ishte gjithçka, dhe se si zyrtarët e vegjël kërkonin favore për të dhënë ndihmë. Ky problem ishte shumë i njohur dhe i zakonshëm për cilindo dhe secili shprehte opiniononin se s'ka rëndësi si e thua, gjëja më e rëndësishme në jetë ishte paraja dhe paraja; nuk ka nevojë të jesh i mençur, i bukur, ose i zellshëm me ta, të gjithë janë njëlloj, njerëzit do të nderonin para monedhave të florinjta.

"Një herë pothuajse u bëra pasanik, - tha Shmidi me një zë të mbytur. - Isha në dasmën e çifligarit Porçinski, ai në Gollovçin.... Rreth njëzet fisnikë polakë ishin mblodhur atje dhe, kuptohet, pas darkës loznim kumar me letra. Kisha në xhep, nuk më kujtohet, njëzet apo tridhjetë e pesë rubla. Sigurisht, ku të futesha kur ata luanin për një mijë rubla. Qëndroj pranë tyre dhe shikoj. Kur papritur, një çifligar me ca mustaqe të gjata, që po tregonte ende një çerek, më tha mua: Pse nuk vë edhe ti? I thashë se nuk kisha aq para sa te luaja. S'ka gjë, tha ai, verë. Atëherë vura dhjetë - i humba, vura edhe dhjetë të tjera me trefishin - po ashtu i humba. Pastaj u inatos. Kisha një rubël argjendi të Ekaterinës, që e mbaja për kujtim. Jap e marr me mendje, do ta vë dhe atë. E vura. E imagjinoni - u bë. Fitova. Përsëri fitova, përsëri e përsëri. Në pesë minuta i mblodha tërë depozitat. Bankieri tha: Tani rreziko. Sigurisht që vura. Sapo dikush vinte një kartmonedhë të madhe, unë e godisja. Arrita deri në pesëmbëdhjetë mijë. Isha gati të mendoja për ta ngritur, por pata njëlloj keqardhje: si mund ta humbja lumturinë time?"

Në këtë kohë vjen në tavolinë vetë Porçinski, ai që martohej. Eja, më tha ai, ti ke fat në dashuri, prandaj nuk do kesh fat në letra. Hajde vëmë. I thashë: Më vjen keq, unë të grij. Dhe ai thotë: Ti? Shumë mirë. Bankë! Nuk kisha ç'të bëja, i hapa kartat. Dhe imagjinoni, në kartën e dytë i mblodhi

të gjitha paratë, i futi në xhep dhe u largua. Nuk dua të hedh më tani, tha ai.

Të gjithë dëgjonin historinë e Shmidit me sy të zjarrtë: njëlloj sikur të kishin parë pesëmbëdhjetë mijë rublat, të kishin nuhatur aromën e tyre, të kishin dëgjuar tringëllimën e tyre.

"Ka gjithashtu njerëz me fat që fitojnë me bileta, - tha xhakoni duke psherëtitur. (Të gjithë e dinin që ai kishte një biletë për borxhin e brendshëm). Lexova ditën tjetër që një përdorues zuri dyqind mijë. Një varfanjak që nuk kishte para, e mori atë. Vërtet misterioze janë udhët e Zotit."

"E po çfarë nuk bën vaki, - ndërhyri mësuesi me një zë basi. - Thonë se po fitove njëherë me biletë, do fitosh dhe herën tjetër. Apo jo?"

"Po, kështu thonë, - u përgjigj ndihmës menaxheri, - por nuk e di në se është e vërtetë... Edhe ne kishim një rast në Z. me një kopist. Ai shërbente në administratën e provincës dhe ia doli të siguronte një biletë për vete. Një ditë erdhi te bordi dhe nëpunësi e pyeti: Cili është numri i biletës tënde, Sergej Ivanoviç? Cili? Nuk e mbaj mend, po dal ta shoh, një mijë e njëqind e njëzet e tre. Ata kontrolluan gazetën: T'i gëzosh, ke fituar pesë mijë rubla! Atij i iku mendja nga gëzimi. Ia valoi drekës me shampanjë, të tërë e uruan, mbajtën edhe fjalime. Ditën tjetër, e njëjta gazetë thoshte se gabimisht, në vend të një mijë e njëqind e njëzet e katër, ishte shtypur një mijë e njëqind e njëzet e tre. Kështu kopisti u bë derr nga nervozizmi.

Njëra pas tjetrës vërshuan këto histori kalorësiake të famshme të botës, të gjashtme me njëra-tjetrën si dy pika uji: për Ritshildin që erdhi në Paris në këmbë dhe në fillim shiste shkrepëse në rrugë, pastaj fitonte njëqind milionë në vit, për Vanderliten, për gjetjet e nëndheshme, për fituesit e letrave, për spekulimet në bursë, për daja Samët amerikanë që bëheshin milionerë papritur.

Agei Fomiç, edhe pse nuk kishte asgjë ç'të tregonte për vete, merrte pjesë aktive në këto biseda. Zotëronte imagjinatë çuditërisht të pasur dhe ritregonte gjithçka që ishte thënë në prani të tij në mënyrë jashtëzakonisht të gjallë. Fliste për borxhet nga të pasur që s'pritej, nga pronarët e tokave, krijesat e fuqishme të quajtur milionerë, që nuk njihnin refuzim për ndonjë nga surprizat e tyre, irritohej e dridhej nga ethet gjithnjë e më shumë, pasi atë çast kishte nevojë dëshpërimisht për pak rubla të mjera për gruan dhe çizmet e djalit.

"Disa njerëz paratë i gjejnë në rrugë," - belbëzoi papritur Agei Fomiç, pa e prititur as vetë.

Të gjithë e panë të habitur, pasi nuk kishte folur fare atë mbrëmje. Agei Fomiç u zu ngushtë dhe i uli sytë mbi mbulesën e tavolinës.

"I gjejnë në rrugë, posi, vetëm... nga xhepat e të huajve," - ia bëri ndihmës menaxheri.

Të gjithë qeshën, më shumë për ndryshimin në fytyrën e Agei Fomiçit sesa nga shpotia e ndihmës menaxherit dhe sakaq secili tregoi raste me vjedhje të mëdha, të rrezikshme, të pazbulura. Dhe përsëri përpara syve të Agei Fomiçit u shfaqën dhjetra, qindra, mijëra rubla, tufa të mëdha me kartmonedha, emrat magjikë të njerëzve të pasur që nuk dinin sa para kishin. Dhe ai dëgjonte me të njëjtën ndjesi me të cilën një i uritur shikon nga dritarja dyqanin e ushqimeve.

Ora e vjetër e murit tingëlloi për orën e plotë. Xhakoni u ngrit, përveshi mëngën e djathtë të rases së vet dhe filloi të përshëndetej, pas tij u ngritën të tjerët, përveç Agei Fomiçit. Gjithë kohën që Rakitini shoqëroi mysafirët te dera e jashtme me një qiri, ai ndenji pa lëvizur në të njëjtin vend, duke formuar topëza buke me dorën që i dridhej nga emocioni.

"Ja tani Rakitini do të kthehet, - mendoj Agei Fomiç, - dhe do t'i kërkoj. Duhet vetëm të tregohem më trim. Dhe, në fund të fundit, ai nuk do të më hajë me pyetje, apo jo?"

Më në fund Rakitini u kthye dhe u ul pranë mysafirët të tij, i habitur që nuk kishte ikur me të tjerët, por Agei Fomiç, në vend që t'i kërkonte para, menjëherë tërhoqi zvarrë një bisedë të gjatë e monotone për shërbimin dhe rrogën. Rakitini e shikonte me sytë e përgjumur duke u munduar të dëgjojë me mirësjellje dhe duke hapur gojën që i mbyllej me zhurmë. Kaloj gjysmë ore kështu. Më në fund Rakitini nuk mundi të duronte më dhe u shtriu me një gogësim të gjatë zëllat.

"Oh, ç'dreq! - tha ai me një zë të përgjumur. - Nesër kam radhën e shërbimit."

Agei Fomiç u ngrit me nxitim dhe filloi të shfaqësohej. Në korridor, duke u mbajtur te doreza e derës, papritur e kapërceu hezitimin dhe iu kthye Rakitinit:

"Dëgjo, - i tha me zë të mbytur dhe pa e vështruar. - Unë kam... kam një gjë të vogël për ty... një... kërkesë..."

"Çfarë?" - pyeti Rakitini me shqetësim.

"Ti e kupton, unë do të... nuk do të doja të të shqetësoja... Gruaja ime duhet të lindë... Ti e di, e kupton, është e domosdoshme... Dhe unë, në emër të Zotit, më jep njëzet... rubla... - ai donte të thoshte dhjetë, por ishte i frikësuar nga një shumë e tillë. - Të paktën pesë rubla..."

"Për Zotin, s'kam asnjë kopejkë, - u përgjigj Rakitini duke vendosur dorën në kraharor. - E po, ti e sheh, në tërë shtëpinë nuk gjen një kopejkë."

Nga toni jashtëzakonisht i sinqertë i Rakitinit, Agei Fomiç e kuptoi fare mirë që ai kishte para, por kishte frikë t'i jepte borxh. Duke murmuritur diçka si shfaqësim, Agei Fomiç doli në rrugë. Nata ishte me hënë dhe me ngricë. Rrugët e gjera të mbuluara me dëborë, shtëpitë e ulëta me kapat e bardha të dëborës, pemët e ngarkuara me dëborën si pambuk, të gjitha këto dukeshin të vdekura. Dëborë kërciste fort në këmbët e tij. Agei Fomiç duhej të shkente mjaft larg, por mendimi për paratë nuk e lejonte. Mendoj me tmerr se si do të vinte në apartamentin e tij të ulët, të ftohtë, me dritare të gjelbra, xhamat e të cilave ishin ngjitur diagonalisht me zamkë, me aromën e përjetshme të varfërisë dhe pelenat e fëmijëve. Çfarë t'i thoshte të shoqes kur ta pyeste për paratë me atë zërin e sëmurë e të çjerrë? Ai pinte vodkë e birrë, hante derrkuc të pjekur, kurse ata shkonin në shtrat barkzbrazët, me të vetmen shpresë se babai patjetër do të kishte gjetur para.

"O Zot, - mendoj Agei Fomiç me hidhërim. - Pse nuk u dërgon lumturi, kënaqësi dhe një jetë për të qenë të tjerëve? Pse më ke harruar mua? Të tjerët gjejnë para që mund të mos u nevojiten. Ç'do të bëhej sikur unë të gjeja të paktën një herë, vetëm një herë në jetën time... të paktën dhjetë, jo, njëzet rubla! Dhe

gruaja do të kishte diçka me se të paguante dhe çizmet e Vasjatkës dhe pallton e ngrohtë të Leles... Tani, për shembull, pse të mos gjej një kuletë me para në rrugë? Mbi të gjitha, ndonjëherë ka edhe të tilla raste, qoftë edhe rrallë; pak shkruajnë dhe flasin për këtë?

Me mendjen e tij ëndërruese, Agai Fomiçi filloi të imagjinojë me kënaqësi se si do të gjente një portofol të trashë prej lëkure në rrugë, si do ta hapte dhe do të shihte një tufë me kartmonedha njëqindrubëlshë dhe bileta fituese, si do të vendosej në një apartament të madh, të ngrohtë dhe plot dritë, si do të ndërronte mobiljet, do të qepte me porosi rroba të ngrohta e të bukura për familjen dhe... Asnjëherë nuk dihet se çfarë të mira bëhen me para shumë?

Pak nga pak, ndoshta edhe nën efektin e ca gotave me vodkë, ndoshta si rrjedhojë e vetësugjestionit, një bindje absolutisht absurde dhe e pazezistueshme filloi të rritej në shpirtin e Agai Fomiçit dhe sonte, madje tani, ai duhet të gjejë një portofol të çuditshëm në rrugë. Pse duhej të ndodhte kjo, ai nuk e dinte, as nuk mendonte për të. Ai thjesht ishte i bindur, po ecte duke ulur kokën dhe duke parë me vëmendje poshtë këmbëve.

“Ja tani... tani, - pëshpëriste në delir, - të tjerët gjejnë... ja dhe pak hapa... ja tani... tani...”

Dhe befasi, nuk ishte iluzion i imagjinatës së nxehtë, ai pa qartësisht një objekt të vogël të zi, me formë të rregullt drejtkëndore, mbi dëborën e rrugës. Duke marrë frymë me një kënaqësi të pakontrolluar, me qimet e kokës të ngritura përpjetë, Agai Fomiçi vështronte përçark si të ishte hajdut dhe u përkuul mbi objektin e shtrirë... Në duart e tij ishte një kuletë e trashë lëkure... Në fillim, koincidenca e gëzueshme e ëndrrës me realitetin, e ngurtësoi për pak sekonda, por duke u siguruar që në duart e tij ishte një portofol i vërtetë dhe jo fantastik, e ngjeshi me gulç në gjoks dhe u vërsul drejt shtëpisë...

I duhej të ikte fluturimthi për rreth pesëqind metra. Ndjeu të prera në stomak nga që nuk ishte mësuar të ecte shpejt, sikur një top i thatë me xipa po hapej në grykë, gjaku po vërshonte me rrëmbim në kokë. Por ai nuk mund të ndalonte, i dukej sikur në rast të një çasti vonese, dikush do ta kapte dhe do t'ia merrte thesarin që kishte gjetur. Duke vrapuar i ra kapela nga koka. Ai do të ishte përkulur ta merrte, por menjëherë tundi dorën dhe vazhdoi vrapin.

“Do të kem një mijë kapela!” – pëshpëriti i kënaqur...

Pas trokitjes së nxituar në derë, e shoqja u zgjua e trembur dhe doli me një qiri në duar. Edhe fëmijët u zgjuan dhe vështruan të atin nga krevatët e tyre me habi dhe tmerr. Agai Fomiç u plas në kolltuk i zbehtë, i mbuluar me djersë, me sytë e çakërdisur e të ndritshëm.

“Anjeçka! Fëmijë! - shfrymoi ai duke tundur kuletën. - Ja këtu... në kuletën tuaj... para... njëqind mijë... Do marrim me qira një apartament. Anja... shampanjë... katërqind mijë... E kupton? Urr-al!”

Tani Agai Fomiç është aq i pasur saqë gjithë thesaret e kështjellës së Gollkondës dhe Kalifornisë s'janë gjë para milionave të tij. Ai mban gjashtë mijë kuaj dhe tre milion e pesëqind karroka në stallën e tij. Ai është drejtori i gjithë hekurudhave të botës, madje edhe i asaj të resë që po shtrihet nga toka në Jupiter. Është jashtëzakonisht bujar dhe i gatshëm t'i japë çdo hallexhiu të varfër një ose dy mijë rubla. Është zemërmirë, i qetë i dhembshur dhe e vetmja gjë që urren është nëse dikush guxon t'ia prekë portofolin e çmuar prej lëkure, i cili ka brenda një kartmonedhë trerubëlshë të lyrosur, një faturë bagazhi dhe një njoftim gazete. Atëherë e kap një tërbim i çuditshëm dhe flak çdo gjë që ka në duar apo rrotull tij.

E shoqja dhe fëmijët e duan shumë atë dhe tregojnë vëmendjen më të madhe. Ai ua shpërblen mirësinë... Dhe më në fund, ku e dimç ne? Ndoshta të çmendurit nganjëherë janë shumë më të lumtur se ne, njerëzit e shëndetshëm.



Vizatimet e Franz Kafkës

(Vijon nga faqja 21)
të frikës dhe komplekseve. Personazhi i tij është përgjithësisht i humbur, i çorientuar. Atmosfera e veçantë e romaneve dhe novelave të tij ka dhënë epitetin *kafkaesk* në gjermanisht, *kafkaïen* në frëngjisht, por edhe në të folmen shqipe përdoret epiteti *kafkiane*, i cili është bërë një referim që ka kuptimin e një diçkaje absurde, të ngatërruar dhe të pakuptueshme.

Shoqëria e dehumanizur për të cilën flet Kafka në fillimet e shekullit XX, është një kritikë e mprehtë dhe shumë aktuale për shekullin e zombive, të mureve ndarës, të antisemitizmit, të inteligjencës artificiale, të luftërave që do të shenjojnë përjetë brezat e rinj. Vepra e tij flet për fatin e njeriut në shoqëri dhe përfton kështu frymë universale. Kafka vetë nuk ka pasur shumë siguri në jetë, pohon biografi i tij gjerman Reiner Stach, prandaj kemi dy Kafka, atë shkrimtar që vëzhgon një botë mbytëse për individin dhe punonjësin e sigurimeve shoqërore që nuk është i qetë të punojë dhe të shkruajë.

Kritikët janë përpjekur ta vendosin veprën e Kafka-s në rryma të ndryshme letrare si *modernizmi* dhe *realizmi magjik*, por mungesa e shpresës dhe absurdi që hasim në veprën e tij janë trajta tipike të atij që më vonë do të quhej *ekzistencializëm*. Në librin me ese *Nga Bibla te Kafka*, George Stainer duke thënë « atdheu ynë, teksti », e quan Kafka-n « një trashëgimi kulturore që bashkë me libra të tjerë të mëdhenj janë të domosdoshëm për t'u lexuar që të arrijmë të kuptojmë vetveten (*De la Bible à Kafka*, Hachette littérature, 2002, f. 60). Vladimir Nabokov-i në leksionet e letërsisë kushtuar shkrimtarëve të mëdhenj ka përfshirë edhe Franz Kafka-n, botuar te libri *Littératures I*, dhe hedh poshtë edhe mendimin e kritikës, ngritur mbi idetë e Frojdit, nisur nga marrëdhëniet e ndërlikuara të Kafka-s me të atin si dhe të ndjesisë së fajit. Kafka vetë ishte shumë kritik ndaj ideve të Frojdit. Nabokov-i thotë se së pari duhet vështruar fuqia e artit të Kafka-s. Ai e sheh Floberin si modelin e vërtetë të Kafka-s. Nabokovi i vështron prindërit e G. Zamza-it, si borgjezë

të vegjël të Pragës « filistinë flobertianë », njerëz me shije të rëndomta që interesohen vetëm për anën materiale të jetës. « Familja Zamza rreth insektit fantastik nuk është gjë tjetër, veçse mediokriteti që rrethon gjenium », shkruan ai. Nabokovi e quan Kafka-n shkrimtarin më të madh të gjuhës gjermane, dhe novelën *Metamorfoza* si « novelën e tij më të shquar » (*Littératures I*, f. 256). Në librin *Diskutime me Kafka-n*, e Gustav Janouch-it shfaqet imazhi i një njeriu që ishte « tmerrësisht i vetëdijshëm në çdo fjalë që thoshte dhe që tregojë i matur dhe shumë i saktë në përdorimin e tyre » (f. 91).

Disa kritikë mendojnë se gjejnë në veprën e tij ndikime të markzizmit, sidomos në qëndrimet kritike ndaj burokracisë. Disa shohin edhe shenja anarkiste. Tomas Mani dhe Maks Brodi shohin në veprën e Kafka-s kërkime metafizike. Nga tërë vepra e Kafkas del edhe një përsiatje njëherësh kritike dhe betejën e çdo individi për të gjetur vendin që meriton.

Ndikimi

Stili dhe simbolizmi i Kafka-s kanë ndikuar mjaft në përvijën letrare. Kundera citon humorin syrealist të Kafkas si burim frymëzimi i shkrimtarëve dhe regjizorëve : Federico Fellini, Garcia Marquez, Carlos Fuentes, Salman Rushdie e të tjerë. Garcia Marquez thotë që pasi lexoi novelën *Metamorfoza*, mendoi se « ishte e mundur të shkruante në një mënyrë tjetër ».

Sot vepra e Kafka-s është analizuar thellësisht dhe është përkthyer kudo në botë. Edhe në Shqipëri. I pari ishte Gjergj Vlashi me përkthimin e suksesshëm të novelave *Metamorfoza* dhe *Kolonja ndëshkimore*, botuar nga shtëpia botuese Argeta LMG dhe më vonë me romanin *Procesi*. Ardian Klosi nën kujdesin e shtëpisë botuese K&B përmbodhi në një libër prej prej 500 e ca faqesh më 2010, Franz Kafka, *Vepra e plotë në prozën e shkurtër*. Libri *Nga Kafka te Kafka*, i shkrimtarit Maurice Blanchot është botuar më 2020 edhe në shqip nga Arka e Noes, me përkthim të Balil Gjinit. Fatmir Alimani shkroi librin *Katër K*, duke pasur parasysh Kafkën, Kavabatën, Kunderën dhe Kadarenë. Përkthyes të ndryshëm kanë marrë përsipër përkthimin e librave të tij, por hyrja në stilin e Kafka-s është mjaft e vështirë.

Kafka mbahet si shkrimtar madhor i avant-gardës europiane.

Kafka është ortografia gjermanisht e fjalës çeke *kavka* që do të thotë *galë*.

Nderimi

Në Pragë është ngritur prej vitesh muzeu *Franz Kafka*.


Pranë shtëpisë së lindjes së tij në Pragë një shesh mban emrin Fanz-Kafka.

Një bust i tij është në hyrje të metrosë qëndrore në Pragë.


Një bust tjetër është në Kielce të Polonisë.

Romani *Procesi* është përshtatur për teatër, radio, muzikë dhome, opera, libër vizatimor etj. Ai u ekranizua nga Orson Welles më 1962. *Kështjella* u ekranizua më 1969. *Amerika* më 1984. Më 1991 dhe 1993 u realizuan dy filma për jetën e Kafka-s. Më 1993 u ekranizua *Metamorfoza*. Më 2004 u ekranizua *Një mjek fshati*. *Udhëtim në Itali*, është një film me metrazh të shkurtër bazuar në *Ditarin* e tij. Më 2016 u ekranizua *Artisti i urisë* (përkthyer në shqip nga Fatmir Alimani).

100 vjetori i vdekjes së Kafkës u përkujtua në të gjithë botën letrare me takime, analiza të veprës, me botime të reja që vazhdojnë ende ta rizbulojnë këtë shkrimtar të madh.



Dorëshkrim nga *Letër babait*, Franz Kafka.



Karikaturë nga Arben Mexsi